

**Bashkia Shkodër**  
**Biblioteka “Marin Barleti”**

**Gegnia**  
E përkohshme kulturore-artistike

**20-2023**  
**Vjeti VIII i botimit,**  
**Shkodër**

**Gegnia**

E përkohshme kulturore-artistike

**20-2023**

**Vjeti VIII i botimit**

**Redaksia:**

Maxhid Cungu, Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija

**Redaktor gjuhësor:** Erzen Koperaj

**Botohet nën kujdesin e Bashkisë Shkodër dhe Bibliotekës “Marin Barleti”**

ISSN: 2519-73-91

**Adresa e redaksisë:** Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

**E-mail:** [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)  
[info@bibliotekashkoder.com](mailto:info@bibliotekashkoder.com)

**Shënim:** *Pikëpamjet e artikullshkruesve nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

## Përmbajtja

### ▪Në vend të editorialit▪

Stefan ÇAPALIKU

Qyteti dhe Letërsia.....

### ▪Kritikë dhe studime letrare▪

Arben PRENDI

Koliqi, tregimtari dhe novelisti modern .....

Laureta BRUKA, Ermira ALIJA

Subjekti i përbashkët i dy përrallave të mbledhura në veri dhe i një poeme të shkruar në skajin jugor të shqipërisë .....

Drita BRAHIMAJ

Rëndësia dhe jehona e veprës *William Shakespeare* të kolosit të letërsisë franceze Viktor Hygo

### ▪Gjuhësi

Klevisa BARDELI

Disa qasje të paskajores gege sot .....

### ▪Filozofi▪

Alessandro PREVER

Fragmente filozofije: “Papa Ratzinger (kërkimi i qytetnimit mesjetar në bashkëkohësi) dhe Umberto Eco (kërkimi i bashkëkohësis në Mesjetë): Nji kontrast i pashërueshëm“ .....

### ▪ Etnografi▪

Zenepe DIBRA

Ismajl Golemi - mjeshtri i parë artizan i prodhimit të vulave .....

### ▪Recensione▪

Gjovalin Çuni

Libri “Përndjekja e Hajrije Mulletit. Stigma e një drame” i autores Fatbardha Mulleti ...

Gëzim Puka

Pikëvështrim për librin “Konsullatat franceze në Shqipërinë e shekujve XVII-XIX” e autorit Luan Rama .....

Ermira **ALIJA**

Mbi monografinë “*Naim Frashëri në historiografinë letrare shqipe*” të autores Irma Bilali, promovuar në bibliotekën “Marin Barleti” të Shkodrës .....

Xhahid **BUSHATI**

Një histori dramatik-tragjike në një rrëfim vetjak. Shënime për romanin "I burgosuri", i autorit Adem Ēzkëse (Ozkose), një histori e vërtetë burgimi.....

▪ **Arkiv**▪

Willy **KAMSI**

Nikollë Dakaj, përkthyes e polemist.....

▪**Kronikë kulturore**▪

Maxhid **CUNGU**

.....

## ▪Në vend të editorialit▪

Stefan ÇAPALIKU

### QYTETI DHE LETËRSIA

ESE

#### I. Qyteti dhe Letërsia

Pse “Qyteti dhe Letërsia” dhe jo “Fshati dhe Letërsia”? Sepse qyteti është një nga vendet më fort përfaqësuese të epokës bashkëkohore, duke filluar nga revolucioni i parë industrial e këndej. Si rrjedhojë e rritjes demografike qytetet janë bërë vendi i përqendrimit të masave të mëdha të njerëzve. Që nga mesi i shekullit të tetëmbëdhjetë, kur gjithnjë e më shumë njerëz filluan të punojnë në fabrika, e deri më sot, qytetet filluan të zgjerohen vazhdimisht, derisa u bënë metropole dhe megalopole.

Çfarë roli luan qyteti në raport me letërsinë? Cili është roli i hapësirës urbane në letërsinë e një vendi të caktuar? Kjo është pyetja themelore që shtron ky libër i vogël.

Në parim kemi dy raporte mes këtyre dy koncepteve, qytetit dhe letërsisë: çfarë dhe si letërsia mund të tregojë për qytetin dhe çfarë ndikimi ka qyteti te të “bërit” e letërsisë.

Në përgjithësi kritika klasike dhe historiografia tradicionale e letërsisë e kanë parë atë të lidhur më së shumti me kohën, me epokën së cilës i përket dhe të cilën përshkruan. Pra e kanë parë të lidhur me “kronos”-in dhe jo me vendin, hapësirën “topos”-in.

Veçanërisht me botimin dhe përhapjen e librave të Michail Bachtin<sup>1</sup>, propozohet një tjetër kriter metodologjik, siç është ai i “kronotopit”. Fjalë për fjalë, “kronotopos” do të thotë “kohëhapësirë” dhe është një koncept që zanafillat i ka në teorinë së relativitetit, përdorur për të treguar marrëdhënien e ngushtë midis hapësirës dhe kohës në fizikën e Ajnshtajnit.

Në vëllimin e tij “Estetika dhe romani”<sup>2</sup> propozohet që ky koncept të përdoret për të përshkruar korrelacionin e ngushtë midis hapësirës dhe kohës në rrëfim letrar. Kësisoj në kronotopin letrar, bëhet shkrirja e konotacioneve hapësinore dhe kohore në një tërësi konkrete të kuptimit. Koha këtu, duke u bërë e dendur dhe kompakte, bëhet edhe e dukshme artistikisht; hapësira intensifikohet dhe hyn në lëvizjen e kohës, të komplotit, të historisë. Konotacionet e kohës manifestohen në hapësirë, së cilës koha i jep kuptim dhe masë. Ky kryqëzim i planeve dhe kjo shkrirje konotacionesh karakterizon kronotopin artistik.

Kronotopi është një element që funksionon në dy nivele, në formë dhe në përmbajtje. Ai është, në të njëjtën kohë elementi strukturor i trullit të veprës letrare, strumbullari rreth të cilit zhvillohet rrëfimi dhe elementi që luan një rol simbolik dhe metaforik brenda tregimit.

Louis Wirth<sup>3</sup>, një sociolog, urbanist i madh dhe kontribues i jashtzakonshëm në teorinë sociale të hapësirës urbane, në esenë klasike “Urbanizmi si një mënyrë e jetës”<sup>4</sup>, thotë

<sup>1</sup> Michail Bachtin u lind më 1895 në Rusi dhe vdiq po aty më 1975.

<sup>2</sup> Bakhtin, Michail. “Estetika e romanzos”, Torino, Einaudi, 1997 fq.231-232

<sup>3</sup> Luis Wirth u lind në Gjermani më 1897 dhe vdiq në USA më 1952. Ishte sociolog i famshëm.

<sup>4</sup> Wirth, Louis. Urbanism as a Way of Life”: American Journal of Sociology (1938). The City Reader Edition 5th Edition, First Published, Routledge 2011

se “qyteti është një vendbanim relativisht i madh, i dendur dhe i përhershëm i njerëzve shoqërisht heterogjenë. Dimensioni, dendësia dhe heterogjeniteti janë elementet që supozohet të bëjnë qytetin një hapësirë materiale dhe simbolike për marrëdhënie shoqërore specifike dhe të ndryshme, krahasuar me ato tipike të mjedisit rural”.

Mendoj se ajo çfarë i intereson argumentit tonë nga ky përkufizim është “heterogjeniteti”. Heterogjeniteti i qytetit është ajo çfarë i jep ngjyrë letërsisë; që e bën atë të kalojë nga grafika bardh e zi në një pasqyrim me ngjyra dhe tone.

E parë nga ditët tona, historia e gjatë e qytetit mund të ndahet në tre periudha, në bazë të llojit të qytetit që u formua dhe u përhap: qyteti paraindustrial, qyteti industrial dhe qyteti post-industrial. Kjo tipologji identifikon modele ose tipe ideale, sepse asnjë qytet në histori nuk i përgjigjet saktësisht një tipi ideal, por, duke krahasuar tipin ideal me realitetin empirik të një qyteti të caktuar, mund të heqim paralele ngjashmërie dhe meridiane divergjencash.

Në të vërtetë qyteti është një shpikje shumë e lashtë njerëzore. Qyteti para-industrial, qyteti industrial dhe qyteti post-industrial kanë pushtuar epoka historike me gjatësi jashtëzakonisht të ndryshme kohore. Qyteti post-industrial është modeli mbizotërues në botën perëndimore, në epokën bashkëkohore dhe ka të bëjë afërsisht me 50 vitet e fundit; qyteti industrial, nga ana tjetër, u vendos si modeli mbizotërues i qytetit, duke filluar nga Revolucioni Industrial<sup>5</sup> e deri në dekadat menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Qytetet e panumërta që lulëzuan në perandoritë e mëdha duhet të llogariten ndër qytetet para-industriale, që karakterizuan një periudhë të gjatë, që shtrihet nga qytetet e para deri në Revolucionin Industrial. Nga ky këndvështrim, qytetet bashkëkohore, por edhe ato industriale, shfaqen si dukuri afatshkurtëra, më së shumti disa qindra vjet.

Kultura perëndimore mbart një traditë të rrënjësor thellë, që e sheh qytetin nga dy perspektiva të kundërta. Nga njëra anë kemi pikpamjen miqësore të Aristotelit, se “Njerëzit mbledhen në qytet për të jetuar, ata mbeten atje për të jetuar një jetë të mirë.”, si dhe nga ana tjetër pikpamjen e Shën Agostinit, që e sheh qytetin si një vend armiqësor dhe kërcënues për individin. Le të kujtojmë me këtë rast vetëm “Qytetin e Zotit” të Shën Agustinit<sup>6</sup>.

Sidoqoftë asnjëra prej prespektivave nuk e shmang rëndësinë e madhe që kanë te njëra tjetra: letërsia dhe qyteti, si për mirë a por për keq.

Për tu kthyer edhe njëherë te Bakhtin, duhet të themi se në analizën e tij të romanit, ai nënvizoi se si rruga me format e saj të shumta simbolike është vendi kryesor i ndërtimit të rrëfimeve nga antikiteti i vonë deri në epokën bashkëkohore. Në interpretimin e hapësirës urbane, rruga mund të përbëjë atë referencë të dobishme për përpunimin e një situatë kuptimore, për krijimin e lidhjeve ndërmjet paraqitjeve të ndryshme të qytetit. Kështu në hapësirën narrative, ashtu si në atë urbane, rruga përfaqëson një pikë referimi, një konstante strukturore përgjatë së cilës shpaloset jeta e personazheve, por edhe jeta e njerëzve që janë alternuar historikisht në qytetet tona.

Nga fillimi i viteve 1900 deri në kohën më sot, nga një metropol në tjetrin, rruga ka qenë një skenë publike për ndarjen, shkatërrimin e një grupimi shoqëror unitar ose një vend tranziti për masat anonime dhe inerte. Rruga bëhet skenë shkëmbimesh, por edhe vend takimesh të humbura. Ajo është baza e të kuptuarit të ekzistencës së protagonistëve dhe në të njëjtën kohë mund të jetë edhe vendi i mohimit të të njëjtit kuptim në një hapësirë më të madhe urbane kaotike.

Kësisoj reflektimi mbi ndërthurjen e një hapësire me një histori, mund të përbëjë një udhërrëfyes, falë të cilit të arsyetohen tekste dhe të ndërtohen drejtime interpretimi.

---

<sup>5</sup> Revolucioni industrial zgjati nga 1760 deri më 1860

<sup>6</sup> Qyteti i Zotit në latinisht: “De civitate Dei contra paganos”, është një libër i filozofisë kristiane, shkruar në latinisht nga Shën Augustini në fillimet e shekullit të 5-të.

Profesoreshë Katherine Mullin<sup>7</sup> thotë se një interes për ndjeshmërinë e letërsisë për qytetin, si bie fjala James Joyce për Dublin, u zhvillua nga mesi i shekullit të 19-të deri në periudhën moderniste. “Sa më i madh të jetë numri i njerëzve që grumbullohen në një hapësirë të vogël, aq më e neveritshme dhe fyese bëhet indiferenca brutale dhe përqendrimi i çdo personi në punët e tij private”<sup>8</sup>.

Kultura përendimore gjithashtu ka treguar edhe një lloj neverie për qytetin. Dikensi gjithashtu në një tufë romanesh të veta apo më vonë edhe Louis Ferdinand Céline, mbeten të impresionuar për keq nga basifondet dhe tualetet e metrove<sup>9</sup>.

Pra vihet re se qyteti na qenka një vend ku lulëzojnë veset e ku vdesin virtytet. Po a mund të ketë për një shkrimtar një vend më interesant se ky?

## a. Letërsia shqipe dhe Qyteti shqiptar

Libri ynë, natyrisht, cekë raportin e letërsisë shqipe me qytetin shqiptar, të zhvilluar në kushte lirie dhe jashtë presionit ideologjik. Prandaj ai fokusohet në gjysmën e parë të shekullit XX dhe tenton të japë një kontribut në të ashtuquajturën antropologji urbane, duke e pasur Shkodrën si rast studimi, si kryeqytet i letërsisë me dy shkollat e veta letrare, françeskane dhe jezuite, si dhe me një laicitet të shpallur letrar.

Qytetet shqiptare, për arësye historike, që tashmë dihen, nisën të marrin formën e vet përendimore diku nga fundi i shekullit të XIX dhe fillimi i shekullit të XX. Por, gjithsesi vulën ia vuri gjysma e parë e shekullit të XX dhe veçanërisht vitet e sundimit të mbretit Zog si dhe periudha e pushtimit italian.

Shkodra, tamam në kohën kur po formësonte strukturat e veta tipike, nxjerrë figura shumë të rëndësishme të letërsisë sonë. Ajo do shkëlqejë me shkrimtarë të tillë si: Gjergj Fishta (1871-1940), Ernest Koliqi (1903-1975), Migjeni (1911-1938).

E dimë se në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë, edhe Shkodra më në fund ra nën ndikimin e Austro-Hungarisë dhe Kultusprotektorat-it të saj<sup>10</sup>. Është koha kur Austria fillon t'i shtojë veprimtarinë e veta në kuadrin e këtij protektoratit si mjet për të ushtruar ndikim politik, në mënyrë që të dobësonte sa më shumë fuqinë e Perandorisë Osmane nga brenda.

Me ndihmën e Austrisë, në Shqipërinë e Veriut u ndërtuan e u meremetuan shkolla e kisha. Kësisoj Shkodra do të bëhej qendra letrare e kulturore jo vetëm për katolikët shqiptarë, por për të gjithë vendin. Në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë Franceskanët, u bënë përherë e më aktiv në fushën e arsimit e të kulturës. Më 1855 ata themeluan një shkollë françeskane, të njohur më vonë me emrin “Illyricum”. Besohet që kjo të jetë shkolla e parë ku u dha gjuha shqipe. Më 1861 u themelua një Seminar Françeskan. Më pas françeskanët ngritën një shtypshkronjë, ku shtypën një numër librash fetarë dhe laikë shqip, si dhe organe periodike me interes të madh letrar e kulturor si Hylli i Dritës, 1913-1944, dhe Zâni i Shna Ndout, 1913-1944.

Nga ana tjetër urdhri jezuit erdhi në Shqipëri më vonë. Shoqata e Jezusit, siç quhet ky urdhër, luajti një rol të çmueshëm në arsimin dhe kulturën e Shqipërisë veriore. Ata ngritën

<sup>7</sup> Mullin, Katherine. James Joyce, Sexuality and Social Purity. Cambridge University Press, 2003. F.202

<sup>8</sup> Mullin, Katherine. Cities in modernist literature në “20th-century-literature”. London 2016

<sup>9</sup> Howe, Irving. A voice still heard A Voice Still Heard: Selected Essays. Yale University Press, London, 2014. F. 162

<sup>10</sup> Nga luftërat fitimtare të Habsburgëve kundër Osmanëve që nga fillimi i shekullit të 17-të deri në Kongresin e Vjenës rezultoi i ashtuquajtur i "protektoratit i kultus-it" i Austrisë, d.m.th. e drejta e mbrojtjes së të gjithë katolikëve, më vonë të gjithë të krishterëve të Perandorisë Osmane. Detyrat zyrtare e protektoratit të kultus-it ishin ngritja dhe mirëmbajtja e kishave, arsimimi i klerit dhe mbrojtja e kongregacioneve në Shqipëri. Në këtë kuadër që në shekullin e 18-të Austria filloi të hapte konsullata dhe zëvendëskonsullata në Shqipëri.

shkolla, kisha dhe lokale publike, veprimtaritë e tyre dhe talentet e tyre intelektuale të fuqishme dhanë gjithashtu një ndihmesë të ndjeshme për ngritjen e nivelit arsimor e kulturor të atdheut të tyre të ri. Më 1859 jezuitët hapën Kolegjin Papnore Shqiptare në Shkodër, kurse më 1870 ngritën aty një shtypshkronjë “Shtypshkroja e Zojës s’Paperlyeme”<sup>11</sup>, e cila gjashtë vjet më pas do të nxirrte librin e saj të parë në gjuhën shqipe “Dotrina e kerscten”, Shkodër 1876, e Ëngjëll Radojës. Deri në vitin 1928, shtypi jezuit kishte botuar gjithsej 471 libra. Sikundër françeskanët, edhe jezuitët nxorën organe periodike të shquara si “Elçija i Zemers t’Jezu Krisctit” (1891-1944), “Përparimi” (1914-1916) dhe “Leka”, 1929-1944, revistë e përmuajshme kulturore. Më 1877, jezuitët themeluan Kolegjin e Shën Françesk Saverit<sup>12</sup> në Shkodër, e cila u kthye në një qendër të madhe të arsimit të lartë për të gjithë në Shqipëri, duke e vënë theksin te arsimit në gjuhën shqipe.

Kjo shkollë nxori shumë shkrimtarë të mëdhenj të fillimit të shekullit të njëzetë. Ndër to mund të permendim: Ndre Mjeda (1866-1937), shkrimtarin dhe publicistin Faik Konica (1875-1942), Luigj Gurakuqi (1879-1925), Vinçenc Prenushi (1885-1949), Zef M. Harapi (1891-1946), Ernest Koliqi (1903-1975), Kolë Jakova (1916-2002), Mark Gurakuqi (1922-1970), etj. Ishin këta shkrimtarë shqiptarë që filluan në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë të krijojnë bazat e një letërsie të re shqiptare<sup>13</sup>.

Mund të themi pa drojë se është kjo letërsia që ndihmoi për shndërrimin e shqipes nga një gjuhë e aftë për t’u shkruar në një mjet letrar të aftë për shprehësi artistike e për larmi stilistike.

Është koha, siç shprehet profesor Kolë Ashta kur “Shkrimtarët e Rilindjes Kombëtare duhet që t’i njohim ndër çfaqjet e ndryshme të tyre, si përkrahja të shllimit atdhetar e si vlerë letrare. Ngjan shpesh që këta shkrimtar paraqiten kombtarista të ndezun gati për t’u flijue, por nuk janë shkrimtar të cilsuem. Sidoqoftë detyra e jonë qëndron në njohunin e drejtë për së drejti të prodhimit të tyre, i cili u krijue në një kohë mundimesh së forta”<sup>14</sup>.

Pra misionet patriotike me misionet letrare aso kohe qenë të ngërthyera pazgjidhshërisht. Kësisoj qyteti gjithashtu jetonte rrezikun të humbiste takimin me modernitetin. Ai, qyteti, Shkodra pra, nuk mund të shkonte përtej asaj që shihej dhe nuk mund të prodhonte ide dhe të udhëhiqej më prej tyre. Qyteti vazhdon të ketë ketë muret e larta apo avllitë, të cilat nuk linin kurrësesi të shikoje nga jashtë brenda dhe as nga brenda jashtë. Shpesh mbi avlli kapërcenin edhe degët e ndonjë mani a ndonjë kumbulle që e bëntë edhe më të mistershme pamjen matanë. Kujtoni këtu këngën e famshme popullore, ku djali i dashuruar i lutet dikujt, që t’i bëjë të mundur të shikojë atë që e do:

*O me m’i ba rixha kojshisë  
Me ma premun moj njate man  
Aman o aman*

Dhe kjo situatë vazhdon në mënyrë uniforme deri në vitin 1905, kur në Shkodër bie një termet shkatërrues.

Aty për aty shfaqet në qytet një njeri jo i panjohur për njerëzit, që quhet Kolë Idromeno<sup>15</sup>. Kolë Idromeno qe i pari shqiptar që ia doli të ofrojë shtëpinë me shtëpi. Ai projektoi dy rrugët e famshme të Shkodrës dhe veçanërisht mbas vitit 1905, kur ra termeti “i madh”, arriti të themelojë zemrën e një qyteti borgjez si Shkodra: me shtëpitë e ngjitura me

<sup>11</sup> Peters, Marcus. “Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimin dhe kulturën: “Tipografia e Zojës së Papërlyeme” në Shkodër (1870- 1945)”

<sup>12</sup> 50 vjetori i kolegjes Savriane, Shkodër, 1928

<sup>13</sup> Për më shumë shiko Elsie, Robert. “Historia e letërsisë shqipe”. Tiranë 1997. F.224

<sup>14</sup> Mbi Novelat e Mihal Gramenos. Arkivi personal, 1938.

<sup>15</sup> Kolë Idromeno (1860-1939). Arkitekt, fotograf dhe piktor.



katet e para dyqane, katet e dyta për banim dhe me oborre mbrapa. Asnjë qytet tjetër në Shqipëri nuk ngjante me Shkodrën e asaj kohe. Idromeno themeloi një qytet me profil të theksuar tregtar. Elementet urbane të propozuara nga ai marrin një rol vendimtar në jetën e kësaj gjëje të gjallë që thirret qytet. Themelohet kështu një kulturë e re. Neoklasicismi i Idromenos vjen si reagim kundër ndikimit të stilit osman në arkitekturë. Në rreth 60 objekte të projektuara prej tij detajet dhe motivet arkitekturore bëhen gradualisht më të qeta dhe më të thjeshta dhe nxisin shfaqjen e një idiome të re arkitekturore.

Kështu Shkodra nisi të hynte në atë kategori qytetesh që jo vetëm që në gjendje të organizonte evente, të importonte zgjidhje, të kopjonte projekte, por që në gjendje që edhe të ripërpunojnë dhe arrijë në procesin e metabolizmit. Metabolizmi është një kusht i domosdoshëm për mbijetesën e çdo të gjalli ose pothuajse të gjalli. Nga ky kusht nuk mund të përjashtohen as qytetet shqiptare.

Në këtë ese na intereson shtjellimi dhe aplikimi në terrene letrare i një antropologjie e parë vecanërisht në aspektin kulturor. Sepse letërsia ka të bëjë me njerëzit dhe vendet ku ata banojnë. Ajo është një nga elementet që na bashkon dhe përcakton komunitetet, duke i siguruar atyre identitet dhe zë. Në botën tonë gjithnjë e më të urbanizuar, qytetet kanë një rol unik dhe të pamohueshëm për të luajtur në mbështetjen e letërsisë.

Edhe sot e kësaj dite ne mund të mësojmë nga kjo e kaluar jo fort e largët dhe mund të restaurojmë gjithë çfarë mundemi nga ajo, sepse ne të gjithë duan të jetojnë në një hapësirë, ku e bukura dhe e dobishmja përmbushin njëra tjetrën, ku marrëdhëniet jetësore kalojnë dhe pasurohen nëpërmjet përvojave të këmbimit të së mirës me të bukurën.

Mjedisi përreth Shkodrës mbeti aq baritor dhe i pakontaminuar sa kam dëgjuar prej disa zotërinjve të vjetër, që kanë shërbyer si mësues në malësitë e mbi Shkodrës në fund të viteve '40 dhe përgjatë viteve '50 të shekullit që shkoi, se malësorët nuk dini të shkruanin një letër dashurie në prozë. Ata e përcillnin mesazhin vetëm me vargje.

Por ajo që dua të nënvizoj në këtë është se qyteti nuk është vetëm kompleksi i shtëpive, shesheve, zyra, dyqaneve, rrugëve, parqeve, por një hapësirë jetese, në të cilën njerëzit dhe gjërat gjenden në një marrëdhënie e relacion të veçantë. Ai nuk është thjesht një vendbanim, por një mikrokozmos i hapur e i pajisur me identitet. Ky identitet ka nevojë të formulohet e të identifikohet në dinamikën e vet. Do ishte absurd të flitej për identitetin letrar të Shkodrës po të mos përmendim disa fakte me ndikim të madh estetik, si psh fakti se: në vitin 1856 në Shkodër u realizua fotografia e parë nga maestro Pietro Marubbi; në vitin 1878 në Shkodër u dha koncerti i parë i orkestrës frymore të drejtuar nga maestro Giovanni Canale; në vitin 1880 në Shkodër u dha shfaqja e parë e teatrit “Nata e Krishtlindjeve” shkruar nga maestro Leonardo de Martino; në vitin 1883 në Shkodër realizohet piktura e parë laike “Motra Tone” nga maestro Kolë Idromeno; në vitin 1912 shfaqja e parë e filmit nga maestro Kolë Idromeno. Qenë të gjithë këto faktorë kulturor ato që ndërtuan portretin e një *homo urbanusi* të letërsisë shqipe?

Në një qytet paraindustrial, si Shkodra, ishte koha kur nuk hidhej tutje asgjë. Sendet duhej të jetonin gjatë. E kishin për detyrë. Kështu njerëzit shisnin mend me njëri-tjetrin sesa të vjetra i kishte këpucët apo sa të moçëm i kishte kostumin. “Nuk ka dekë”<sup>16</sup> Një pjesë e konsiderueshme e qytetit punonte ndër shërbime, duke bërë kështu të lindnin dhe të forcoheshin me dhjetëra zanate, të cilat aty për aty dhe më vonë u bënë personazhet që zëvendësuan heronjtë e letërsisë shqipe. Kështu p.sh: ahengxhi, akulllore shitës, berberë, biciklist, bojaxhi, bozagji, fotograf, hidraulik, këpucar, larës leshi dhe qepëse dyshekësh e jastekësh, lustrues mobiliesh, ilustraxhinj, marangoz, peshore, radioteknik, rregullues bravash dhe celësash, rregullues çadrash, rrobaqepës, samarxhi, saraç, pret dhe qepë, lëkura, shtypshkrues, etj

---

<sup>16</sup> Në kuptimin që nuk vdes kurrë.

Kësisoj letërsia nis të çlirojë veten nga barra e heronjëve. Portretet mashkullore bien. Karaktere letraret tashma kanë nevojë të kenë pantelikën e vet. Autorët kujdesen që t'ia ndërtojnë sa më mirë dhe sa më saktë tiparet e tyre antropologjike, psikologjike dhe sociologjike.

Teknikat e arteve të tjera nisin të implementohen edhe në letërsi. Më së shumti vihen re influencat e kinemasë. Migjeni është një ndër bartësit më inteligjent të teknikave të montazhit kinematografik në letërsinë e tij të "re". Mjafton të kujtojmë "novelzën" "Në Kishë" për të kuptuar mekanizmin kinematografik të "zoom in"-it.

## **b. Historia e Qytetit si Histori Letërsie**

Besoj se është me rëndësi të listohen dhe të pranëvihen ngjarjet kryesore politike të gjysmës së parë të shekullit të XX; ngjarjet kulturore, si dhe ngjarjet letrare. Kësisoj mund të shikohen më qartazi varësitë dhe ndërlidhjet midis qytetit dhe letërsisë, por nga ana tjetër edhe pavarësitë relative. Vetëm të para kësisoji, si elemente të ndërvarura e të ndërlidhura mund të shohim sesi sistemi zhvillohet në mënyrë paralele. Do mund të shikohet gjithashtu se asnjë element i sistemit nuk ka identitet jashtë sistemit, sado i largët dhe i parëndësishëm qoftë. Mund të evidentohet gjithashtu fakti sesi ndryshon dhe rritet edhe Qyteti vetë.

Në nivel politik ato çfarë ndodhen në këtë periudhë mund të artikulojnë lehtësisht dhe pa mëdyshje:

1908: Shpallja e Hyrrjetit<sup>17</sup>

1912: Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë;

1913: Rrethimi i Shkodrës nga serbo-malazezët

1916: Hyrja e ushtrive austrohungareze.

1918: Mbarimi i Luftës së Parë Botërore

1918: Protektorati i Pesë Fuqive të Mëdha

1920: Kongresi i Lushnjës dhe qeveria e parë pas Pavarësisë me selinë në Tiranë.

1924: Peshkopi Fan Noli shpallet zyrtarisht kryeministër i Shqipërisë; Po këtë vit, në dhjetor, Ahmet Zogu vjen në fuqi në Shqipëri me një grusht shteti.

1928: Ahmet Zogu shpallet "Mbret i Shqiptarvet".

1937: Njëzetepesë vjetori i pavarësisë së Shqipërisë.

1938: Krijohet Grupi Komunist i Shkodrës.

1939: Italia pushton Shqipërinë.

1940: Krijohet Veprimi Katolik Shqiptar<sup>18</sup>

1941: Krijimi i Partisë Komuniste Shqiptare.

1943: Kapitullimi i Italisë dhe mbetja në Shqipëri e 25000 ushtarëve italianë.

1944: Ardhja e komunizmit.

1946: Shpallet Republika Popullore e Shqipërisë.

Po kështu edhe ngjarjet e mëdha kulturore mund të shikohen shpesh si nënfisha të atyre politike. Letërsia si nënfish i kulturës dhe gjithçka tjetër ndoshta:

1908: Mbahet Kongresi i Manastirit për të vendosur për një alfabet përfundimtar të shqipes.

1909: Themelimi i të përmuajshmes së ilustruar Diturija nga Mid'hat Frashëri; Themelimi i Shtypshkroja Nikaj në Shkodër.

---

<sup>17</sup> Hyrrjeti ishte kushtetuta që e shpallte Turqinë Republikë. De jure dhe de facto kjo duhej të ishte fundi i Turqisë në Shqipëri, një ngjarje kjo me një pritshmëri të madhe dhe që nuk ndodhi.

<sup>18</sup> Veprimi katolik ishte një organizatë që frymëzohet nga idetë e Papa Piu i X dhe Enciklikes së tij "Il fermo proposito" për ta çuar Zotin në ndërgjegjen e njerëzve, në familje e shoqëri, kundër se keqës dhe imoralitetit, komunizmit gjithashtu.

Themelimi i së parës shkollë pedagogjike në Shqipëri, Normalja e Elbasanit;  
 Themelimi i së përjavshmes Dielli të Bostonit nga Fan Noli dhe Faik bej Konica.  
 1913: Themelimi i së përmuajshmes françeskane Hylli i dritës. Ngrihet në Shkodër nga autoritetet austro-hungareze Komisija Letrare Shqype.  
 1919 Krijimi në Shkodër i Shoqërisë Teatrorë Bogdani.  
 1923: Numri i parë i së përjavshmes “Ora e Maleve” në Shkodër;  
 Themelimi i së përmuajshmes fetare e kulturore “Zâni i naltë”.  
 1925: Numri i parë i gazetës Demokratia në Gjirokastër.  
 1929: Themelimi i së përmuajshmes kulturore jezuite Leka në Shkodër.  
 1930: Themelimi i periodikut Neo-Shqiptarismi nga Branko Merxhani.  
 1932: Themelimi në Tiranë i së përmuajshmes Minerva.  
 1936: Themelimi i së përjavshmes kulturore të majtë Bota e re në Korçë; Themelimi në Tiranë i së përmuajshmes kulturore Përpjekja shqiptare.  
 1934: Botimi në Tiranë i së përjavshmes kulturore Illyria.  
 1940: Themelimi në Tiranë i së përmuajshmes letrare “Shkëndija” nga E. Koliqi;  
 Vdekja e At Gjergj Fishtës.  
 1944: Themelimi i së përdyjavshmes letrare Revista letrare;  
 Numri i parë i së përmuajshmes letrare Kritika nga Arshi Pipa;  
 1945: Themelimi i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, kryesuar nga S. Malëshova.

Dhe ndërkohë që ndoshin gjithë këto ngjarje dhe vendi prodhon gjithë këtë histori, Qyteti, nisi të selisë bijtë e vet intelektualë, artistë dhe shkrimtarë. Edhe në kohën kur u duk se paratë e dhëna për zgjimin kulturor shqiptar nga ana e qeverisë austro-hungareze sosën me mbarimin e vetë Perandorisë, në fund të Luftës së Parë Botërore, inercia e projekteve të tyre mesa duket vijoi, sepse Perandoria nuk u shkërmoq për një ditë të vetme dhe aq më pak strategjitë e saj afatgjate.

Kësisoj edhe në Shkodër vijuan krijimi i institucioneve kulturore, që kishte në fokus demokratizimin e kulturës. Pra kultura iu la në dorë shtresës së mesme e poshtë. Qenë kryesisht zejtarët ata që themeluan shoqatat kulturore, klubet muzikore, bandat, sallat e teatrove dhe të ballove. Qenë ata që hodhën themelet e shëndosha të bashkëjetës fetare, duke nisur me klubin “Vllaznia” më 1919.

Në këtë atmosferë gjimnazistët e rinj morën bursat e para për të studiuar jashtë vendi dhe për t’u kthyer më vonë me dëshirë të madhe në Qytet. Kësisoj “amoku” i ndërtimit të Qytetit kapi të madh e të vogël.

Në nivel kombëtar veprat letrare të botuara aso kohe (1900-1945) dhe që kanë lidhje të drejtpërdrejta me qytetin si vendveprimi dhe si mentalitet dhe që ndikuan fuqimisht në sendërtimin shpirtëror të kësaj structure, ishin:

**Në dramaturgji:** Mihal Grameno me komedinë me tri akte “Mallkimi i gjuhës shqipe”, Bukuresht 1905. Andon Zako Çajupi me “Burr’ i dheut” dhe komedinë me një akt “Pas vdekjes”; Fan Noli me dramën me tri akte “Israilitë dhe Filistinë”, Boston 1907. Gjergj Fishta me “Shqiptari i gjytetnuem” dhe “Juda Makabé”, Shkodër 1923, Milo Duçi me pjesën me tri akte “E thëna”, Kajro 1922; Kristo Floqi me farsën me katër akte “Qërthulli politik”, Tiranë 1922 dhe tragjedinë me pesë akte “Pirro Neoptolemi”; Zef M. Harapi me tragjedinë “Mustafa Pasha i Shkodrës”; Haki Stërmilli me “Dibraneja e mjerueme”, Tiranë 1923, “Dashuni e besnikëri”, Tiranë 1923, “Agimi i lumnuëshëm”, Tiranë, 1924. Mehdi bej Frashëri me tragjedinë me pesë akte “Trathëtia”, Tiranë 1926. Kostandin Kote me pjesën me tri akte “Shperblimi i gjaksís”, Zadar 1929. Etëhem Haxhiademi me “Ulisi”, “Akili”, “Aleksandri”, Tiranë 1931. Lazër Lumezi me komedinë me një akt “Makaronat e shejtanit”. 1935.

**Në poezi:** Gjergj Fishta me “Anxat e Parnasit”, Sarajevë 1907, vargje satirike dhe me “Gomari i Babatasit”, Shkodër 1923, vargje satirike.; Hilë Mosi me “Lotët e dashnís”, Shkodër 1916; Ndre Mjeda me “Juvenilia”, Vjenë 1917; Ernest Koliqi me “Kushtrimi i

Skanderbeut”, Tiranë 1924, me “Gjurmat e stinve”, Tiranë 1933, si dhe me “Symfonia e shqipevet”, Tiranë 1941; Vinçenc Prennushi me “Gjeth e lule”, Shkodër 1924; Hilë Mosi me “Lule prendvere”, Tiranë 1927; Asdreni me “Psallme murgu”, Bukuresht 1930; Lasgush Poradeci me “Vallja e yjve”, Bukuresht 1933; Filip Shiroka me “Zâni i zëmrës”, Tiranë 1933; Nexhat Hakiu me “Këngët e zambares”, Tiranë 1939; Etëhem Haxhiademi me “Lyra”, Tiranë 1939; Ali Asllani me “Hanko halla”, Tiranë 1942; Fan Noli me “Mall e brengë”, Tiranë 1943. Migjeni me botimin e dytë të “Vargjet e lira”, Tiranë 1944; Shevqet Musaraj me “Epopeja e Ballit Kombëtar”, Tiranë 1944; Arshi Pipa me “Lundërtarë”, Tiranë 1944.

**Në prozë:** Mihal Grameno me “Oxhaku”, Selanik 1909, “E puthura”, Selanik 1909, dhe “Var’ i pagëzimit”, Korçë 1909; Ndoc Nikaj me “Fejesa n’djep a se Ulqini i mârrun”, Shkodër 1913, “Shkodra e rrethueme”, Shkodër 1913, dhe me “Lulet n’thes”, Shkodër 1920; Mid’hat Frashëri me “Hî dhe shpuzë”, Sofje 1914; Zef Mark Harapi me “Pushka e trathtarit”, roman, Shkodër 1914; Foqion Postoli me “Për mbrojtjen e atdheut”, 1921; Milo Duçi me “Midis dy grash”, Kajro 1922; Mehdi bej Frashëri me “Nevruzi”, Tiranë 1923; Foqion Postoli me “Lulja e kujtimit”, 1924; Ernest Koliqi me “Hija e maleve”, Zadar 1929 dhe me “Tregtar flamujsh”, Tiranë 1935; Nonda Bulka me “Kur qan e qesh bilbili”, Korçë 1934; Sterjo Spasse me “Psel?”, Korçë 1935 dhe me “Afërdita”, 1944; Vedat Kokona me “Yje të këputur”, Tiranë 1940; Musine Kokalari me “Siç më thotë nënua plakë”, Tiranë 1941 dhe me “... sa u-tunt jeta”, Tiranë 1944; Mitrush Kuteli me “Ago Jakupi e të tjera rrëfime”, Tiranë 1943 dhe me “Kapllan Aga i Shaban Shpatës”, Tiranë 1944; Haki Stërmilli me “Sikur t’isha djalë”, Tiranë 1936;

**Në publicistikë dhe studime letrare:** Shtjefën Gjeçovi me “Agimi i gjytetnisi”, Shkodër 1910; Gaetano Petrotta me “Popolo, lingua e letteratura albanese”, Palermo 1932 (Popull, gjuhë dhe letërsi shqiptare). Shtjefën Gjeçovi me “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, Shkodër 1933; Justin Rrota me “Letratyrë shqype”, Shkodër 1934; Eqrem Çabej me “Për gjenezën e literaturës shqipe”, Shkodër 1938-1939. Namik Ressuli & Karl Gurakuqi (red.) me “Shkrimtarët shqiptarë”, Tiranë 1941.

Siç shihet edhe pse një pjesë e madhe e tyre nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me qytetin e Shkodrës, prapëseprapë ishin pjesë e të njëjtit sistem letrar. Nga ana e vet ky sistem letrar paraqitet si element i një sistemi tjetër më të madh, siç ishte ai politik, e që po zhvilloheshe asaj kohe me intensitet për të lartë.

### c. Tre poetët e Qytetit

Në Shkodër, brenda dy-tre dekadash grumbullohet një numër i konsiderueshëm artistësh në të gjitha lëmitë e veprimtarive artistike. Kishim Muzikantë (kompozitorë dhe instrumentistë); Dramaturgë, regjisorë dhe aktorë; Piktore, skulptorë dhe fotografë; Arkitektë; Bibliotekarë dhe koleksionistë; Shkrimtarë, botues dhe përkthyes të klasit të parë. Por ajo cka është më e rëndësishmja qëndron te fakti se kësaj oferte I përgjigjet një kërkesë gjithnjë e më e madh dhe më aktive.

#### **Gjergj Fishta (1871-1940)**

I vetmi person që ia del të jetë me dy këmbë, një në patriotizëm dhe një në bashkëkohësi mbetet Fishta. Gjithë çka lartëson me epikën e vet, e propozë me satirikën e tij. Aq sa ishte *homo ruralis* në epikë, aq ishte *homo urbanus* në satirikë. Fishta ndoshta është i pari që e kupton se aftësia homogjenizuese e qytetit, në këtë rast Shkodrës, duhet të shoqërohet me nevojat e kërkimit të një identiteti dinamik qytetar.

Fishta ishte katundar prej Zadrimë, ku shkonte të veronte çdo vit te njerëzit e farefisit të vet, bujq e blegtorë, të cilët vazhdimisht, si rrjedhojë e kontradiktës historike, vinin në qendër të hokave të tyre “dobiçat e qytetit që notojnë në ”auera medicritas”. Ai njohu në këtë

mënyrë, anën komike të jetës së katundarit dhe tragjiken njëkohësisht, gjithmonë të nëpërkëmbur nga “dobiçat e qytetit” e zyrtarët e vegjël. Fishta jetoi në Shkodër, në qytetin ku në çdo kënd të hapësirës së vet dhe në çdo çast të kohës, gjen të qëndrojnë pezull ajo valë humori therëse, gjithnjë kundërshtarë e inteligjente. Fishta në Shkodër ishte miku i vazhdueshëm i gostive të shkodranëve, ku vlonin bejtat e barcoletat. Një ndër miqtë më të ngushtë të tij ishte roja i Kuvendit Françeskan, një hokatar i regjur, me të cilin Pater Gjergji luante cic-mic dhe regjistronte në kujtesë të shara pazari.

Gjeografikisht, vepra letrare e Fishtës, u përket hapësirave të ndryshme. Epika, merret me malin shqiptar e banorët e tij; Dramatika paraqet një gjeografi joshqiptare; Lirika, si një gjini pa një gjeografi të caktuar; Satira gjeografi tjetër të përcaktuar. Në të gjallon qyteti shqiptar me të gjitha shtresat e veta sociale, qyteti bashkëkohor shqiptar i Fishtës e posaçërisht dy prej tyre, siç janë Shkodra e pjesërisht Tirana. Bashkëkohësia e veprave satirike është e qartë, e drejtpërdrejtë. Unë nuk njoh ndonjë autor tjetër në letërsinë shqiptare, që të jetë marrë aq seriozisht me realitetin e kohës së vet, me anët më të errëta të këtij realiteti, sesa Fishta me veprën e tij satirike.

Fishta ndër satirat e veta është mjaft i ashpër e idhnak. Vihet re lehtë se si ai ndjek natyrën popullore, e cila ndjen nevojën e shfrimeve të tilla. Ai duke ndjekur këto modele, fillon operimin letrar nga humorizmi dhe karikatura, deri tek sarkazma që përfundon në invektiva. Kjo prirje shqiptare e poetit, shprehet ndër skema krejt popullore e të kuptueshme prej gjithkujt, aq sa popullaritetin më të madh, ia dha atij ajo shtresë analfabete e kombit, që e quante me metaforën kuptimplote e plot humor: “Fishta me bishta”.

Në lidhje me këtë mision civilizues dhe emancipues të Fishtës, poeti ynë i shquar Lasgush Poradeci, në një artikull përkujtimor<sup>19</sup>, botuar pas vdekjes së Fishtës, do të shprehej: “Veprimi krijimtar i Gjergj Fishtës, i këtij krijuesi kombëtar të vetëdijshëm, prej kombësisë shqiptare të pavetëdijshme, është ay i endjes; së pari, nëpër Purgatorin e vetvetes spastronjës, ay i faljes në Adhurimoren e Mendimit të Kombit. Si një kushtimtar i vyer për punën e kushtimit të tij, na pat bërë Fishta, vetë ay me gazin e fjalës së vet, këtë Apokalipse të madhe shqiptare.”

Ja si i shkruan një sivëllai të vet, Pal Dodës, që në agim të shekullit të XX: “...sepse është njëlloj sikurse të fitojmë me të pamundurën, po aq e pamundur është edhe dëshira për të pasur një Atdhe sipas idealit tonë. Ç’po bëhet me këtë Atdhe? Të marrët, dinakët, dembelët, njerëzit e privuar nga çdo lloj virtyti, po mbeten në krye prej prapaskenave të mirëbërësave të tyre, atyre që janë të interesuar... Dhe nga qyteti duhet të nisen impulset e progresit civil dhe ekonomik të kombit. Por unë them se është mjerim i madh, nëse fshatrat dhe malësitë tona bëhen sikurse qytetet tona-ku i vihet flaka qytetërimit!

Po është e vërtetë se nuk mund ta bëjnë Atdheun këta burra mikroskopikë...që janë mikrobet e polmoneve të Kombit e që po i shtien veremin faunës së shpirtit, në atë mënyrë, që Shqipëria jo shumë vonë, do të mbetet vetëm një kufomë e kalbur për të shuar urinë e bijve llafazanë të Ausonisë, të shqiponjave grabiqare të Danubit, apo ajo çka është edhe më e keqja e të këqijave, të ujqve dhe arinjve të Ballkanit!<sup>20</sup>

Kryesisht Fishta merret me publikën e Qytetit. Ai demaskon institucionet, politike më së pari e mandej satira e tij ndërhyjnë deri te zyrtat e parlamentit, shkollat, zyrtat e institutet botuese, etj. etj.

I shfaqur si autor i qytetit që në vitin 1907, me veprën “Anzat e Parnasit”<sup>21</sup>, i rikonfirmuar më pas me “Gomarin e Babatasit”<sup>22</sup> dhe deri të veprat e mbetura në dorëshkrim, si “Visku i Babatasit”<sup>23</sup> dhe “Shtjelmat e Pegasit”<sup>24</sup>

<sup>19</sup> Poradeci, L. “At Gjergj Fishta, vazhdimtar në Mendimin e Kombit”. Tomorri i vogël. Tiranë, 1 kallnor 1943.

<sup>20</sup> Leter drejtuar At Pal Dodës, më 13 tetor 1907.

<sup>21</sup> “Anzat e Parnasit”

Personazhet e Fishtës janë “qytetarët e rinj”, ata të cilët në emër të “modernes” duan të shkatërrojnë gjithcka që trashëgojnë nga e kaluara. Personazhet e Fishtës, si Palokë Cuca me shokë janë tipat që nuk e kanë për asgjë të vënë në pikëpyetje vlerat primordiale të kombit tonë. Nga kjo pikpamje mund të themi se Fishta kërkon një qytet, i cili nuk jeton si një bullist, duke tallur krijesat e veta...

### **Ernest Koliqi (1903-1975)**

Ernest Koliqi ishte një nxënës i dalë nga tradita e shkollës letrare shkodrane jezuite dhe i kultivuar nëpër qendra universitare, siç ishin ato italiane. Ai u selit si individualitet me një mendim të kultivuar letrar dhe në korrent me atë çfarë po ndodhte ndërkohë në Europë. Ai është një nga themeluesit e letërsisë sipas strukturave moderne, duke nxjerrë njeriun e thjeshtë, qytetasin, në plan të parë të individualitetit të tij, të projekcionit të tij individual.

Ai bëhet themeluesi i prozës moderne shqipe, si në aspektin tematik ashtu edhe në atë stilistik.

Në vëllimin “Hija e maleve” (1929) trajton tema që kanë rrënjë në moralin e malësisë, të cilat, me tragjicitetin e vet, përballen me jetën qytetëse. Në vëllimin “Tregtar flamujsh” (1935) trajtohet jeta e qytetit të Shkodrës, shpaloset mentaliteti i vendit, harmonia e jetës, përshkrimi i personazheve që përfaqësojnë shtresa dhe mentalitete të ndryshme shoqërore. Në prozën poetike “Pasqyrat e Narçizit” (1936) autori, në shtatë variante, shpalos shpirtin e tij, na shfaqet qytetari modern në kërkim të atdheut metafizik.

Rasti Koliqi është tipik për të konkretizuar teorinë më të fundit të Dominique Maingueneau-së, se në entitetin “krijues-autor” barten tri entitete përbërëse që i japin jetë krijimtarisë: personi fizik, shkrimtari dhe qenia tekstore a nënshkruesi në tekst. Emërtimi “person” i referohet individit të pajisur me të dhënat e një gjendjeje civile, të një jete vetiake, private; “shkrimtari” tregon aktorin që përvijon një trajektore në institucionin letrar; ndërsa “nënshkruesi” tregon thënësin në tekst, subjektin e procesit të të thënit që bart e transmeton njëherazi edhe statusin e përvijuar ndërkohë të individit biografik e shkrimtarit në fushën letrare”<sup>25</sup>.

Te Koliqi kështu kemi personën njerëzore: Koliqin atdhetar, Koliqin fashist, Koliqin arsimdashës, por edhe Koliqin shkrimtar. Brenda këtij të fundit gjendet Hilush Vilza, uni i tij letrar, apo zëri i tij.

Në vëllimin “Hija e maleve” (1929) trajton tema që kanë rrënjë në moralin e malësisë, të cilat, me tragjicitetin e vet, përballen me jetën qytetëse. Në vëllimin “Tregtar flamujsh” (1935) trajtohet jeta e qytetit të Shkodrës, shpaloset mentaliteti i vendit, harmonia e jetës, përshkrimi i personazheve që përfaqësojnë shtresa dhe mentalitete të ndryshme shoqërore. Në prozën poetike “Pasqyrat e Narçizit” (1936) autori, në shtatë variante, shpalos shpirtin e tij, na shfaqet qytetari modern në kërkim të atdheut metafizik.

Edhe në ekzil Koliqi merret pafundësisht me qytetin, jo si prani fizike tashmë, por si mungesë apo si prani transhedentale. Si romani “Shija e bukës së mbrucime” (Romë, 1960), po kështu edhe drama “Rrajët levizin” e vitit 1970. E vertetojnë këtë që po themi. Eksperienca njerëzore e Koliqit në raport me Qytetin është shumë e komplikuar. Sa kohë që ishte në Shqipëri përpiqet ta universalizojë atë, kur largohet nisë t’i mungojë atdheu, qyteti i vet: Shkodra

---

<sup>22</sup> “Gomari i Babatasit”

<sup>23</sup> “Visku i Babatasit”

<sup>24</sup> “Shtjelmat e Pegasit”. Revista “Hylli I Dritës”. Shkodër, nr.2, 2022

<sup>25</sup> Dominique Maingueneau, *Le discours littéraire, Paratopie et scène d’énonciation*, Armand Colin, 2004, 2014, faqe 107-108.

## Milosh Gjergj Nikolla (1911-1938)

Migjeni, bëhet autori më i ri i kohës, që me veprën e vet trajton botën intime të personazheve të tij të dashur. Migjeni shkroi dy vepra kryesore, “Vargjet e lira” në poezi dhe “Novelat e qytetit të veriut” në prozë. Ai arrin të botojë në shtypin periodik disa nga vjershat e tij, si dhe disa proza të shkurtra që i ka quajtur edhe “novelëza”.

Të tre shkrimtarët tanë, shkrimtarët e Qytetit janë të pakënaqur më Qyteti. Por personi më i pakënaqur me Qytetin nga të tre shkrimtarët, është padyshim Migjeni. Migjeni, ashtu tuberkuloz, duke pirë kafën e vet më një filxhan të personalizuar në Kafe Adriatik, rri vetëm dhe heshton. Ai e shikon qytetin nga jashtë brenda. Është i parehatuar. Ai tallet jo vetëm me të, por edhe me disa situata urbane satelite edhe më të vogla: “Në një katund që don të quhet qytet. Stacioni i fundit automobili. Mbrapa nga lindja s’ka ma rrugë të gjana, por rrugë kuajsh. Njerëzit që vijnë në këto anë, vijnë vetëm nga shtrëngesa e jetesës. (Mund të shifet edhe ndonjë turist i huej). Një ditë kur automobili i postës nisej nga katundi që don të quhet qytet, për qendër prefekturë, erdhi në mes dy gjindarmve, një grue me durr lidhë”.

Te “Studenti në shpi” Migjeni na përshkruan një personazh të nisur për tu bërë evropian, që pa dashje mbart brenda vetes edhe njeriun shqiptar me gjithë ekzistencën shumëshekullore. Ai është totalisht i habitur me shpinë e tij, si një qelizë e gjallë e këtij Qyteti. “A mundet me qenë ky oborri që e lash para tri vjetësh?! Kaq i vogël, më bahet se nuk ishte. Asgja e re. Po ato pemë: hardhia, fiku, kumbulla. Po ato lule. Që atje drandofillja e pak ma tej lulemustaku. Dhomat po m’bahen shumë të vogla. Mobiliet si mos me i pasë prekë dora e njeriut. Gjithçka në vendin e përparshëm, si me qenë të destinueme dhe me u kalbë po n’ato vende. Po gjithçka, gjithçka disi e zvoglueme, vetëm vllaznit e motrat janë rritë, ma të mdhajnë sesa i paraftyroja kur i kujtoja përjashta. Nanës i ka ramë një dhamb, e baba paska fituem do rrudha në ball dhe thija në mustakë. Un e due kët votër, ma mirë me thanë këto gjind rreth votres, prindët, motrat e vllaznit, por diçka si ma e fortë më lidh edhe për ato vise. Ato vise ku jeta impulsive të lejon ta shijosh dhe si i ri dhe si plak, si filozof ose si njeri i thjeshtë.. E urrej të kaluemen që asht aq e afërme, si baba jem. Baba asht i afërm, si babë, por i largët si përfaqësues i shoqnis, si person. E gjithë mosmarrveshja, te gjitha moskuptimet vijnë ngase te gjithë kemi nëpër shtëpia, nëpër votra, ka një ose ma tepër të këtyllë të dashtun dhe t’urretun përnjëherësh. Çashtja me ta qendron si çashtja e një operacioni: ose ta presish kambën dhe të rrosh, ose mos ta presish kambën dhe të vdesish. Kush ka pasë fat me iu smund ashtu kamba, njat të dalun ka.

Migjeni e shikon Qytetin si një *Big Brother* i tij. Ashtu i sëmurrë dhe asocial sic ishte, mbetet i lidhur dhe shumë i shqetësuar me njerëzit e racës së vet. Te poezia e tij e famshme “Një natë pa gjumë”, matanë dritës së ndezun të dhomës së vet, që ndricon zbehtë edhe rrugën boshe bri shtëpisë, Migjeni *urren e din ç’urren, don e s’din se ç’don*.

### Bibliografia

50 vjetori i kolegjes Savriane, Shkodër, 1928

Ben Lewis është një gazetar i famshëm i BBC, fitues i mjaft çmimeve dhe bashkëpunëtor i rregullt i “Evening Standard” dhe “Sunday telegraph”

Bergson, Henri. “E qeshura”, Tiranë, 2015, f.117

Dominique Maingueneau, Le discours littéraire, Paratopie et scène d’énonciation, Armand Colin, 2004, 2014, faqe 107-108.

Wirth, Louis. Urbanism as a Way of Life”: American Journal of Sociology (1938). The City Reader Edition 5th Edition, First Published, Routledge 2011

Elsie, Robert. “Historia e letërsisë shqipe”. Tiranë 1997. F.224

Fjalimi i plotë i udhëheqësit sovjetik Nikita Hrushov. Gaz. “Sot” 3 mars 2018

Howe, Irving. "A voice still heard", Selected Essays. Yale University Press, London, 2014. F. 162.

Kavafis, Kostandin. "Qyteti", poezi. Përktheu Primo Shllaku.

Marashi, Ardian. Pole koliqiane: në kolanën "Studime Shqiptare", nr.3, Universiteti i Shkodrës, 1995; ribotim i përmirësuar tek "Hylli i dritës", nr.3-4, Tiranë 1996.

Marx, Karl. Deutsch-Französische Jahrbucher, 1884

Poradeci, L. "At Gjergj Fishta, vazhdimtar në Mendimin e Kombit". Tomorri i vogël. Tiranë, 1 kallnor 1943.



**Arben PRENDI**

**KOLIQUI, TREGIMTARI DHE NOVELISTI MODERN**

**Koliqi, interpret i psikës së shqiptarit**

Ernest Koliqi është pranuar tashmë në studimet letrare të këtyre viteve si krijues i shumanshëm që u dallua, si poet, prozator e dramaturg, studiues i letërsisë së shkruar dhe asaj gojore, eseist, themelues revistash, përkthyes, hartues antologjish dhe për disa vite me radhë profesor në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe të Universitetit të Romës “La Sapienza”, themelues i Institutit të Studimeve Shqiptare etj. Koliqi, siç shprehet studiuesi Anton Berisha është “personalitet i shumanshëm dhe shumëfish i rëndësishëm i kulturës sonë” apo siç cilëson shkrimtari Martin Camaj: “shtyllë e shkrimit shqip”. Po ashtu përcaktimi që Koliqi përdor për Fishtën si: “interpret i shpirtit shqiptar”, mund të përdoret me të njëjtin qëllim për atë vetë, Koliqi është interpret i psikës së shqiptarit. Vepra e këtij krijuesi është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me botën shqiptare, ajo është pjesë e ndikimit jo vetëm artistik por edhe shoqëror, ndërsa ishte analizuuese, zhbiruese e vlerësuese e përhershme e saj. Vepra e Koliqit është pritur me interes në kohën e botimit të saj dhe tani. Në të gjitha studimet është nënvizuar shumanshmëria e veprës dhe roli i këtij autori në lëvrimin e tregimit dhe novelës shqiptare, si themelues dhe krijues i tregimit dhe novelës moderne shqipe.

Në novelat dhe tregimet e tij “Hija e maleve” (1929) dhe “Tregtar flamujsh” (1939), përmes rrëfimit artistik që është parësor për prozatorin, Koliqi zbërthen psikologjinë e shqiptarit të kohës, pengesave dhe vështirësive të tij për t’u përfshirë në rrjedhën e qytetërimit dhe përparimit shpirtëror e material; pengesave kulturore e psikologjike në radhë të parë, pastaj edhe të pengesave sociale dhe historike.

Këtë e dëshmon edhe bota e pasur e personazheve të novelave, tipat dhe karakteret, përkatësia e tyre nga të gjitha shtresat dhe moshat e shoqërisë. Malësorë e qytetarë, fshatarë e intelektualë të shkolluar në universitetet perëndimore, tregtarë e rruftanë politikë, mësues e meshtarë, materialistë e idealistë, gra dhe burra, të rinj e të reja; një arkiv artistik i botës psikologjike të shqiptarit verior, të gjysmës së parë të shekullit XX. Përmes këtyre personazheve, Koliqi tenton të analizojë një tranzicion të rëndësishëm për shoqërinë shqiptare dhe mentalitetin e saj, shkëputjen nga shumë forma dhe rregulla të jetës tradicionale malësore apo tradicionale qytetare dhe përfshirjen në qytetërimin e ri modern me orientim europiano-perëndimor, qytetërim me të cilin Shkodra i ka pasur lidhjet gjithnjë të afërta, qytetërim prej të cilit Shkodra është ushqyer me kulturë dhe modele. Dhe për Koliqin ashtu si për Konicën problemi është tek psikologjia e individit, i cili duhej të shkëputej nga rëndesa e modelit të jetës tradicionale, nga rëndesa e elementëve negativë të këtij modeli, për të përqaftuar një model më bashkëkohor që ka në bazë kulturën e jetës dhe jo atë të vdekjes. Jo rastësisht personazhet konfliktohen për këtë arsye, pse kjo është çështje jetike, çështje zhvillimi dhe emancipimi; arsye e mjaftueshme që shqiptari të mbetet me sahat te koha e Kanunit të Lekë Dukagjinit, apo edhe më keq, te sahati i kohës së perandorisë turke. Në prozën e Koliqit, vihen re elemente të simbolizmit dhe psikanalizës, por këto elemente nuk janë thelbësore, dhe të qëllimshme. Ato më shumë duhen parë siç thotë studiuesi Anton N. Berisha, në një rrafsh më të gjerë, për arsye se botën e brendshme të individit, kontekstet e ngjeshura e të tendosura dhe shqiptimin e ndjesive shpirtërore, i ndeshim të trajtuara në mënyra të ndryshme edhe në krijimet e letërsisë gojore në përgjithësi, apo në letërsinë gojore shqiptare, para se sa të lindte teoria e psikanalizës dhe freudizmi. Anton Berisha edhe disa shenja të simbolizmit në prozën

e këtij autori, i lidh me simbole të trashëgimisë sonë letrare ose mitologjike, që në prozën e Koliqit janë funksionalizuar në mënyra të ndryshme.

Dilemat dhe pikëpyetjet psikologjike të shqiptarit, shkrimtari i vesh artistikisht me elemente mistike apo misterioze, në funksion të rrëfimit, që sigurisht ka parësor anën artistike, por edhe në funksion të shpjegimit të embrionit të neurozave psikologjike të personazheve. Sikurse Frojdi nënvizon rëndësinë e fëmijërisë në jetën njeriut, ashtu Koliqi artistikisht i drejtohet botës së hershme shqiptare; besëtytnive, riteve, miteve, përrallave, legjendave, figurave mitologjike, rregullave kanunore që bënë jetë të gjallë, në popull për shekuj; si “fëmini” e psikes së personazheve. Personazhet nuk mund të interpretohen as nuk mund të kuptohen pa këtë shtresë të personalitetit të tyre, që megjithëse nuk është në vetëdije sepse kohët kanë ndryshuar, gjendet ende në pavetëdije, në formë primitive.

Elementet nga bota parake shqiptare në aspektin psikologjik, marrin funksione simbolike. Ngjyrimin në jetën e gjallë në popull i shtohet edhe një ngjyrim simbolik, me natyrë artistike dhe psikologjike që shndërrohet edhe në një kod për zbërthimin e neurozës emocionale, psikologjike të personazheve. Shkrimtari bashkon kështu një projektim tredimensional, të botës së personazhit, ku dimensionin e parë është ai primitiv, në pavetëdije, dimensionin e dytë ai i përjetimeve dhe ndijimeve, mendimeve të momentit dhe dimensionin e tretë një përzierje e tyre, që prodhon një kaos shpirtëror dhe psikologjik prej të cilit pasojnë neuroza me pasoja të rënda, por edhe veprime tragjike, siç ndodh me personazhin kryesor të novela “Gjaku”. Konica të “Një ambasadë e zulluve në Paris” (1924), ashpërsisht i stigmatizonte bashkatdhetarët e vet si një turmë zullujsh, që nuk ishin në gjendje të bëhen komb, kurse Koliqi të njëjtën kërkesë e shtron në novelën “Gjaku” në mënyrë më të rafinuar: “A ka send ma të mrekullueshëm në këtë botë se me i sjellë qytetnimit një kombi zhytë në errsinën e padijes?” duke e parë çështjen e daljes nga errësira e traditës negative dhe e kapërcimit të modelit moral të traditës si një çështje parësore për njeriun dhe shoqërinë shqiptare. Personazhet që marrin përsipër një mision të tillë kalojnë përvoja dramatike dhe tragjike, që janë në fakt edhe përvojat dramatike dhe tragjike të intelektualit apo të riut shqiptar në realitet. Ata duhet të kalojnë nëpër unazën e zjarrtë të konflikteve të shumëfishta: së pari me veten, instinktet e vjetra që nuk janë shtypur plotësisht nga kultura, së dyti me mjedisin, të afërmit, shoqërinë, së treti me institucionet morale apo institucionet inekzistente të shtetit të ri. Por për shkrimtarin, ndoshta konflikti i parë që duhet zgjidhur është ai psikologjik, brenda njeriut, ku flenë instinktet e vjetra të shtypura përkohësisht në pavetëdije, por që me t’u dhënë rasti dalin me agresivitet dhe në mënyrë të paparashikueshme në sipërfaqe, në vetëdije siç do të thoshte Frojdi. Mësuesin Doda të novela “Gjaku”, pikërisht se i ka shtypur këto instinkte, rrezikon të shndërrohet i papranueshëm për mjedisin ku jeton.

Përplasja në këtë novelë është kontrastuese dhe e lashtë: ajo mes dritës, (qytetërimi, kultura) dhe errësirës (padija, zakonet negative). Mësuesi Doda frymëzohet nga “drita”, kultura e jetës, dija e marrë në universitet, mjedisi i tij nga “errësira”, padija, instinkti, tradita negative, që çojnë në takim me vdekjen. Koliqi si personazhi i tij mendon se arsimit, kultura, janë një mjet i rëndësishëm për ta shkëputur shoqërinë shqiptare nga tradita negative, një mjet i rëndësishëm për të rritur brezin e ri me një botëkuptim tjetër.

Vrasja e vëllait, e vendos heroin në një pozicion të vështirë, të cilin as e mendonte ndonjëherë. Ky moment shërben edhe një herë, për një projektim tredimensional të personazhit. Aty zbulohet bota e tij shpirtërore, reale. Realiteti i plagos njerëzit idealistë atëherë kur nuk e presin dhe atyre u duhet ose të luftojnë deri në fund, ose të kapitullojnë. “Diçka zgjohej në shpirt të tij, diçka që deri atë ditë kishte fjetë në fundet e errëta të pandërgjegjes”- përshkruan trazimin psikologjik të personazhit, ndërsa kujtimi i vëllait të vvarë e mundon.

Ky përshkrim i qartë psikoanalitik më kujton një përcaktim të Frojdit për natyrën psikologjike të njeriut: “Çdo jetë pra është e dyfishtë. Poshtë në pavetëdije ne ekzistojmë në

tërësinë tonë, ne jemi e Dikurshmja dhe e sotmja, njeriu primitiv dhe ai i qytetëruar, përzjerje e turbullt ndjenjash, mbeturina arkaike të një Uni më të gjerë të lidhur me natyrën lart, në dritë të kthjellët e të fortë ne jemi vetëm Uni i vetëdijshëm që ekziston në kohë”. Doda, i pushtuar nga këto përzjerje ndjenjash kontradiktore bëhet edhe personazh tragjik. Qëllimi i jetës së tij: qytetnimi i vendit të tij, mbetet një projekt i ndërprerë, ndaj të cilit ai është edhe i gatshëm të flijohet, siç edhe flijohet në fund të novelës, duke u dorëzuar vetë në xhandarmëri pasi vret gjaksin e tij, me qëllim që shteti të nisë të funksionojë, kjo në fakt e dallon nga një gjakmarrës i zakonshëm. Doda nuk është një gjakmarrës i rëndomtë, por beteja që zhvillohet në të përfundon në favor të zakonit, kundër qytetnimit dhe vetë ideve të Dodës, që thotë se “gjaksor janë të gjithë ata që derdhin gjak njeriu”.

Te Koliqi, nuk mungon kritika e ashpër për të metat e përparimit shpirtëror dhe atdhetar të shqiptarit, në mënyrë të dallueshme në novelat “Gjaku” dhe “Tregtar flamujsh”. Te “Tregtar flamujsh”, Koliqi me personazhin e tij të preferuar: të riun ëndërrimtar e idealist që kthehet nga studimet jashtë shtetit me ndjenjën e mallit për atdheun dhe përgjegjësinë për t’i shërbyer familjes por edhe atdheut; (kuptojmë këtu “Studentin në shtëpi” të Migjenit) e qesëndisë pa kompromis mentalitetin anadollak, të tregtarit të vogël që s’lë asgjë pa shitur vetëm e vetëm që të pasurohet sadopak, shet edhe flamuj kombëtarë... Flamuj të cilët nuk po i shiteshin, dhe për këtë fajëson poetin e ri, mësuesin që nuk u ngjallë njerëzve ndjenjat e duhura atdhetare. Sa më shumë ndjenja atdhetare aq më shumë flamuj të shitur, aq më shumë fitime për tregtarin e vogël, që mbetet në këtë mënyrë edhe më i vogël dhe më i cekët. Ky tregtaruc, siç thuhet në Shkodër, me këtë tregim hyn në ligjërimin artistik dhe publicistik shqiptar si simbol i gjithë asaj kategorie njerëzish, që për interesa personale janë gati të shesin gjithçka, qytetin e tyre, atdheun, gjuhën, flamurin... çdo gjë që mund të blihet.

Ndërkaq disa tregime elementin mistik apo mitologjik e kanë pikërisht si element simbolik që zbërthen kodin e gjendjes shpirtërore - psikologjike të personazheve. Të tilla mund të jenë, “Nusja e mrekullueshme”, “Kur orët lajmojnë”, “Zana e fundme”. Veçanërisht “Nusja e mrekullueshme” është një tregim lirik në të cilin elementi mitologjik fsheh neurozën e “dashurisë së pamundur” të malësorit shqiptar, ose të dashurisë si “sekret” mistik.

### **Përfundime**

Koliqi tashmë është shkrimtar i rëndësishëm në historinë e letërsisë sonë, veçanërisht në historinë e prozës. Si prozator modern, Koliqi sjell në prozën shqipe të gjysmës së parë të shek. XX risi në formë, në tematikë dhe përmbajtje. Strukturën e tregimit, novelës, e përsosi nga pikëpamja kompozicionale, si asnjëherë më parë në prozën shqipe, duke u mbështetur së pari në përvojën e prozës shqiptare dhe europiane, veçanërisht asaj italiane dhe së dyti në modelin e rrëfimit gojor shqiptar. Ndërsa nga ana tematike ai e pasuroi prozën e këtyre viteve me një larmi temash, që nga tema intime e deri te tema sociale.

Në përmbajtje analizohet bota e brendshme plot dilema dhe kundërshti e njeriut shqiptar dhe njëkohësisht bota morale, psikologjike e shoqërisë shqiptare. Zbulesa psikologjike e qenies njerëzore është ndër përmbajtjet më domethënëse. Për ta realizuar këtë përmbajtje autori i drejtohet shpesh analizës psikologjike të “dhomës së errët” (Niçe) të qenies njerëzore. Analizës psikologjike të marrëdhënies së njeriut përmes kësaj “dhomë të errët” me realitetin, grupin social, hapësirën dhe kohën në të cilën ekziston.

Në tregimet dhe novelat e dy vëllimeve “Hija e maleve” dhe “Tregtar flamujsh”, Koliqi i kushton rëndësi të veçantë portretizimit bindës të personazheve, si personazhe të botës shqiptare, dhe si personazhe, qenie njerëzore. Ky portretizim është shpesh edhe teknika bazë e analizës së botës së brendshme të njeriut. Shpesh edhe domethëniet artistike e kuptimore janë të lidhura me mënyrën e ndërtimit të portretit të personazheve.

Në plazmimin e këtyre portreteve autori ndërthur elemente sa të formës aq edhe të përmbajtjes, ku elementi përmbajtësor është dominant për të krijuar karakterin e dallueshëm të personazheve njëri nga tjetri. Si personazhe të botës shqiptare, personazhet e Koliqit bartin

gjithë ngarkesën emocionale, psikologjike, të shqiptarit i cili gjendet në kapërcyell të dy epokave, epokës tradicionale të dominuar nga tradita zakonore dhe epokës moderne të dominuar nga kërkesa për një model të ri jete, kryesisht ndikim nga kultura e shkruar, nga shkollimi brenda vendit apo nga modeli i jetës perëndimore, kryesisht ndikim nga shkollimi në universitetet europiane.

Ndërsa si personazhe - qenie njerëzore, ato përshkohen nga trajta të vuajtjes dhe dhimbjes, të dhëna në formën e trishtimit, melankolisë për fatin e qenies njerëzore, për ikjen e moshës rinore, mosrealizimin e ëndrrave ose të ndjenjave, deri në formën e pikëllimit për vetë absurdin e jetës apo të vdekjes së qenies njerëzore. Këto personazhe përshkohen nga vuajtja ekzistenciale e qenies. Përmes saj na zbulohet një botë shpirtërore shumë komplekse e personazheve, gjë e cila, mendoj, i afron ata edhe tani me botën e lexuesit. Shumë prej personazheve që përshkohen prej kësaj vuajtjeje dramatike në mënyrën e vet, janë personazhe idealistë që e pësojnë në konflikt me realitetin dhe të përditshmen. Çka përbën një element tjetër modern në prozën e Koliqit, dhe në prozën shqiptare.

Prozat e Koliqit shquhen për shprehjen lakonike dhe strukturën e ngjeshur, aq sa mjaft prej tyre përmbajnë elementë që mund të shtjellohen edhe më tej, në lloje të tjera të prozës. Autori përdor emërtimin “novela” për këto proza, por një pjesë e mirë e tyre për shkak të përfundimit të shpejtë të veprimit dhe mungesës së shtjellimit më në gjerësi të episodeve, mbeten në kufijtë e tregimeve. Në modelin e rrëfimit, Koliqi, gërsheton rrëfimin si rrëfim i shkruar me rrëfimin si rrëfim gojor, ndaj shpesh mjete të rëndësishme të komunikimit artistik janë përshkrimet e shkurtra, dialogjet, monologjet e ngjeshura. Në themel të prozave qëndron pothuaj gjithnjë një fabul interesante, e cila fillon dhe mbaron shpejt, me një zhvillim klasik të veprimit, shpesh duke ndjekur rrjedhën logjike dhe kronologjike të tij. Sa i përket shprehjes artistike mund të themi se proza e Koliqit përshkohet nga lirizmi dhe nga ngjyrimi poetik i shprehjes artistike, cilësi këto të tekstit të prozës moderne.

**Laureta BRUKA, Ermira ALIJA**  
**SUBJEKTI I PËRBASHKËT I DY PËRRALLAVE TË MBLEDHURA NË VERI DHE**  
**I NJË POEME TË SHKRUAR NË SKAJIN JUGOR TË SHQIPËRISË**

Vepra e Kuçukut, *Erveheja*, më është dukur interesante për faktin se si kjo vepër ka një subjekt pikë për pikë të ngjashëm me përrallën *Besa e Kunorës*.

Prof. Ermira më propozoi edhe një përrallë tjetër të ngjashme me poemën, por me veshje më të hershme: *Çika e pakund shoqe*. Fakti që Erveheja kishte dy simotra në krijimtarinë popullore, ishte interesant për ne dhe na propozoi ta vëzhgonim këtë marrëdhënie si raport të letërsisë me folklorin.

\*\*\*

Dihet që Kuçuku nuk është nisur në veprën e tij nga përrallat dhe objekti i punimit tonë nuk tenton të kërkojë burimin<sup>26</sup>, por të vëzhgojë mënyrën e vështrimit dhe të konceptimit të jetës në poemë duke e krahasuar me atë të përrallave. Meqë ata kanë një subjekt shumë të ngjashëm, këtë e gjykojmë si rast shumë të mirë, pasi përqsja e dy teksteve letrare që i përkasin zhanreve të ndryshme, do të thotë sjellje në vëmendje e bashkëjetesës të motiveve mes folklorit dhe letërsisë së kultivuar. Vëzhgimin e përbashkësive e të ndryshimit mes Ervehesë dhe përrallave e menduam me interes për të treguar letrariterin që përbashkon dhe ndan dy zhanre të ndryshme në letërsi.

Përrallat janë mbledhur nga pater Donat Kurti dhe botuar në vëllimin I, *Prralla Kombëtare*. Ai, kur ka dashur të shpjegojë motivet e përrallave të grumbulluara, thotë: “*Motivat që zhvillohen ndër ne, duken fort të hershëm, pse i ndeshim ndër prralla t’indjanve, t’arapvee të kelteve*”<sup>27</sup>.

Për të evidentuar ngjashmëritë dhe dallimet mes Ervehesë së Kuçukut dhe përrallës “Çika e pakund shoqe” kemi përdorur faktet që na jep analiza e dy teksteve.

Muhamet Kuçuku jetoi në shekullin XVIII. Studiuës të ndryshëm, si Gaetano Petrota, Namik Resuli, Filip Fishta, Robert Elsie, Sabri Hamiti, Klara Kodra, Bashkim Kuçuku e të tjerë e kanë përmendur. Vepra më e njohur e tij “Erveheja” u botua në fillim në Bukuresht nga Rilindasi Jani Vreto në vitin 1888, i cili mori përsipër ta pastrojë dorëshkrimin nga fjalët e huaja duke u bërë kështu “dora e dytë” që ndërhyri në material. Me gjetjen e dorëshkrimit original, ai u transliterua nga Osman Myderrizi<sup>28</sup>. Erveheja është quajtur *poemë, tregim apo novelë në vargje* që ...*vjen tue i mbrue përherë e ma tepër ndiesit e bukura shqiptare të ruejtjes së nderës a t’erzit*...<sup>29</sup> Megjithatë emri i Kuçukut, nuk është përfshirë në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar.

Erveheja, në fillim mbante titullin Revza (Kopshti) dhe është ndërtuar me vargje tetërrokëshe me rimë ABAB. E gjithë struktura e veprës qëndron në 226 strofa me nga katër vargje.

---

<sup>26</sup> Pwr kwtw shih: THE SIMILAR SUBJECT BETWEEN TWO FAIRY TALES AND A POEM IN THE ALBANIAN LITERATURE, on-line, IAI Academic Conference Proceedings, p. 56; <https://ia-institute.com/iai-academic-conference-proceedings-vienna-21-june-2022>

<sup>27</sup> Pater Donat Kurti, parathënie në “Prralla kombëtare, Mbledhë prej gojës së popullit, Botimi IV, vëllimi i I, Botime Françeskane, Shkodër 2013

<sup>28</sup> Sipas tij, Muhamet Çami, lindi në Konispol më 1780. Familja e tij e kishte origjinën e hershme nga Skrapari. Mësimet e para i mori në shkollën fillore të fshatit. Më tej arsimit i tij vijoi në një nga medresetë e vendlindjes. I ati i vdiq kur ishte ende i vogël dhe për arsimin e tij u kujdes xhaxhai, Ymer Kuçuku. Të afërmit vunë re që ai kishte një vullnet dhe dëshirë të madhe për të mësuar dhe për këtë e nisën në *Medresenë e Kajros*. Në Kajro, Kuçuku, qëndroi për 11 vjet me radhë dhe më pas u kthye në vendlindje. Kur kthehet në Konispol vendoset një herë e përgjithmonë për të mos u larguar më. Krijon familje dhe për shkak të arsimit të tij merret me xhaminë e fshatit si hoxhë. Vdiq më 1843. (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “*Muhamet Kuçuku-Çami, Vepra letrare dhe studime për të*”, f.46)

<sup>29</sup> Po aty, fq 97


Marrja dhe dhënia e Ervehesë me folklorin është parë si tipar i krijimtarisë së Muhamet Kuçukut. Kjo marrëdhënie është vënë re në studime të ndryshme dhe është parë si marrje dhe dhënie motivesh, subjektsh, heronjsh etj. Në parathënien: “Muhamet Kuçuku, Çami, Vepra letrare dhe studime për të”, shkruhet se hyjnizimi i virtytit, në mënyrë të veçantë i besnikërisë bashkëshortore, është një dukuri universale dhe mbikohore, modele të së cilës gjenden tek Penelopa në mitologjinë antike greke. Pavarësisht se autori thotë se e ka marrë subjektin nga një tregim në turqisht, cilësitë e personazheve të tij lidhen me zanafillën që në antikitet, kur bota ekzistonte në emër të paganitetit. Për këtë flasin edhe dy motërzimet në përralla të Ervehesë: “Besa e Kunorës” dhe “Çika e pakund shoqe”. Me përrallën “Besa e Kunorës”, Erveheja ka një ngjashmëri pothuajse autentike. Por me “Çika e pakund shoqe” ndryshon pak, pasi kjo përrallë ka veshje më të hershme. Prandaj edhe zgjedhëm të krahasojmë Ervehenë me “Çika e pakund shoqe”, për të evidentuar raportin e letërsisë me folklorin.

#### **NGJASHMËRITË DHE DALLIMET MES POEMËS DHE PËRRALLËS**

	<b>POEMA</b>	<b>PËRRALLA</b>
<b>KOHA</b>	<b>Më e përcaktuar</b>	<b>Më e papërcaktuar</b>
	Për kohën flitet në dy vargjet e para: <i>Pa dëgjoni një përrallë /T'atyre motëvet të parë.</i>	Nuk është e përcaktuar. Për kohën flitet: <i>Një ditë po i thotë djali babës së vet...</i>
<b>VENDI</b>	<b>Më e përcaktuar</b>	<b>Më i papërcaktuar</b>
	Përmbajnë më shumë elemente qytetërimi: <i>shtëpia, bregu, togu me gurë, deti, gjemi, qytet, pallate, saraje, mejdan, teqeja</i>	Fjalët janë më të përgjithshme: <i>kulla, oda, pylli, mal, shpi, bunar, mbretëri</i>
<b>PERSONAZHET</b>	<b>Personazhet kanë veshje kulturore më shumë si emërtime e më pak si përmbajtje</b>	<b>Personazhet kanë veshje kulturore shumë pak, qoftë si emërtime qoftë si përmbajtje</b>
	Burri, Erveheja, arabi, kunati, Iblisi, hismeqari, delikallija, kapedani, Sulltani, Allahu, devleti, padishahu hallku.	Babai, djali, çika, kojshia, lypësja, mbreti, tre djemtë (e çikës), rrogtari, çobanesha, i zoti shpisë.
<b>PERSONAZHI KRYESOR</b>	<b>Vajza ka emër</b> Erveheja	<b>Vajza s'ka emër, por vlerësim</b> Çika e pakund shoqe
<b>RRËFIMI</b>	Në vargje	Në prozë
<b>PËRSHKRIME</b>	Kanë gjendje emocionale	Gjendjet emocionale mungojnë
<b>ZGJIDHJA</b>	<b>Sipas frymës fetare:</b>  Erveheja vendos të falë të gjithë ata që bënë padrejtësi ndaj saj.	<b>Sipas organizimit shoqëror, i merr Mbreti</b>  Mbreti fal babain, vëllait i pret dorën; kojshiun, lypsen dhe rrogtarin i pret copë-copë, të zotit të shtëpisë i jep një shpërblim të mirë
<b>GJUHA</b>	E folura Çame, disi më e përpunuar, në vargje, me rimë, që plotëson disa parime estetike	E folura Gege, një gjuhë e thjeshtë tipike për rrëfime të natyrës së përrallës.

	të letërsisë së shkruar.	
<b>MORALI</b>	Në fund fiton e drejta dhe e vërteta.	Në fund fiton e drejta dhe e vërteta.

### Shpjegimi i ngjashmërive sipas skemës së Vladimir Propp



na shprehin subjektin e Ervehesë si subjekt i ngjashëm përralle, ka plot (muosina) vetëm në Veri), edhe para se Kuçuku ta shkruajë poemën<sup>30</sup>. Nga ana tjetër, struktura rrëfimtare e Ervehesë, aq sa nga studiuesit është quajtur edhe novelë në vargje, është e vështirë të identifikohet me kufij të prerë nacionalë. *Vetëdija e krijuar e njeriut të sotëm pranon ... një shumësi tematikash...si simbole...*<sup>31</sup> Besa ka qenë kod moral i padiskutueshëm në mentalitetin dhe kulturën mbarënjëzore përfshirë dhe atë shqiptare. Në rastin tonë Erveheja është heroina *me moral të lartë tradicional*. Origjinaliteti i poemës shfaqet si letrarësi, si aftësi poetike e autorit për të reflektuar botën e gjallë të personazheve: *Ervehenë e pezmosi,/ Ngriti duartë të dija/ Të kunatin e munxosi:/ “U, të humbtë perëndija!”*. Kjo është e folura tipike që na kujton gjyshtet tona, me shprehjet gjuhësore të shoqëruara me gjeeste, gjë që na jep një personazh tipik shqiptar, real social që, kur preket atje ku nuk tolerohet, hidhet në ritëm verbal duke mallkuar kundërshtarin. E njëjta

<sup>30</sup> THE SIMILAR SUBJECT BETWEEN TWO FAIRY TALES AND A POEM IN THE ALBANIAN LITERATURE, on-line, IAI Academic Conference Proceedings, p. 56; <https://ia-institute.com/iai-academic-conference-proceedings-vienna-21-june-2022>  
<sup>31</sup> Alija Ermira, “Letërsia shqipe si metafizikë dhe trashëndencë”, “Naimi” 2018, fq 280

veshje që e bën Ervehenë një grua shqiptare, na jepet edhe te strofa: *Erveheja kur e digjoi/ "Shporru, i tha, "me të shpejtë",/ "se tit zotit vete i dëftoj,/ Si qenet ta prët krietë"*.

Sipas studiuesit Osman Myderrizi, edhe pse Kuçuku thotë se novela u shkrua për të paditurit, kjo nuk është e vërtetë, sepse vargu është punuar me kujdes dhe gjurmët e përpjekjeve për të arritur shprehje artistike, i shohim kudo.

Ndryshimi me përrallën qëndron pikërisht në veshjen kohore e kulturore të poemës, pavarësisht se shpreh të njëjtin thelb përrallor në realizimin e të pamundshmes dhe të përpjekjes për të sublimuar botën<sup>32</sup>. Pavarësisht se vepra e Kuçukut është e brymosur me tipare të letërsisë së kultivuar, kryesisht në formë, ajo na ofron një tekst poetik të ndikuar fort nga folklori: *Erveheja qe një grua,/ Që s'kish shoqe nd'atë ditë,/ Vajzë dhe si u martua,/ Posi hëna që bën dritë.*

Studiuesit çmojnë momentet lirike te Erveheja si dëshmi për talentin original, por nuk mbetet pas edhe përshkrimi i disa detajeve, si në këtë rast i përshkrimit të tërthortë të bukurisë së Ervehesë: *Vate, e pa, i pëlqeu./ Dhe s'i tha, se isht'e shtrinjtë/ As fjalë tjetër këmbëu / Por i nëmëroj, florinjtë.../ Pastaj tha, qenëka fëmërë,/ Që sa do të kesh thënë,/ Kaq më hyri në zëmrë/ Të gjitha t'i keshë dhënë.*

Gjuha e kultura popullore jep e merr me letërsisë individuale. Përbashkësia që patëm si objekt të punimit, tregon se letërsia individuale, individualizon më fort dhe mbart më shumë gjurmë kulturore, kohore dhe psikologjike. Në këtë mënyrë ajo ndërton arketipe më të dallueshme në kohë e hapësirë dhe si rrjedhojë mbart më tepër pjesë të një realiteti të caktuar. Ky individualizim vjen i zbehtë në rrëfimet popullore, ku subjekti endet në trajta simbolike, që na çojnë në kohë të papërcaktuara, pa gjurmë konkrete historike.

Personazhi Ervehesë së Muhamet Kuçukut individualizohet edhe falë mjeshtërisë së përshkrimit. Ky raport si marrëdhënie mes letërsisë së kultivuar dhe asaj popullore është një fenomen interesant dhe kompleks, me afri dhe largime. Dallimet me fjalë, si: Allahu, Xheneti, shejtani, iblisi, kaphe, ulqesa, padishahu, elçitë, sarajet, gjemi, fermani, mejdani, teqeja, mehqemes, kadiu, hyzmeqari, s'bëjnë asgjë tjetër veçse vendosin veprën në kohë dhe hapësirë dhe i japin veshje kohore e kulturore. Nga ana tjetër përralla me leksikon popullor, si: çika, kulla, komshiu, shkallët, çobanesha, pylli, etj., na çon në një realitet artistik abstragues, ku ekziston mundësia e mashtrimit, prova për heroinën si dhe ndëshkimi i të ligjve.

Edhe pse daton në fillim të shek XIX, letrarësia e Ervehesë na tregon për ngurtësimin e subjektit të përrallës ndër shekuj, në paraqitjen e thelbit të rrugës së mirë dhe vlerave të njeriut.

## BILIOGRAFIA

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, "Muhamet Kuçuku-Cami, Vepra letrare dhe studime për të.
- Kurti Donat, "Përralla Kombëtare I" fq 96.
- Resuli Namik, Shkrimtarët Shqipëtarë 1, Histori e letërsisë shqip, nën kujdesin e Ernest Koliqit, botim i Ministrisë së Arsimit, 1941, fq 96-97.
- Historia e Letërsisë Shqipe, Vëllimi I, Folklori shqiptar Letërsia e vjetër shqipe, Tiranë, 1959.
- Hamiti Sabri, "Poetika Shqipe" "55" 2010.
- Historia e letërsisë shqipe 1, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1959, f.297.

---

<sup>32</sup> Arben Prendi, Letërsi gojore shqiptare, Fiorentina, Shkodër, Nëntor, 2016, fq 299



- Historia e letërsisë shqiptare, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1983.
- Elsie Robert, Histori e Letërsisë shqiptare, përkthyer nga origjinali anglisht “History of Albanian Literature (1995, nga Abdurrahim Myftiu, Tiranë, 1997.
- Hamiti Sabri, Letërsia Filobiblrike Letërsia Romantike, Vepra letrare 7, Faik Konica, Prishtinë 2002.
- Historia e letërsisë shqipe 1, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1959.
- Prendi Arben, Letërsi gojore shqiptare, Fiorentina, Shkodër, Nëntor, 2016.
- Alija Ermira, “Letërsia shqipe si metafizikë dhe trashëndencë”, “Naimi” 2018, fq 280
- Alija Ermira, The Similar Subject Betëeen Tëo Fairy Tales And A Poem In The Albanian Literature, on-line, IAI Academic Conference Proceedings, p. 56;  
<https://ia-institute.com/iai-academic-conference-proceedings-vienna-21-june-2022>
- <https://www.studocu.com/it/document/universita-degli-studi-di-palermo/critica-letteraria-e-letterature-comparate/le-fiabe-i-ruoli-e-e-le-funzioni-di-propp/1270826>.

## Rëndësia dhe jehona e veprës *William Shakespeare* të kolosit të letërsisë franceze Viktor Hygo

U deshën më shumë se një gjysëm shekulli që lexuesit shqiptar t'i shtohet një vepër tjetër e shkrimtarit, poetit dhe dramurgut francez Viktor Hygo, këtë herë si eseist. Vepra *William Shakespeare* vjen e përkthyer mjeshhtërisht nga version original. Është interesant fakti se përkthimi është nisur nga Abdullah Rami dhe më pas vijuar dhe përfunduar nga mbesa e tij, Ermira Xhomaqi- Godo, e cila ka realizuar ëndrrën e saj për të përmbushur amanetin e tij.

Për të kuptuar më mire veprën, le të paraqesim kontekstin dhe rrethanat e shkrimit të veprës *William Shakespeare*:

1. Është 300-vjetori i lindjes së Shekspirit. Teksti që Viktor Hygo boton me këtë rast është një himn për lirinë e gjenit artistik dhe epërsinë e saj mbi të gjithë njerëzit e tjerë të mëdhenj (në fushën politike apo ushtarake): *William Shakespeare*- një flakëhedhës indirekt kundër Perandorisë së Dytë, ku ndjehet ky vrull militant.
2. Është botimi i Veprave të plota të Shekspirit nga François-Victor Hygo (i biri) i cili ia besoi parathënien Viktor Hygo-it. *William Shakespeare* lindi si zgjerimi i këtij projekti.
3. Është e drejta e përgjigjes që Hygo ia jep vetes pas sulmeve të kritikëve mbi romanin *Të mjerët*. Shumë nga reflektimet e shprehura në veprën *William Shakespeare* mbi dëmshmerinë e kritikës shpjegohen me këtë vetëmbrojtje indirekte.
4. Rrethana e katërt është më e përgjithshme. Është mërgim. Ajo shpjegon denoncimin e të gjitha formave të tiranisë së vuajtur nga gjenitë e mëdhenj në të gjitha kohërat dhe dedikimin e tij ndaj Anglisë. Ja se si shprehet : “Për lavdinë e poetit të saj këtë libër ia kushtoj e të vërtetën Anglisë ia them; Por, si vendstrehim, e dua me shpirt”.

Shtrohet pyetja : Si duhet lexuar kjo vepër ?

A është biografi? Po, një biografi indentifikuese ku nën pretekstin për t'i thurrur lavdi Shekspirit, Hygo synon të derdhë zemrën e shpirtin e tij dhe të militojë për romantizëm,

A është autobiografi? Po, por një autobiografi ku uni që rrëfëhet është ai i personazheve të teatrit, të tillë si: Mbreti Lir, Hamleti, Otello, Makbeti, Kordelia si edhe lexuesit i cili gjen pasyrën e kushtit të tij njerëzor.

A është kritikë letrare? Po, por një libër i kritikës mbi kritikën.

A është manifest? Po, por një manifest jo normative pasi *kredoja* e tij është konkretisht liria e gjenit përkundrejt çdo norme të jashtme të shijes.

A është pamflet? Po, por një pamflet me karakter të përgjithshëm, ku armiku nuk përmendet me emër (Perandori i dytë, regjimi perandorak, kleri i korruptuar apo borgjezia puritane),

Leximi i *William Shakespeare* mund të duket turbullues në shikim të pare. Kjo nuk ndodh vetëm sepse Hygo, siç shpjegon Guy Rosa, "e mbush librin e tij "me njohuri, duke përdorur shumë referenca, anekdota, emra dhe data, citime dhe aludime" por edhe sepse secila prej këtyre rrethanave dikton një apo edhe disa orientime të përgjithshme të veprës.

Vepra ndahet në tri pjesë. Tek pasqyra e lëndës së veprës, Hygo tre pjesët i fillon me një libër mbi Shekspirin, por më pas kalon në diçka tjetër. Për shembull, në pjesën e parë të veprës Shekspiri shërben vetëm për të dhënë një përkufizim të Gjenit. Vetëm dy librat e parë të pjesës së dytë i kushtohen Shekspirit. Tek "Shekspiri, gjeniu i tij" Hygo rendit kundërshtarët e tij dhe kritikët e bëra ndaj tij, të tilla si: teprimet dhe sjelljet e tij, marrëzia e tij, abuzimi me antitezën dhe imazhet.

Në fakt Hygo komponon në këtë vepër autoportretin e Shekspirit si një gjeni rebele. Kush tjetër përveç tij, në fakt, mund të jetë ky "Shekspiri modern" ardhjen e të cilit ai e shpall, në një prejardhje që shkon larg në kohë, deri te Eskili, i mbiquajtur prej tij "Shekspiri Plak"? Identifikimi është i dyfishtë: nga një gjeni i persekutuar në një gjeni tjetër, nga kritika anti-shekspiriane te kritika antiromantike.

Plot anekdota historike, shtesa erudite dhe zhvillime anësore, në vepër sillen tri këndvështrime : së pari, Shekspiri jo për veten e tij, por si një gjeni ; së dyti , art por si situatë e gjenive që përballen me natyrën (ose Zotin) dhe njerëzit, dhe së treti, qytetërimi në lëvizjen e tij e rrjedhimisht historia nga e cila shpëtojnë gjenitë dhe nga e cila ata frymojnë.

Të tri këndvështrimet janë të ndërvarura sa që çdo zhvillim kushtuar njërës vendoset nën dy të tjerat. Mbi të gjitha, ne e kuptojmë ambicien e librit. Në qendër të tij është gjeniu, jo ideja apo nocioni i tij, por realiteti i tij. Jo nga shija për njerëzit e mëdhenj ose me synimin për të lavdëruar veten, por sepse gjenialiteti, në plasticitetin e tij, duke filluar nga ata që prehen në Panteon deri te shpikësit anonimë të progresit teknologjik, bën të mundur përfaqësimin e unifikuar të aktiviteteve të mendjes – arti, mendimi, shkenca, reforma morale apo sociale – ashtu siç ushtrohen në situatën e dyfishtë të njerëzimit, atë të përhershme mes natyrës dhe Zotit dhe atë progresive në histori.

Historia ndahet në dy kategori. Ajo përparon, si shkenca dhe shpesh përmes saj, ajo fiton hap pas hapi idealin për t'i bërë thirrje gjenive - është histori reale, gjithmonë e lënë në hije nga historia iluzore e dhunës dhe e shtypjes. Por ka ndodhur që gjeniu ta ketë pushtuar historinë dhe të ketë ngadhjyer mbi të : revolucioni është momenti kur ai është bërë brilant falë përmbajtjes së tij – deklarata e të drejtave, barazia civile, e drejta e votës universale, heqja e kufijve dhe shkrirja e popujve në një republikë universale – si në rastin e tij: shkatërrimi efektiv, edhe pse i papërfunduar, i botës së vjetër ku njerëzit fituan të drejtat e tyre.

Lexuesi e merr me mend se si për Hygoin e mërguar Shekspiri mbetet një figurë identifikuese e një gjeniu të madh, i cili duhej të luftonte kundër paragjykimeve, censurës dhe pushtetit politik të kohës së tij. Ky libër u jep bashkëkohësve të djeshëm dhe të sotëm këtë mesazh subkoshiençë : Shekspiri ende gjallë, romantizmi nuk ka vdekur.

Viktor Hygo na kujton këtu themelin e çdo organizimi shoqëror dhe këtë lidhje të pashprehur, por të domosdoshme, mes njerëzve dhe krijuesit, arsyt e të qenurit të Artit në shërbim të popujve. Ai mund të konsiderohet si vektor i një mendimi themeltar, si gjenerator i njerëzimit!

Prandaj, kjo vepër tingëllon aktuale edhe në shekullin e 21-të. Ajo mund të jetë një thirrje për ndërgjegjësim dhe pse jo një këshillë : qytetërimi le të ketë mbretëreshë lirinë, dhe injoranca le të ketë shërbëtor dritën.

Klevisa BARDELI

### “Disa qasje të paskajores gege sot”

#### Hyrje

Përzgjedhja e temës që do të trajtohet në vijim nuk erdhi rastësisht, kjo pasi përherë më ka shtyrë kureshtja të studioj se çfarë janë në vetvete format e pashtjelluara të foljes, konkretisht paskajorja gege. Ajo që më shtyu të ndalem të studioj *paskajoren gege* të tipit *me + pjesore* është fakti se përherë e shohim si kundërvënie me paskajoren e standardit të tipit *për të + pjesore*, por pavarësisht kësaj, vihet re se folësit e shqipes ndonëse zotërues të standardit priren shpesh të përdorin në të folur paskajoren gege. Dhe një ndër diskutimet që bëhet për sa i përket politikave të përmirësimit të standardit është “*A duhet të integrohet paskajorja gege në standard?*” Për ta parë paskajoren gege, ndërtimin por edhe kategoritë e funksionet e saj jemi ndalur tek një autor gegë, konkretisht te poetja Ledia Dushi, në dy vëllimet poetike “*Ave Maria bahet lot*” dhe “*Seancë dimnash*”.

Arsyeja e përzgjedhjes së kësaj autoreje erdhi duke qenë se Ledia i përket poetëve bashkohore gegë, ku gjuha e përdorur nga autorja i identifikon më së miri format gjuhësore të gegërishtes, duke na lënë mundësi studimi pikërisht të paskajores gege, gjë që e dallon nga pararendësit e saj, por edhe nga ato poetë bashkohës me të, pse jo edhe për ta parë paskajoren gege tashmë në kuadrin brenda *poezisë* e jo të *prozës*. Punimin e kemi mbështetur kryesisht në metodën kontratuese, duke bërë më shumë përjasjen standard-gegërisht sa i takon dy formave të pashtjelluara, pjesores dhe paskajores. Sigurisht kemi përdorur edhe metodën statistikore, aty ku ka qenë e mundur dhe nuk mund lëmë jashtë edhe metoda me karakter përshkrimor. Pas analizimit të paskajores gege tek autorja e përzgjedhur jemi përpjekur të japim mendimin tonë rreth integritetit të paskajorja gege në standard. Mendojmë se ka ardhur koha t’i kthehet vëmendja dhe rëndësia e pasurisë gjuhësore gege. Shpresojmë se kontributi ynë modest mbi studimin e paskajores gege të jetë shtysë për analiza më të detajuara dhe shkencore. Para se të shohim se cilat janë ndërtimet e funksionet kryesore të paskajores, do të ndalemi pak te baza e saj, pjesorja.

#### 1. Pjesorja në veprën poetike të Ledia Dushit. Raporti pjesore gege -pjesore e standardit

Duke u ndalur në raportin e pjesoreve mes gegërishtes dhe të pjesores së shqipes së sotme standarde në lidhje me integritetin dhe përdorimin, dalin diskutime të ndryshme që nuk shkojnë gjithmonë në të njëjtin kah. Problematika e parë ka të bëjë me kundërvënien *standard-gegërisht* të prapashtesave të pjesoreve. Tipat e foljeve me temë me -**Ë** dhe ato me temë me -**NË** nuk paraqesin pengesa formale e drejtshkrimore. Zakonisht trajta e shqipes letrare nuk ndryshon shumë ndaj asaj gege, si p.sh.: *dalë, dhënë, marrë, nxënë* etj., por siç shprehet dr. Nuhi Veselaj “*Mund të thuhet se format e foljeve me – Ë dhe ato me - NË mund të përdoren pa diskutim, nëse mbizotëron gjykimi i autorit se një trajtë e tillë del e nevojshme për të shprehur koncepte të caktuara.*”<sup>33</sup> Nuk është e njëjta situatë me foljet me temë me -UR dhe -R(Ë) sepse “*atyre u ndryshon prapashtesa temëformuese në krahasim me format e pjesores së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes.*”<sup>34</sup> Siç vihet re edhe nga studimet e N.Veselaj, do shohim se prapashtesa temëformuese -UR e standardit është në kundërvënie me prapashtesën temë formuese -Ë, karakteristikë kjo e pjesoreve të gegërishtes, ndërsa

<sup>33</sup> N.Veselaj, *Paskajorja çështje e shqipes standarde*, Prishtinë 2000, f. 126.

<sup>34</sup> Po ai, po aty, f. 126.

prapashtesa -R(Ë) e standardit është në kundërvënie me trajtën e shkurtër të pjesoreve të gegërishtes.

Konkurrenca apo kundërvënie e formave të pjesoreve vihet re edhe te vepra poetike e poetes Ledia Dushi, çka dëshmon se këto forma përdoren edhe në krijimet artistike e jo vetëm në idiomën e folur. Këto vecori i mbartin edhe dy vëllimet poetike të marra në analizë “*Ave Maria bahet lot*” dhe “*Seancë dimnash*”. Në vijim do ta vendosim diskutimin në planin krahasimtar për të parë kundërvëniet mes prapashtesave që formojnë pjesoret në veprat e sipërcituara.

### 1.1. Kundërvënia -UR dhe -Ë

Këtë kundërvënie mes pjesores së standardit dhe gegërishtes e ndeshim edhe te poezitë e Ledias, siç duket kjo kundërvënie vjen e natyrshme për një folës të gegërishtes. Pjesoret e gegërishtes me prapashtesën -ë shërbejnë edhe si temë prodhuese për formimin e mbiemrit të nyjshëm me prapashtesën -shëm, të emrit të veprimit dhe emrit të vepruesit, prandaj në ndonjë rast raporti del në favor të gegërishtes p.sh.: *djeg* (tashme e dëftores), *i djegshëm* (mbiemër prejpjesor), *djegie* (emri prejpjesor i veprimit), *djegës* (emri prejpjesor i vepruesit). *djegë /djegur; gdhendë / gdhendur; çmendë / çmendur; dashtë /dashur; pasë /pasur mbyllë / mbyllur; me u futë /futur; puthë /puthur; vdekë /vdekur; rritë /rritur; shndritë /shndritur; mbytë /mbytur; prekë /prekur; mbyllë /mbyllur; korrë /korrur; qeshë /qeshur; ikë /ikur; thirrë / thirrur; mbetë /mbetur; fjetë /fjetur; këputë / këputur humbë /humbur; dashtë / dashur; pasë/ pasur etj. Po japim disa vargje për ilustrim:*

Flaka u shkundte me akull/Për mos me **djegë** gjithçka/Atëherë/Unë  
mplakem./Strukem n’brij/Nisi me **gdhendë**/Vdekjen e plagëve.  
(“*Mbas...Dite*”, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 7-8);

Me **ikë** shpirt shpirt/Me **ikë**/Kah hijet/Kah rrjetat/Kah liqejt lotues/Që s’ shihen.  
(“*Liqej lotues*”, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f.50).

Pra, vëmë re edhe në shembujt e mësipërm të marrë nga vepra poetike e L.Dushit kundërvënien mes pjesores së standardit dhe gegërishtes, siç duket kjo kundërvënie vjen e natyrshme për një folës të gegërishtes.

Në librin me poezi “*Ave Maria bahet lot*” dhe “*Seancë dimnash*” të poetes L. Dushi, vëmë re se ka raste kur te pjesoret e gegërishtes nuk përdoret fare prapashtesa -Ë e cila siç e thamë më sipër i kundërvihet prapashtesës së standardit -UR p.sh.: *vuejt /vuejtë / vujtur; lind / lindë / lindur;këput / këputë / këputur ; vorros/vorrosë /vorrosur;dijt / dijtë / ditur; këput / këputë / këputur etj. Më poshtë po japim vargjet ku del kjo formë e pjesores.*

Gjumi m’kjan n’sy/Përherë m’rritet dëshira/Me **dijt**/ Ç’ka m’djeg/Nën lëkurë...  
(“*Humbje*”, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”,f.51);

Trupi/M’ban me **vuejt**./Njomë/A 'asht ma/Askush/Nuk vdes/Për mue.  
(“*Trupi m’ban me vuejt*”, vepra poetike “*Seancë dimnash*”,f. 103);

Përnatë/Me **lind** n'trup/Nji engjëll/Që ban/Pyje t'bardha...  
(“*N’psherëtimë*”, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f. 24).

Siç edhe e shohim te shembujt më sipër jo gjithmonë pjesoret e foljeve janë të formuara me prapashtesa që i takojnë gegërishtes, konkretisht hasëm rastin e përdorimit të prapashtesës -ë. Duke u ndalur në analizën e pjesoreve *dijt*, *vuejt* e *lind* vëmë re se: në kohën e tashme të standardit folja *di* del me temë me zanore (di), në pjesoren e standardit e zgjeron temën me -t (ditur), kurse gegërishtja kohën e tashme të foljes *di*, që i përket zgjedhimit të tretë e zgjeron me -j ashtu siç dalin foljet e zgjedhimit të parë në standard, kurse tema e pjesores së kësaj

foljeje del e zgjeruar me **-t** (dijt). Folja *vuaj* e zgjedhimit të parë në kohën e tashme të standardit del me temë me tog zanor (vuaj), në pjesoren e standardit e zgjeron temën me **-jt** (vuajtur), kurse në gegerishte koha e tashme e kësaj foljeje del me temë me tog zanor -ue (vuej), në pjesore e zgjeron temën me **-jt** (vuejt). Folja *lind* e zgjedhimit të dytë në kohën e tashme të standardit dhe në pjesore del me temë të njëjtë me bashtingëllore (lind/lind-ur), po ashtu edhe në gegerishte si në kohën e tashme dhe në pjesore del me të njëjtën temë me bashtingëllore (lind-lind-ë ose prapashtesë si rasti përjashtimor i pjesores).

## 1.2. Kundërvënia -R(Ë) me 0 (zero)

Pjesorja me prapashtesën *-rë*, shërben si temë prodhuese për prejpjesorët, si p.sh: *běj*(tashme e dëftores), *bërje* (emri prejpjesor i veprimit), *bërës* (emri prejpjesor i vepruesit), *i bërë* (mbiemri prejpjesor). Raporti del në favor të saj kundrejt formës së pjesores së gegerishtes, por ka raste siç është mbiemri i nyjshëm me **-shëm** “*i bëshëm*”<sup>35</sup> që formohet mbi bazën e pjesores së gegerishtes. Te foljet me prapashtesën *-r* në pjesore dalin çështje më të ndërlikuara, kryesisht te foljet që kanë temën me togun *ye,ue*. Edhe për tipin këtyre foljeve raporti del në favor të pjesores së standardit, pavarësisht se kemi raste të formimit të emrave prejpjesor të vepruesit mbi bazën e pjesores së gegerishtes, si: *ëndërrues*, *grimcues*, *frymues* etj. si edhe të mbiemrave të nyjshëm me prapashtesën *-shëm*: *i mësuëshëm*, *i afruëshëm*, *i gëzueshëm* etj. Nga krjimtaria e L. Dushit kemi vjelë pjesoret e mëposhtme: *grimcue / grimcuar; andrrue / ëndërruar; shtrëngue / shtrënguar; gëzue / gëzuar; notue / notuar; jetue / jetuar; mësue / mësuar; prangue / pranguar; afrue / afruar; kujtue / kujtuar; harrue / harruar; frymue / frymuar; Ndryshue (titull)/ ndryshuar; shkrueme / shkruar; pa / parë; ba/ bërë; pi / pirë etj.* Po marrim për ilustrim vargjet:

N'stinë/Dielli/Ka me e **pa**/N'bëthamë t'dashunisë/Tokën./N'fund/Lule-zemra/Ka me u **grimcue** (“*Kohë për shi*”, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 21);

Flej n'kujdes/Me iu **afrue**/Gjumit t'madh./Ajri përmbi/Asht/Vetëm... (“*Gjumi i madh*”, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f. 29);

Me **jetue** s'mundem/me vdekë s'due... /Tash po filloj/Me u **mësue**/Me vedin. (“*Vedja*”, vepra poetike “*Seancë Dimnash*”, f. 6).

## 2. Paskajorja gege në veprën poetike të L. Dushit. Ndërtimi i saj.

Paskajorja gege është një formë e pashtjelluar e foljes e cila shpreh një veprim a gjendje në mënyrë të përgjithësuar pa u lidhur me një kohë a vetë të caktuar, duke emërtuar një veprim a proces abstrakt. Forma e tipit *me punue* njihet si formë e pashtjelluar me vlerën e paskajores, ndonëse ka diskutime të shumta nëse kemi të bëjmë me një paskajore primare apo sekondare. *Ndërtimi i saj përbëhet prej dy gjymtyrësh: nga pjesëza “me” si gjymtyrë e parë dhe nga pjesorja përkatëse e foljes së caktuar, si gjymtyrë e dytë*<sup>36</sup>. Pra, forma e tipit **me + punue** njihet si formë e pashtjelluar paskajore, që paraprihet nga pjesëza parafjalore “me”, e cila ka humbur vlerat semantike dhe funksionale si parafjalë duke u shndërruar me vlerën e pjesëzës, kurse si gjymtyrë e dytë e paskajores është pjesorja e foljeve të caktuara. Pjesëza *me* mendohet se ka qenë pjesë përbërëse e paskajores së bashku me funksionet e saj që me krijimin e saj “*duke pasur parasysh edhe rrugën e formimit të togjeve të tjera foljore, si p.sh.: togjet për të punuar, me të ardhur, një të parë etj.*”<sup>37</sup>

<sup>35</sup> Shih: N.Veselaj, *Paskajorja çështje e shqipes standarde*, Prishtinë 2000, f. 128.

<sup>36</sup> N.Veselaj, *Paskajorja çështje e shqipes standarde*, Prishtinë 2000, f. 118.

<sup>37</sup> S.Mancaku, “*Paskajorja e shqipes dhe kategoritë e saj gramatikore*”, *Studime filologjike* 1982, nr. 1, f. 140.

Në lidhje me karakterin analitik origjinal të paskajores N.Veselaj shprehet se “paskajorja karakterizohet nga karakteri origjinal analitik i formëzimit të saj në shqipe kundrejt karakterit sintetik që ka forma e paskajores në shumicën e gjuhëve simotra indoevropiane”.<sup>38</sup> Paskajorja gege del në disa forma që janë: **me punue** si paskaroje e zakonshme, **për me punue** si paskajore e dytë hibride, ku pjesëzën “për” e ka marrë analogjikisht nga paskajorja e dytë e tipit “për të”+pjesore, kurse pjesën tjetër e ka nga paskajorja e mirëfilltë, **për të punue** e ndërtuar nga parafjala për dhe pranëvënie e emrit *prejfoljor* të gjinisë asnjësore në rasën kallëzore. Të gjitha këto forma, në standardin e sotëm shprehen vetëm me formën e tipit **për të punuar**. Paskajorja gege përdoret nga shkrimtarët për qëllime ideo-estetike, si një thesar i fjetur i rizbuluar që magjeps si ai fryti i ëmbël imagjinar që josh autorët e caktuar, pikërisht si një “mollë e ndaluar”.<sup>39</sup> Duke u ndalur te veprat poetike të L. Dushit “Ave Maria bahet lot” dhe “Seancë dimnash” do vëmë re dy forma të përdorimit të paskajores gege, ajo e tipit **me + pjesore** dhe **për me + pjesore**.

**a. me+ pjesore** e ndërtuar nga pjesëza *me* dhe nga pjesorja e foljes së caktuar. *me pa; me marrë; me çmendë; me lind; me pasë; me dijt; me mbyllë; me andrrue; me shtrëngue; me pi; me futë; me gzuë; me notue; me puthë; me kenë; me jetue; me vdekë; me mësue; me lanë; me rritë; me folë; me prekë; me afrue; me çilë; me thanë; me kujtue; me korrë; me qeshë; me ikë; me thirrë; me fjetë; me harrue; me jetue; me frymue; me këputë; me humbë; me dashtë; me pasë; me kthye; me vuejt etj.* Më poshtë po japim ilustrim vargje ku përdoret kjo formë e paskajores nga vepra poetike e L. Dushit.

Dhëlpnat turren/Me u **çmendë**/Rrëzueshëm bjeshkëve

(“Nesër plakem”, vepra poetike “Ave Maria bahet lot”, f. 34);

Mali/S'ka **me** më **thanë** kurrë/Çka ndien/Për mue.../Mundem/Ende/Me **kujtue**.

(“Me kujtue”, vepra poetike “Seancë dimnash”, f. 35).

**b. për me + pjesore** e ndërtuar nga paravendosja e parafjalës *për* formës së paskajores gege p.sh.: *me thanë*, karakteristikë për gegërishten veriperëndimore. *për me djegë; për me dashtë; për me këput; për me varros; për me marrë; për me mbytë; për me prangue; për me shndritë; për me ba etj.* Më poshtë po japim ilustrim vargje ku përdoret kjo formë e paskajores nga vepra poetike e L. Dushit.

Vetmia /Lëshon/Lule t'prishuna,/Këputë/Rrezet e diellit/Për **me shndritë**/Fëmijë t'vdekun.

(“Vetmija”, vepra poetike “Seancë dimnash”, f. 23);

Larg prej themeleve/Ku kishin hedhë/Nji turrë drush/Flaka u shkundte me akull/Për mos **me djegë** gjithçka;

(“Mbas...Dite”, vepra poetike “Ave Maria bahet lot”, f. 7-8).

Vëmë re se mes këtyre dy formave të pjesores ka denduri më të madhe përdorimi forma *me + pjesore*, kurse forma *për me + pjesore* nuk kemi një denduri të madhe përdorimi ndryshe nga forma e parë. Forma *për me + pjesore* kryesisht përdoret me funksion qëllimor.

### 3. Kategoritë gramatikore të paskajores gege

Ndonëse është një formë e pashtjelluar e foljes, paskajorja gege ka disa kategori gramatikore, si: *diateza* dhe *koha*.

#### 3.1. Kategoria e diatezës

Në përgjithësi format e pashtjelluara, me përjashtim të pjesores e kanë kundërvënien formë *veprore*-formë *joveprore*, duke i dhënë edhe mundësinë e diatezës.

<sup>38</sup> N.Veselaj, *Paskajorja çështje e shqipes standarde*, Prishtinë 2000, f. 24.

<sup>39</sup> Po aty, f. 73.

Në dy veprat poetike të L.Dushit kemi përdorimin e formës *veprorë* dhe të formës *joveprorë* të formuar me pjesëzën me origjinë përemërore *u* për të dyja format e paskajores. Në rastin e paskajores me formë *joveprorë*, ka më shumë kuptim përsor, megjithatë duhet theksuar se paskajorja *joveprorë* përdoret më rrallë se ajo *veprorë*.

#### a. me + pjesore

**forma veprorë :** *ka me pa; ka me marrë; ka me lind; me pasë; me dijt; me mbyllë; me andrrue; me pi; me notue; me jetue; me vdekë; me pa; me lanë; me kenë; me falë; me lind; me prekë; me çilë; me kujtue; me qeshë; me ikë; me fjetë; me harrue; me frymue; me dashtë; me marr; me vujt etj.* Më poshtë po japim disa vargje nga vepra poetike e L. Dushit. Te mrina/Me ngjyrë t 'ngjyrë t 'krenueme/Fieri/Pret frymët/Ulen/**Me mbyllë** sytë/**Me andrrue...** (“*Kumbulla n 'dritore*”, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 55)

**forma joveprorë** e paskajores ndërtohet me ndihmën e pjesëzës me origjinë përemërore *u*, që vihet ndërmjet pjesëzës së paskajores dhe pjesores së foljes, si: *ka me u grimcue; me u çmendë; kanë me u futë; me u gëzue; nisin me u puthë; me u mësue; me u rritë; me iu afrue; me u mbyllë; s'ka me u korrë; me u pa; kam me u çmendë; me u kthye; kena me u harrue etj.* Më poshtë po japim disa vargje nga vepra poetike e L.Dushit: Tjegulla t 'bronxue/**Kanë me u futë**/N 'andrrën e detit...

\*\*\*

**Kena me u harrue**/Mbas orëve/Tue lind/N'nyje pemësh...

\*\*\*

Tue pritë **me u gëzue**/Me hungërim prej rane/Nisim e rrejmë vedin. (“*Mirë ardhte*”, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 76-77)

#### b. për me + pjesore

**forma veprorë:** *për me djegë; për me dashtë; për me varros; për me marrë; për me shndritë; për me prangue; për me ba etj.*

Vetmija/Rrite/Ndër Vneshta/**Për me ba**

(“*Vorri em*”, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f. 63)

**forma joveprorë:** *për me u këput; për me u mbyllë etj.*

Kur prej trupit/Zhdeshet/Dita që leh/Mbetet dëshira e bilbilave/**Për me u këput**/N'nji vend. (“*Humbje*”, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 52)

### 3.2. Kategoria gramatikore e kohës

Kuptimi i paskajores si një formë e pashtjelluar foljore që shpreh një veprim në mënyrë të përgjithësuar e të pacaktuar pajtohet me kategorinë gramatikore të kohës në kuptimin e mirëfilltë të saj. Nga të gjitha format foljore të pashtjelluara, paskajorja është forma që i është përshtatur më mirë kategorisë gramatikore të kohës. Në gegërishte ka pasur dy forma kohore të paskajores:

1) *me punue* si kohë e tashme e paskajores.

2) *me pasë punue* është quajtur paskajore e kryer ose e shkuar.

Në veprat poetike të L.Dushit “*Ave Maria bahet lot*” dhe “*Seancë dimnash*” vëmë re se paskajorja geqe përdoret në *kohën e tashme* dhe në *kohën e ardhme*.

**Koha e tashme.** Paskajorja e tashme shënon një veprim të pacaktuar në kohë. Koha e paskajores aktualizohet nga konteksti ku bën pjesë nga koha e foljes, prej së cilës varet e me të cilën hyn në lidhje, nga ndajfolje të kohës, nga fjalë të ndryshme treguese: përemra vectorë, dëftorë, nga intonacion etj. Më poshtë po japim paskajoren e kohës së tashme të vjelura nga dy vëllimet poetike të L. Dushit:



*me u çmendë, për me u këput, me pasë, me dijt, me mbyllë, me andrrue, me shtrëngue, me shtrëngue, me pi, për me marrë, me jetue, me lëshue, me ikë, me dashtë, me marrë, me vuejt etj.*

Po ilustruam me vargje konkrete.

Nata s 'din/**Me e lanë** tokën.../**Me kenë** vetëm/Kullë/Me rrajë/N'liqen.

(“*Stinë*”, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f. 12)

**Koha e ardhme.** Kuptimi kohor i paskajores përcaktohet dhe nga kuptimi leksikor i foljes drejtuese. Kështu, pas disa foljeve, kuptimi leksikor i të cilave përmban idenë e së ardhmes, paskajorja shënon një veprim që do të realizohet domosdoshmërisht pas veprimit të foljes drejtuese, prandaj ka shpesh kuptimin kohor të së ardhmes. Më poshtë po japim paskajoret me kuptimin e kohës së ardhme të vjelura nga dy vëllimet e L. Dushit:

*ka me e pa, ka me lind, ka me u grimcë, kanë me u futë, kam me vdekë, s'ka me thanë, s'ka me u korrë, kam me mbetë, kam me u çmendë, kam me vdekë, kam me kenë, kanë me këputë, s'kam me kenë, kam me pasë, kanë me i humbë etj.* Po ilustruam me vargje konkrete.

N'stinë/Dielli/**Ka me e pa**/N'bërthamë t'dashunisë/Tokën./N'fund/Lule-zemra/**Ka me u grimcë** (“*Kohë për shi*”, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 21)

### **Koha e ardhme e paskajores gege përballë të ardhmes së standardit**

Sipas gramatikës së gjuhës shqipe, në gjuhën e sotme letrare përdoren dy tipa të së ardhmes. Tipi i parë, që është mbizotëruesi ndërtohet duke i paravendosur pjesëzën *do* formave vetore të kohës së tashme të mënyrës lidhore, si : *do + të jem, do + të laj etj.* Tipi i dytë i së ardhmes, që përdoret më pak se i pari, ndërtohet duke i paravendosur formën së pashtjelluar të tipit për të larë, foljet ndihmëse *kam*, p.sh.: *kam për të larë, kam për të hapur etj.*<sup>40</sup>

Koha e ardhme me anë të paskajores gege ndërtohet nga folja ndihmëse *kam* dhe paskajorja e tipit

*me + pjesore.*

Gjatë studimit të paskajores gege që përdorë poetja L. Dushi, konkretisht të paskajores në kohën e ardhme, vëmë re nuancën e ndryshme kuptimore të kësaj paskajoreje të përdorur në kohën e ardhme në krahasim me kohën e ardhme të vetë standardit.

Kemi kundërvënien kuptimore mes së ardhmes në standard të tipit *do + të këpus* me formën e ardhme përmes paskajores të tipit *kam + me këputë*. Koha e ardhme e tipit *do + lidhore* shprehë dëshirueshmëri ose dëshirë, ndryshe nga forma e së ardhmes përmes paskajores gege *kam + paskajore*, e cila shpreh domosdoshmëri.

Më poshtë po japim një shembull krahasues mes dy poezive, njëra që i përket standardit e shkruar nga Kadare dhe tjera që i përket gegërishtes, e poetes L. Dushit.

#### Krahasojmë:

Hëna shpejt **do të zhduket** dhe netët

**do të mbeten** pa të kurse ti

në ëndërrimet e mia përjetë

perëndim **s'do të kesh** kurrsesi

(“*Ti dhe hëna*” I.Kadare)

Ngjyrat

e pangjyrat

**kanë me na i këputë**

sytë...

(“*Qeniet e paqeniet*” L.Dushi)

Siç edhe mund ta vëmë re te poezia “*Ti dhe hëna*” e Kadares forma *do + lidhore* shprehë një veprim me vështrim *dëshirë, vullneti*, kurse në poezinë “*Qeniet e paqeniet*” e Dushit forma e tipit *kam + paskajore* shprehë një veprim me kuptim detyrimi.

<sup>40</sup> Shih: *Gramatika e gjuhës shqipe* I, f. 290.

Këtë ndërtim të kohës së ardhme të mënyrës dëftore e gjejmë dendur në krijimtarinë e L.Dushit, p.sh: *kam + me u çmendë, kam + me vdekë, kam + me kenë, kanë + me këputë, s'kam + me kenë, kam + me pasë, kanë + me i humbë etj.* Më poshtë po ilustruam me vargje nga veprat poetike të L. Dushit.

**Kam me mbetë/N'Tokë/Me zemren/N'dritore/Ushqim/Për zogat e dimnit.**  
(“Gjendja A”, vepra poetike “Ave Maria bahet lot”, f. 64);

**Kam me vdekë/E përgjumun/N'përrallën/E të tjerëve.**  
(“Grueja ankth”, vepra poetike “Seancë dimnash”, f. 77 );

Gjatë studimit të kësaj forme të ndërtimit të paskajores nga folja ndihmëse *kam* dhe paskajorja e tipit *me + pjesore*, vëmë re se poetja e përdorë vetëm në kohën e ardhme të mënyrës dëftore dhe jo në kohën kushtore.

#### **4. Kategoria gramatikore e vetës së paskajores gege. Zbutja e abstraksionit nga folja parashoqëruese**

Në të vërtetë, veprimi i shprehur nga paskajorja lidhet me një subjekt të caktuar ose të pacaktuar, por vetë forma e saj nuk ka asnjë tregues që të shënojë *vetën* që e kryen ose e pëson këtë veprim<sup>41</sup>. Siç shprehet edhe S.Mansaku “*paskajorja, në të shumtën e rasteve të përdorimit, nuk shqërohet nga një kryefjalë që të mund të plotësonte mungesën e mbaresave vetore*”<sup>42</sup>, andaj paskajorja duke mos pasur tregues gramatikorë për të shënuar vetën, kur është e varur ka si subjekt në pjesën më të madhe të rasteve subjektin e foljes drejtuese. Kjo ndodh kryesisht në ato raste kur folja drejtuese dhe paskajorja e varur prej saj janë të lidhura shumë ngushtë midis tyre, kur kjo e fundit shërben për të plotësuar përmbajtjen e foljes drejtuese, si p.sh., në ndërtimet me *folje modale*, me *folje aspektive* etj., por edhe në shumë ndërtime të tjera.<sup>43</sup> Më poshtë po ilustruam me vargje të poetes dhe po analizojmë këtë që thamë më lart.

**mundem** (*mundesh, mundet, mundemi...*) **me i prekë.....**

Kujtohem/Për gjana/Që s'mundem/Me i prekë.  
(“Rroftë i vdekuni”, vepra poetike “Seancë dimnash”, f. 25 )

**ka** (*kemi, keni, kanë...*) **me lind.....**

Bufi/Sonte asht vjedhë/Prej folesë/Me kashtë t'pa rritun/Tue m'diftue/Se edhe dielli/**Ka me lind**

i rrejshëm.

(“Hanë e rrejshme”, vepra poetike “Ave Maria bahet lot”, f. 50)

---

<sup>41</sup> Duke u bazuar te gramatika fjali pavetore kemi quajtur ato fjali njëkryegjymtyrëshe, gjymtyra kryesore e të cilave shprehet me një folje që nuk ka kuptimin e vetës dhe shpreh veprim, ku vepruesi nuk shprehet. Kemi raste kur te fjalia pavetore gjymtyra kryesore shprehet me një togfjalësh. Në veprën poetike të L.Dushit hasim rastin e përdorimit të paskajores gege si pjesë ndërtuese e fjalive (vargjeve) pavetore. Fjalia pavetore, ndërtohet me një përemër të trajtës së shkurtër + foljen *vij + paskajorja gege*, këto ndërtime tregojnë gjendjen psikologjike, si *më vjen me qeshë etj.*

Më poshtë po ilustruam me vargje : *Ka vdekë/nji zog.../m'vjen/veç/me qeshë* (“Nji zog”, vepra poetike “Seancë dimnash” f. 43 ).

<sup>42</sup> Shih: S.Mansaku *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj*, Studime filologjike 1982, nr.1, f. 150.

<sup>43</sup> Po aty, f. 150.

Paskajoren gege e karakterizon abstraksioni mendor, pasi duke e marrë vetëm për vetëm ajo nuk ka kategori të që i karakterizojnë foljet e shtjelluara, si: *vetën, numrin, kohën etj.* Por kur ajo bashkëshoqërohet nga folje *ndihmëse* ose *gjysmëndihmëse* përcaktohet veta, numri etj. duke u zbutur edhe abstraksioni i paskajores.

### 5. Funkcionet sintaksore të paskajores gege në dy veprat poetike të L. Dushit

Në dy vëllimet poetike të L. Dushit vëmë re se paskajorja gege del e përdorur në këto funksione sintaksore:

1. qëllimore
2. përcaktore
3. kundrinore
4. shkakore
5. kryefjalore
6. kallëzuesore
7. rrjedhimore
8. mënyre
9. vendore

Më poshtë po ilustruam me vargje nga dy vëllimet poetike:

Larg prej themeleve/Ku kishin hedhë/Nji turr drush/Flaka u shkundte me akull/**Për mos me djegë gjithçka;** (qëllimore, *Mbas...Dite*, vepra poetike “*Ave maria bahet lot*”, f.7);

N’ dritoret e shiut/Fmija-vajzë/Kris kështjellat e nofullave/Tue i thirrë bukurçiles/Që **ka me e marrë.** (përcaktore, *Lot, lëshon kërthiza*, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 28);

Bufi/Sonte asht vjedhë/Prej folesë/Me kashtë t’pa rritun/Tue m’ diftue/Se edhe dielli/**Ka me lind**  
i rrejshëm. (kundrinore, *Hanë e rrejshme*, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 50);

Kam hapë bira n’ajr/**Për me marrë** frymën...  
(shkakore, *Mike*, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 78 );

Fëmija jem kjan/Se s’ don **me u rritë.**  
(shkakore, *Fëmija kjan*, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f. 21);

Kaq e mbytn/Fryma eme/Sa s’ mundet/**Me thirrë**/As Vedin...  
(rrjedhimore, *Tetor*, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f. 50);

Dhelprat turren/**Me u çmendë**/Rrëzueshëm bjeshkëve.  
(kallëzuesore, *Nesër plakem*, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 34);

Kam gjetë masën e fjalëve/Që thohet/**Për me t’u këput** zemra.  
(kryefjalore, *Jeta asht ba drapën*, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 49);

N’ fund/N’ kërkim/Tue pritë **me u gëzue**/Me hungërim prej rane/Nisim e rrejshëm vedin.  
(mënyre, *Mirë ardhhtë*, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 77 );

Lulet s’ e dinë/Ku shkohet **me vdekë**...  
(vendore, *Kryet e hanës*, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f. 17).

Siç edhe e shikuar më sipër paskajorja gege në dy vëllimet poetike “*Ave Maria bahet lot*” dhe “*Seancë dimnash*” përdoret dendur në funksionin qëllimor, kundrinor, përcaktor e më pak në funksionet e tjera. Ndryshe nga forma e pashtjelluar e tipi *për të lexuar* e cila edhe sipas gramatikës së gjuhës shqipe ka përdorim të kufizuar në ndërtime me funksion kundrinor, po ashtu edhe në ndërtimet me funksion kryefjalor. Pavarësisht se nuk e gjejmë dendur në të gjitha funksionet e tjera në këto dy vëllime poetike, kjo nuk do të thotë se paskajorja gege nuk ka mundësi përdorimi në funksione të ndryshme sintaksore, pasi poetja nuk besoj që e ka pasur qëllim në vetvete përdorimin e këtyre funksione, por çdo funksion ka ardhur natyrshëm përmes vargut artistik e botëkuptimit të autores, që tregon qartë se paskajorja gege ndonëse formë e pashtjelluar përdoret me funksione të ndryshme sintaksore, ashtu siç përdoren format e shtjelluara.

## 6. Paskajorja gege si pjesë e ndërtimeve foljore me foljegjysmëndihmëse me vlerë modale në veprën poetike të L. Dushit

*Foljet modale* quhen ato që shërbejnë për të shprehur modalitetin në lidhje me veprimin e shprehur nga folja ndjekëse. Pas foljeve modale vjen një folje në mënyrën lidhore ose një formë e pashtjelluara. Si folje modale përdoren: *mund* + folje në mënyrën *lidhore*, *duhet* + folje në mënyrën *lidhore* ose *pjesore*, *do* + *pjesore*, si edhe foljet ndihmëse *kam* dhe *jam* të ndjekur nga forma e pashtjelluar e tipit *për të* + *pjesore*. Foljet me vlerë modale e humbasin mëvetësinë si folje të zakonshme, të cilat po të merren të shkëputura nga togfjalëshi ku bëjnë pjesë nuk kryejnë funksionin e kallëzuesit. Paskajorja gege *me* + *pjesore* del e përdorur pas foljeve me vlerë modale, të cilat shërbejnë për ta paraqitur veprimin e shprehur nga folja ndjekëse si të mundshëm, të detyrueshëm ose të domosdoshëm, ndryshe nga forma e pashtjelluar e tipit *për të* + *pjesore*, e cila sipas gramatikës shqipe “*nuk përdoret pas foljes me vlerë modale mund; pas këtyre foljeve në gjuhën e sotme letrare përdoret rregullisht mënyra lidhore.*”<sup>44</sup>

Konkretisht në veprën poetike të L. Dushit vëmë re foljen me vlerë modale që shpreh *domosdoshmëri* e kryerjes së veprimit si: *duhet* + *me kenë*, por edhe foljen me vlerë modale që shpreh *mundësinë* e kryerjes së veprimit si: *mundet* + *me thirrë*, *mundem* + *me jetue* (*me jetue s'mundem*), *mundem* + *me prekë*, *mundem* + *me kujtue* (*mundem ende me kujtue*) etj. Më poshtë po ilustruam disa vargje nga veprat poetike të marra në analizë:

Gjallë **duhet me kenë**/Guackat/Që nga herë/N 'gushë m 'i varshin zemrat.

(“*Prej detit, shija*”, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 87);

Kaq e mbytun/Fryma eme,/Sa s '**mundet/Me thirrë**/As Vedin...

(“*Tetor*”, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f. 51);

Kujtohem/Për gjana/Që s '**mundem/Me i prekë**.

(“*Rroftë i vdekuni*”, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f. 25 );

**Me jetue s'mundem/Me vdekë s'due...**

(“*Vedja*”, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f. 6 ).

Në poezinë “*Vedja*” siç edhe e shohim në shembullin e mësipërm kemi një rast të veçantë të përdorimit të foljes modale *mundem* + *me jetue*, përmes inversionit theksi logjik bie mbi paskajoren *me jetue*.

### 6.1. Paskajorja gege pjesë përbërëse e foljeve që shprehin mënyrën e veprimit

<sup>44</sup> Shih: *Gramatika e gjuhës shqipe I*. f. 341.

Janë ato folje që në disa togfjalësha të caktuar përdoren për të shprehur *fillimin, vazhdimin, rritjen progresive ose mbarimin e veprimit* të emërtuar nga folja ndjekëse.<sup>45</sup> Si folje që shënojnë fillimin e veprimit në gramatikën e shqipes përdoren foljet *zë, nis, filloj* + folje në mënyrën *lidhore*; si folje për të shënuar vazhdimin e veprimit përdoren foljet *vazhdoj e vijoj* + folje në mënyrën *lidhore*; për rritjen progresive të veprimit përdoret folja *vij* e ndjekur nga përcjellorja; si folje për të shprehur mbarimin e veprimit kryesisht folja *mbaroi, pushoi* + emër *prejfoljor* asnjans. Paskajorja gege *me+pjesore* del e përdorur edhe në përbërjen e foljeve që shprehin mënyrën e veprimit si fillimin, vazhdimin dhe mbarimin e veprimit të emërtuar nga folja ndjekëse. Më poshtë po ilustruam vargje nga veprat poetike:  
Atëherë/Unë mpakem/Strukem n 'brij/**Nisi me gdhendë**/Vdekjen e plagëve.  
(“*Mbas..Dite*”, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 8 );

Nata ra edhe mbi pyll/Shtazët/**Nisin me u puthë**...  
(“*Andrra*”, vepra poetike “*Ave Maria bahet lot*”, f. 85);

Tash/Po **filloj/Me u mësue**/Me vedin.  
(“*Vedja*”, vepra poetike “*Seancë dimnash*”, f. 6).

Në veprën poetike të L. Dushit vëmë re përdorimin e foljes që shpreh fillimin e një veprimi, si: *nisi + me gdhendë, nisim + me u puthë, filloj + me u mësue etj.*

### **Në vend të përfundimit**

#### **A duhet të integrohet paskajorja gege në standard marrë shkas edhe nga përdorimi i saj në letërsi?**

Kemi menduar që përfundimet t'i nxjerrim jo në formën e zakonshme, por në formën e diskutimeve, duke shkrehur edhe mendimet tona rreth kësaj forme foljore. Për të folur në lidhje me integrimin e paskajores në standard duhet të ndalemi fillimisht se çfarë kuptojmë me fjalët *integrim* të *paskajorjes*.

Me integrim të paskajores kuptojmë ruajtjen e autonomisë kuptimore e stilistike në raport me trajtat e tjera sinonimike me të cilat është në konkurrencë paskajorja gege.

Paskajorja gege nuk krahasohet me elementet e tjera të dialektit gegë, pasi është një element i veçantë. Ajo është pasqyrë e njëkohësisht treguese e gurrës së filozofisë popullore që vjen nga një përvojë e gjatë historike duke përbërë kështu pasurinë shpirtërore të këtij populli. Abstraksioni i lartë që ka paskajorja gege e bën atë të rishikohet për integrim, sidomos brenda shprehjeve frazeologjike, të cilat nuk mund të shprehen me forma të tjera ndër-këmbëse p. sh. nëse marrim në krahasim dy raste kur përdoret shprehja frazeologjike e njohur pothuajse nga të gjithë “*Me ndejtë shtrembët e me folë drejt*” në këtë rast përdorimi me paskajore ka karakteristikë përgjithësuese të qëllimtë dhe nuk i drejtohet dikujt në mënyrë direkte por çdokujt, ku përmes kësaj forme të shprehuri nuk preket askush në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ndërsa po ta zëvendësojmë me një trajtë tjetër foljore si “*Të rrimë shtrembur e të flasim drejt*” kemi konkretizim të qëllimshëm se kujt i drejtohet, ku përcaktohet veta, numri, koha, mënyra, pra konkretizimi bëhet me tregues gramatikor të vetës. Duke marrë parasysh sistemin leksikor e fjalëformues të shqipes i cili është i hapur, pse të mos pranojmë ato njësi frazeologjike që e pasurojnë gjuhën shqipe, të cilat në përbërje të tyre kanë paskajoren gege si formë abstraguese, përgjithësuese.

Paskajorja gege shihet edhe si përbashkuese me gjuhët indoevropiane ndonëse me karakter analitik me + pjesore “*është kategori e vetme foljore me barasvlerësi të plotë kundrejt*

---

<sup>45</sup> Shih: *Gramatika e gjuhës shqipe* I. f. 264.

*infinitivitet të gjuhëve indoevropiane dhe të tjera që janë të pajisura me këtë kategori, ku forma e paskajores mund të dalë si formë e vetme përfaqësuese e foljes*"<sup>46</sup>.

Përmes paskajores gege përcillet ana ideo-estetike letrare. Siç shprehet edhe N. Veselaj "*çdo shqipfolës i brezave më të rinj në të ardhmen do ta ketë të vështirë të mund të shijojë dhe të kuptojë bukurinë artistike të thesarit tonë të traditës të shprehur me ndihmën e formës së paskajores*".<sup>47</sup>

Këtë cilësi të paskajores e pamë edhe tek poezitë e L. Dushit, ku secila ka një ide estetiko-emocionale, që nuk mund të zëvendësohet me forma alternative sepse përveçse humbet origjinaliteti, nuk arrihet të përcillet efekti estetik e ideor që ka në vetvete paskajorja gege. Edhe pse në këtë rast kemi të bëjmë me një vepër letrare, kjo s'do thotë që në jetën e përditshme mungesa e paskajores nuk përbën problem në shprehjen e ideve dhe botës sonë, pasi ajo përbën palcën, indentitetin e popullit.

Paskajorja gege i përmbush funksionet sintaksore që "*mund të kryejë si fjalë bosht në togfjalëshja a si gjymtyrë kryesore sintagmore mund të ndeshet në të gjitha llojet e fjalive e të periudhave duke i kaluar kufijtë e një elementi të thjeshtë dialektor*"<sup>48</sup> ndryshe nga forma e dytë e tipit *për të + pjesore* e cila del me funksionet të kufizuara. Siç edhe e pamë në dy vëllimet poetike të L. Dushit paskajorja gege përdorej dendur në funksionin qëllimor, kundrinor, përcaktor e më pak në funksionet kryefjalore, kallëzuesore, shkakore, vendore, mënyrore e rrjedhimore. Edhe pse te poezitë e L. Dushit nuk hasëm të gjitha rastet në të cilat mund të dalë paskajorja gege, mund të themi se kjo varet nga pikësynimi i poetes në të shkruar, por kjo se bën paskajoren gege të kufizuar në të gjitha përdorimet e tjera.

Paskajorja gege del në disa forma, si: *me punue, për me punue, për të punue*. Gjatë vjeljes së paskajores në vëllimet poetike të L. Dushit dolëm në përfundime se ajo përdor dy forma të paskajores gege. Denduri të madhe përdorimi kishte forma e tipit *me + pjesore*, në krahasim me formën e dytë që përdorë, atë të tipit *për me + pjesore*. Paskajorja gege ndonëse formë e pashtjelluar, ajo ka kategori gramatikore, të cilat ia shtojnë veçantësinë e saj. Ajo gëzon kategorinë e diatezës e të kohës. Konkretisht në veprat e L. Dushit gjatë studimit pamë se paskajorja gege del e përdorur në diatezen *veprorë* dhe *joveprorë*. Në rastin e kategorisë së kohës pamë se përdorej vetëm në kohën e ardhme dhe të tashme. Ajo çfarë e bën interesante kategorinë e kohës te paskajorja gege, konkretisht kohën e ardhme është nuanca kuptimore që e dallon atë nga koha e ardhme e standardit. Kjo sepse koha e ardhme e standardit shprehë një veprim me vështrim *dëshire, vullneti*, ndryshe nga e ardhmja e paskajores gege që shprehë një veprim me kuptim *detyrimi* ( *Kanë me na i këputë sytë - Hëna shpejt do të zhduket*).

Paskajoren gege e pamë edhe si pjesë përbërëse të kallëzuesve të përbërë në veprën poetike të L. Dushit, si p.sh: *gjallë duhet me kenë, sa s'mundem me thirrë, nisi me gdhendë, nisin me u puthë, filloj me u mësue* etj. që shprehin modalitetin por edhe mënyrën e veprimit duke e emërtuar atë.

Pavarësisht të gjithave, arsyeja që pengon ose që mund ta quajmë problematike në rastin e integritetit të paskajores gege janë *pjesoret* e gegërishtes duke qenë se ato janë në forma heterogjene kundrejt atyre të toskërishtes. Kjo mendohet se sjellë pengesë e prishje të strukturës morfo-sintaksore. Theksojmë se e bëjmë tonin mendimin e N. Veselaj dhe të B. Bokshit pasi integrimi nuk përbën prishje të strukturës morfo-sintaksore për sa kohë sjellim në kujtesë se mbi bazën e pjesores së gegërishtes kanë hyrë në standard format e habitores : *la-kam, thye-kam*, etj ; mbiemrat prejpjesorë me - *shëm* : *i thye-shëm, i punue-shëm* etj ;

<sup>46</sup> Po aty, f. 26

<sup>47</sup> N. Veselaj, *Paskajorja çështje e shqipes standarde*, Prishtinë 2000, f. 76.

<sup>48</sup> Po aty , f. 154

emrat e vepruesit : *mësue-s, lexue-s, mbjellë-s, etj.* Po ashtu disa "togfjalësha frazeologjike në funksion të lidhëzës a të ndajfoljes si : *domethënë, meqenëse, me thënë të drejtën etj*"<sup>49</sup>

Në rastin e pjesoreve ato që kanë temë me bashtingëllore sonante dhe që mbarojnë me - n mbeten të njëjta për dy dialektet, siç shprehet edhe Bokshi "*kjo formë e përbashkët e pjesores e lehtëson përdorimin e paskajores me + pjesore brenda gjuhës së folur standarde : me vjelë, me marrë, me lënë etj, ndihmuar edhe nga format e pranuar më parë në toskërishte si : me thënë, me qenë*".<sup>50</sup>

Kurse për pjesoret me prapashtesën *ur/ r (ë)* që është nga më të diskutueshmet të lihet alternativë zgjedhje siç propozon edhe Veselaj : *me punue /me punuar, me ble / me blerë, me bë / me bërë,*

*me vendosë/ me vendosur, me punue/ me punuar etj,* që pavarësisht shqiptimit thekson Veselaj "*forma e pjesores mbi bazë të gegërishtes tipit : me la, me pëlqye et.j është e lejueshme të përdoret vetëm si gjymtyrë e paskajores dhe jo të shtrihet në format e tjera analitike jo kam punue por kam punuar*"<sup>51</sup> duke respektuar kështu rregullat e drejtshkrimit dhe rregullat e tjera gramatikore të shqipes gjatë përdorimit të paskajores. Kundërvënia e formave të pjesoreve u vu re edhe te veprat poetike të L. Dushit, ç'ka dëshmon se këto forma përdoren edhe në krijimet artistike dhe jo vetëm në idiomën e folur. Kundërvëniet që vume re ishin kundërvënie *-ur* dhe *-ë* , si kundërvënie mes pjesores gege dhe pjesores së standardit (puthë-puthur, fjetë-fjetur, dashtë-dashur etj), po ashtu kundërvëniet *-r(ë)* me 0 (zero) të cilat i evidentuam gjatë vjeljes (grimcë-grimcuar, frymë-frymuar, andrrue-ëndërruar etj).

Integrimi i paskajores duhet parë edhe në këndvështrimin sociolinguistik. Shoqëria përmes nevojave të saj komunikuese dhe përdorimi në masë i saj do bëjë që ajo të jetë pjesë e standardit ose jo, por mendojmë se është e nevojshme nga gjuhëtarët të rishikohen, të diskutohen problematikat e standardit dhe rregullat e vendosura më parë, në mënyrë që folësit e shqipes ta kenë më të lehtë komunikimin mes njëri-tjetrit dhe jo ta vështirësojnë atë përmes politikave të ngurta gjuhësore. Mospërdorimi i paskajores dhe zëvendësimi me trajtat e toskërishtes shkakton barriera gjatë të folurit. Andaj lejimi i përdorimit alternativ të paskajores gege, si edhe të pjesoreve të saj, do të bëjë që shqipja të ketë një fazë normale zhvillimi duke mos iu shmatur zhvillimit të natyrshëm, por gjithmonë brenda kufijve të standardit.

Mendojmë se integrimi i kësaj forme nuk duhet parë si barrierë për toskërishten, po ashtu nuk duhet parë si detyrim tek individët që nuk e ndjejnë të nevojshëm përdorimin e saj. Në të tilla raste të lihet një konkurrencë e lirë mes paskajores gege dhe formave dytësore si *lidhorja*, forma e tipit *për të + pjesore* e të tjera është zgjidhja më e pranueshme e problemit të paskajores

## BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I* , Tiranë, 2002.
- Domi, M, Ajeti, I, " *Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot* ", në Konferenca shkencore " *Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot* ", Tiranë 20-21 nëntor 1992.
- Ismajli, Rexhep, *Gjuhë standarde dhe histori indentitesh* , Tiranë, 2005.
- Mansaku, Seit, *Humbja e paskajores në gjuhën shqipe, hipoteza dhe të vërteta shkencore*, Studimet albanistike në Amerikë, Aktet e konferencës shkencore të ASHAK, Prishtinë, shtator 2015, Prishtinë, 2016.

<sup>49</sup> Po aty, f. 133

<sup>50</sup> B.Bokshi *Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë"Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit" Botime albanologjike, Tiranë, 2011, f. 159-160

<sup>51</sup> N.Veselaj, *Paskajorja çështje e shqipes standarde*, Prishtinë 2000 f. 149- 150

- Mansaku, Seit, *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë e saj gramatikore*, Studime filologjike 1982, nr. 1.
- Pipa, Arshi, *Politika e gjuhës në Shqipërinë socialiste*, Botime Princi, Tiranë, 2010.
- Topalli, Kolec, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011.
- Osmani, Tomor, *Shekulli i Komisionit Letrar në Shkodër(1916-1918) 100 vjet të rrugëtimit të saj*, Tiranë, 2016.
- *Shqipja në etapën e sotme: Politikën e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Botime albanologjike, Tiranë, 2011.
- Veselaj, Nuhi, *Paskajorja çështje e shqipes standarde*, Prishtinë, 2000 .

**Letërsi e vjelë:**

- Dushi, Ledia, *Ave Maria bahet lot*, Tiranë, 1997.
- Dushi, Ledia, *Seancë dimnash*, Shtëpia botuese “Camaj-Pipaj”, Shkodër, 1999.



## ▪Filozofi▪

**Alessandro PREVER**

### FRAGMENTE FILOZOFIJET

E përktheu nga italishtja: Edion Petruti

“Papa Ratzinger (kërkimi i qytetnimit mesjetarë në bashkëkohësi) dhe Umberto Eco (kërkimi i bashkëkohësis në Mesjetë): Nji kontrast i pashërueshëm”

Ka vdekë sot Papa Ratzinger, nji njeri qi sipas meje ka pasë nji randësi vendimtare në Kishën Katholike nga post Koncilli gjer më sot, edhe pse jo të tânë e kanë vûe re këtë fakt. Dhe kjo sepse, ka kënë aj qi ka interpretue (sigurisht në sens konservator) Koncillin Vatikan II, kur kje sekretar i Kongregacionit të Doktrinës së Besimit ndën pontifikatin e papës Gjon Pali II. Dhe meqense Koncilli Vatikan II ka kënë Koncilli mâ i randësishmi pas Koncillit të Trentit, Ratzinger-i ka pasë të njejtin rol të kardinalit Bellarmino (pas Koncillit të Trentit). Roli i nji interpretuesi të madh të nji Koncilli Epokal, rol për të cilin lypen e nevojiten inteligjencë dhe nji kulturë tepër e thellë.

Edhe si papë, unë besoj se ka kënë edhe mâ i madh se ç’ë kanë konsiderue deri mâ sot. Të mos harrojmë guximën e tij për me u përballë me stuhinë e pedofilisë, - kurajë qi para Tij kish mungue, - përpjekjen e tij të sinqertë (jo tanësisht e arritun) për me shërue financat vaticanase, si dhe përpjekjet e tij (sigurisht jo të kuptueme prej tânë Botës Katholike), ama pa dyshim të drejta për me rifutë edhe nji herë në kishë Liturgjinë Latine si nji alternativë opcjonale ndaj Rritit të futun në kishë prej Vatikanit II.

Deshta me shtjellue megjithatë nji pikë, të studimevet të tij si teolog (pa dyshim nji prej tre a katër teologëvev katolikë mâ të mëdhëj të shekullit XX) dhe qi i perket në mënyrë të veçantë skolastikës, ose mâ mirë nji shekulli të veçantë të skolastikës e dmth. shekullin XIII. N’atë shekull, kambanoret, kishat, manastiret dhe universitetet shpeshherë kjënë vende polemikash t’ashpra dhe filozofijet së naltë (dishkà qi nuk mund të bâhet veçse në kontrastet pjellore të opinionevet).

Kishin lindë urdhnat mendikante dhe shkolla françeskane shpeshherë i shkonte kundër shkollës domenikane mi atë qi kje problemi i madh filozofik i shekullit, d.m.th. marrëdhânja mes Besimit dhe Arsyës.

E nëse Besimi kishte të bânte me tekstet e shêjta (Bibla e Ungjilli për krishtenimin, qi tue kjenë Fjalë e Hyjit, e qi vjen nga nalt, duhen pikërisht me u pranue me anë të Besimit, kah ana tjetër Arsyëja kishte të bânte me mënyrat dhe format e arsyetimit njerëzorë. A kje e mundun qi Besimi dhe Arsyëja me u sintetizue harmonikisht apo duhet me e injorue - madje, me iu kundërvûe - njâna-tjetrës? Kjo âsht edhe thema e studiueme gjatë nji jete të tânë prej nji theologut të randësishëm si Ratzinger-i.

Na e dijmë se urdhni domenikan - gjithmonë tue ndjekë gjurmët e Shën Tomës, - ka me besue gjithmonë në nji integrim e iluminim të ndërsjellë të Besimit dhe Arsyës, dhe gjithmonë ka me e mbrojtë këtë pozicjon. (Jo mâ kot do t’i besohet urdhnit domenikan dikasteri i Inkuizicionit).

Në vend të kësaj, në urdhnin françeskan, nji pasigurí e trazim mbi mundësin e integritit pjellor e reciprok mes Besimit dhe Arsyës ka me sjellë më 1300 në ndarjen përfundimtare,

me theologë të mëdhëj si Skoti (doctor subtilis) dhe Okami, dhe në hapjen kahë protestantizma dhe epoka moderne.

Skoti dhe Okami për shembull kanë me refuzue provat tomistike të ekzistencës së Zotit dhe pikërisht pra të integritit mes Besimit e Arsyes.

Për ta, sfera e arsyes është në vetvete e vlefshme dhe e dobishme, ama e pamvarun prej çështjeve të Besimit.

Problemi pra lind për atë qi nis prej Besimit si trashëgimí e padiskutueshme, pasi buron prej Hyjit (Ungjilli e Bibla, e brendia e tyne) si tip i arsyes njerëzore dhe mâ e përshtatshme për me u sintetizue me librat e mëdhëj të traditës së krishtenë.

Më 1200 bâhej fjalë me zgjedhë mes platonizmës e aristotelizmës si forma të arsyes për me integruë dhe mbështetë Besimin.

Në atë shekull vendosen në dispozicion për të parën herë (falë auktorëvet arabë) përkthime të reja të Aristotelit dhe kështu pra vëhet për të parën herë para në mënyrë të pastër e të rregullt një zgjedhje mes aristotelizmit dhe platonizmit.

E dijmë qi dy theologët ma të mëdhëjtë e shekullit, dmth. Bonaventura e Toma bâjnë një zgjedhje të kundërt.

Toma zgjedhë Aristotelin, Bonaventura Platonin.

Theologët e shkollës françeskane janë ata qi e vëjnë mâ shumë zgjedhjen e Aristotelit si përfaqësues të arsyes së krishterë, siç tregojnë edhe pozicionet e ashpra të Provincjalit të tyne Bonaventurës.

E qi prej aty e pak ma shumë (pasi Kisha Zyrtare ka me preferue gjithmonë Shën Tomën) kanë me zgjedhë me theologët e tyne të mëdhëj qi tashmâ bien era herezî, për pamvarsín e plotë, totale mes Besimit e Arsyes.

Është e interesantshme qi Ratzinger-i (qi ka me u bâ mâ pas Mbrojtës i Besimit), në sprovën e tij të shkëlqyeme “San Bonaventura“ merr anën e platonizmës si formë mâ e mirë e arsyes me integruë e mbështetë Besimin qi rrjedhë e buron prej librat e mëdhëj të krishterë (Bibla dhe Ungjilli). Dhe për këtë arsye - pasi tepër antitomistë - ka me pasë probleme me Uficin e Shëjtë.

Edhe dishkà tjetër.

Nëse krishtenimi në thelb të vet është një synthezë mes traditave të Librit dhe një formë (pak a shumë e përshtatshme) arsyeje njerëzore, çka me thënë mbi synthezën mes krishtenimit dhe shkencës moderne?

A mundet shkenca moderne të jetë si arsye, një mbështetje solide ndaj traditës biblike, apo papërrputshmënia e tyne e sjellë qytetënimin tonë shkencor përherë e mâ shumë drejt skajeve të atheizmit?

Edhe mbi integritin e mundshëm, dhe empatín mes arsyes shkencore dhe traditës biblike, punimet e Ratzinger-it (qi ishte shumë i përgatitë mbi shkencën moderne e bashkëkohore) janë me të vërtetë shumë interesante.

Me pak fjalë, gjendemi përballë një Pape qi nëse kishte një kufi (të paktën për njerëzit e zakonshëm) ishte aj i të kjenit tepër inteligjent.

\* \* \*

Umberto Eco shkruen: “Ratzinger-i nuk është një filozof i madh, e as një theolog i madh, edhe pse përgjithësisht paraqitet si i tillë. Polemikën e tij, lufta e tij kundër relativizmit - sipas mendimit tëm - janë thjesht shumë të trasha dhe as edhe një nxënës i arsimit të detyruem kish me i formulue si aj. Formimi i tij filozofik është jashtëzakonisht i dobtë. Në gjashtë muej, unë vehtë kisha muejtë me organizue një seminar mbi temën e relativizmit. Mund të jemi të sigurt qi në fund kisha me paraqitë të paktën një pozicione të ndryshme filozofike. Me i bâ bashkë siç bân papa Benedikti XVI, sikur të ishin një pozicione unitar, është jashtëzakonisht naive“.

Nisem prej kësaj kritike bâmë Ratzinger-it nga ana e Umberto Eco-s, të botueme në grupin „Officina di Filosofia Teoretica“ nga Giorgio Lecchi.

Më duket kjo e Eco-s një pozicion i tepruem dhe disi i mënishëm. Ndoshta është një përgjigje ndaj Ratzinger-it që e kishte përkufizue „Ëmni e trandafilit“ asgjë mangu veç një best selleri. Edhe ky pohim i Ratzinger-it më duket pak i tepruem, sepse e kam konsiderue gjithmonë „Ëmni e trandafilit“ si romanin më të arrimë të Eco-s.

Ndoshta ka pasë ndonjë farë mënjete mes të dyvet, ndaj dhe për këtë arsye këto vlerësime të ndërsjella janë që të dyja pak të teprueme dhe të shtrëmbëta.

Ama ka një arsye themeli që i shpjegon.

Eco ka kënë një studjues i madh i Filozofisë Mesjetare dhe veçantësisht admirues i Okamit (një prej mësuesvet në universitetin e Torinos ka kënë Abbagnano, që ka shkruar një sprovë të randësishme pikërisht mbi Okamin).

Dhe mendoj që Williami i „Ëmni të trandafilit“ - edhe pse Eco nuk e ka shprehë në mënyrë eksplicite - është pikërisht Williami i Okamit.

Tash nuk ka pikë dyshimi që Okami dhe Skoti (dy teologë të shkollës françeskanë, më të mëdhjetë e viteve 1300) kanë pasë një rol themeltarë në Mendimin Njerëzor. Në të vërtetë, edhe pse në mënyrë të ndryshme njëri prej tjetrit, dy teologët e mëdhjë françeskanë kanë kontribue me e zbutë dhe me e hollue raportin Arsye-Besim. Tek ata, sfera e arsyes autonomizohet prej sferës së Besimit, gjithmonë tue i mbajtë të dy sferat (të Arsyes dhe të Besimit një vlefshmëri në vetë brendin e tyre).

Arsyeja ka të baje me Mendimin Njerëzor, Besimi me të besuemit.

Kjo ka me na sjellë më pas te „Sola Scriptura“ e protestanizmit dhe më pas te moderniteti filozofik (që priret gjithmonë e më tepër ta shquejë Besimin prej Arsyes, të besuemit prej të menduemit.)

Shkenca moderne kur merr e studjon yjet, kërkon sërish të Vërtetën në lëvizjen e tyre, në përbamjen e tyre materjale, por nuk ka me kërkue më në ta - siç bënte platoniku Augustin - bukurin dhe sidomos mirësin.

Ndamje pra mes Besimit dhe Arsyes, Mirësis e Bukurisë, dhe arsyes.

Kjo është shifra e modernitetit, por jo e Mesjetës, as e lashtësis.

Dhe Ratzinger-i, tue kënë një studjues i madh i Mesjetës, kërkon në një modernitet - që shpeshherë duket se e mohon dhe i kthen krahët - pikërisht raportin dhe synthezën mes Besimit dhe Arsyes.

Në vend të kësaj, Eco nuk i beson dhe nuk mundet me i besue (ama tue dashtë veçanërisht Mesjetën), kërkon te Mesjeta pikërisht ata teologë që e kanë ndë më dysh raportin Besim-Arsye, tue e ndryshue qytetnimin me të vërtetën.

Me pak fjalë, qëllon që edhe njerëzit më inteligjentët (mes të cilëve gjinden pa dyshim Ratzinger-i dhe Eco), kuer janë në lojë vizjonet dhe idetë me të cilat janë veçantësisht të lidhun, të tejkalojnë cakun (sidomos Eco do të thoja në këtë rast) e polemikës.

*31 dhjetuar - 7 kallënduar 2023*

## ▪Recensione▪

### Gjovalin Çuni

Libri “Perndjekja e Hajrije Mulletit. Stigma e nje drame” i autores Fatbardha Mulleti

Te nderuem miq, vuajtes e bashkevuajtes, zoja e zotnij, miresekeni ardhe ne promovimin ma te ri te Fatbardha Saracit (Mulletit) Perndjekja e Hajrije Mulletit. Stigma e nje drame.

Kam paraqite shpesh here, por kesaj radhe ishte me te vertete e veshtire e keshtu vendosja t’ju percjell mendimet e Prof. Sami Repishtit.

Komedia grotesk e butaforesk “Prefekti”, si pjese e nji biblioteke tane te realizmit socialist, mjet ndihmës I propagandes ideologjike, ushqim I randsishëm për një publik të izoluar që ishte I kushtezuar të ndiqte vetëm disa orë programe televizive, u shkru nuk po I tham ne kohën e diktatures së po e randoj shume, por po I tham njashu sic I thote prof.Repishiti në kohën e formimit të “njeriut tonë të ri” që ishte një monstruoizitet I shekullit XX, nji boshlllek moral, dhe nje robot që ka hjeke dorë më kenë I lirë e me farktue me duert e veta nje jetë që plotëson kërkesat e tij si individ, e si pjestar I nji shoqnie civile.

Fatkeqsia e dyte për “njeriun e ri” asht edhe boshlleku I krijuem (vrasja e burgosja) e elitave e vlerave dhe zevendesimi I tyne me antivlera që e çoroditën plotesisht personalitetin e qytetarit shqiptar, e shkaterruen edhe gjurmen mate vogël te traditave shekullore shqiptare e përfunduan në një rrugë pafund në një “qorrsakak” ku ai mbeti I gozhduem për 45 vjet me radhë pa shpresë lirimidhe në gjëndje të një skllavërie të tejskajshme.

Sollzhenici I pvetun per komunizmin gjegjej : Komunizmi ! Rregjim terrori e kulturë e gënjeshtër.

Kulturë gënjeshter, ndoshta edhe genocidale ka kene komedia Prefekti, e shkruar nga Besim Lëvonja,me personazhe tanësisht reale e ç’ka asht ma e keqja edhe qe jetonin, e vene ne skenen e teatrit popullor nga trupa regjizoriale dhe aktoresh me mbeshtje teknike, e shfaqun ne tana skenat shqiptare te teatrove dhe te vatra te kultures e prodhur si film që vijon e shfaqet , e që shoqërohej me të qeshuara te pafundme, njerezish mes te cileve edhe une, qe se fundi nuk ishim ne vehte.

Terrori e kultura e gënjeshtërës ka rëndu edhe mbi një pjesë të kësaj sallë, një pjesë e të cilëve kanë kalue burgj e nje pjese persekutim per të afërmit.

Në ditë tona asht fat të kemi “zera të kujtesës”, asht fat me e pase në jetë Bardhën, asht fat me pase kete vajzë, ketë grue, këtë nanë, këtë gjyshe (Zoti ja ka plotesue të tana) për me vijue një punëtë fillueme e fatkeqsisht të mbetun në vend, riformin e shoqnisë shqiptare, tuj fillu njatu ku duhet te te rijte, që fatkeqsisht janë tuj u largue përditë me dëshirën e tyne e me pëlqimin tonë si prindër o gjysha.

Bardha ka gjete edhe celesin e riformimit, që asht pikërisht libri. Librin, veprën artistike e vlerësonte edhe diktatori si mjetin bazë që duhet ti shërbeje formimit të njeriut.

Të njajtën armë përdorë edhe Bardha për t’ju kundërvënë së keqes, e për me skjaurue se shkrimtarët e librat e botuem gjatë komunizmit, në një pjesë e tyne janë krejtësiht fallco sepse në fakt ato i shërbenin njeriut të ri “një gënjeshtër” e madhe, sepse ata il shërbenin kthimit të tyne në servilë të pushtetit, në gënjeshtar, në persona pa pikë morali etik.

E puna që ka ndërmarrë Bardha e sa të tjerë nuk asht aspak e lehtë , për arsye se edhe mbas viteve ’90 , vijon të shpërndahet falciteti, e të mbrohet nostalgjia, nga skerma nuk asht hjeke as Prefekti, megjithë realitetin e trishte te shkrueme tashma, megjithë fatkeqsitë njerëzore të shkatuara nga kjo komedi, jo, jo prap vijon te shfaqet ai dhe te tjerë, çdo ditë e në kanale të dedikuara, me një llogjikë perverse të aktrimit.

E pse ndodh kjo ? Repishti e quan aspekt i tragjedisë së shoqnisë shqiptare. Mos besimin e ndërsjelltë qeveri qytetar ai e cilëson dikotomi fatale, e shënja e parë e kësaj gjëndjeje asht refuzimi ase indiferenca me votue.

Gjendemi para një dileme ekzistenciale ose shoqëni civile autentike të fortë e një qeveri të dobët ose një qeveri të fortë dhe një shoqëni civile shqiptare të dobët.

Në përfundim na mbetet vetëm një ngushëllim breznitë e reja kanë fajin të mos jetojnë ashtu si breznite tona në një botë ku idetë mashtruese me gjysëm të vërtetat e tyne mund të transformohen në rreziqe te matejshme.

## Gëzim PUKA

Pikëvështrim për librin “Konsullatat franceze në Shqipërinë e shekujve XVII-XIX” e autorit Luan Rama

Vepra “Konsullatat franceze në Shqipërinë e shekujve XVII-XIX” e autorit Luan Rama, ish-diplomat, promovues dhe studiues i lidhjeve shqiptaro-franceze, në leximin tim është një kontribut i vyer në historiografinë e të dy popujve. Në parathënie të librit autori përpiqet ta paraqesë në mënyrë të thjeshtëzuar këtë ndihmesë, por një lexues i vëmendshëm, duke e përpirë këtë libër, kupton se ky material që përmban korrespondencë, arkiva, bibliografi për konsullatat franceze dhe konsujt që shërbyen në Shqipërinë e shekujve XVII-XIX, është aq i pasur dhe i detajuar, sa që mund të jetë një pikë e mirëfilltë referimi për historianët e asaj periudhe.

Por ky libër ka diçka prej letërsie...

Në pikështrimin tim, autori e tërheq lexuesin e zakonshëm jo vetëm për të mbushur boshllëqet shekullore që ka në lidhje me këtë periudhë historike, por edhe i krijon atij një mendim të përplotësuar për jetën shqiptare, të parë me syrin e të huajve. Prandaj themi se këtu ka material që i intereson shumë edhe një studiuesi të letërsisë.

Udhërrëfyes dhe kronikanë të formatit të François Pouqueville, që e dëshmon kohën dhe njerëzit e Janinës së Ali Pashë Tepelenës, janë vepra që i bëjnë jehonë kulturës shqiptare të kohës.

Kushdo që merret me letërsi është befasuar jo veç nga Shqipëria e parë “si nënë e rreptë burrash të egër”, prej Bajronit, por edhe me mbresat e fuqishme që sjell Pouqueville-i, konsulli i famshëm i Francës, të cilin fati e solli dhe e bëri të lidhet ngushtë me këto brigje, sa të shkruajë dhe të magjepsë edhe Chateaubriand-in vetë, siç e dëshmon ky libër i Luan Ramës.

Në imagjinaren time për ato kushte historike që po kalonte vendi ynë, përmes këtij rrëfimi dhe vetërrëfimi ata vijnë si heronj romantikë në rrethana romantike, dhe për më tepër, përmes kronikash së romanësuar. Duket se pjesën më të madhe i bashkon qasja prej studiuesi të epokës dhe popullit që po përshkruanin. Më tepër sesa mbrojtës të interesave të tyre politike dhe shteteve që përfaqësonin, ata na shfaqen, si mbrojtës të humanizmit, si përcjellës të qytetërimit të tyre, që më shumë se në asnjë vend tjetër spikat në Francën republikane, ku vlonte ideali i lirisë.

“Liria jeton ndër male”, përmendet diku në faqet e këtij libri. Këtë e kanë vërejtur konsujt personazhe, ndërkohë që stili rrëfimtar dhe përshkruar rrjedh i freskët. Për këta burra konsuj, autori ka një kujdes të veçantë për kombinimin e konspekteve, komenteve, interpretimeve me citime nga veprat e shkruara që ato lanë. Autori ndjek një rrjedhë të qetë ligjërimore, që asnjëherë nuk e mërzhit lexuesin edhe kur jepen shifra e statistika të Shqipërisë ndër ata shekuj të errët.

Përbashkësia e këtyre konsujve është se ata lanë vepra e shkrime për këtë vend që me vështirësi të mëdha kishte mbijetuar, së bashku me gjuhën shqipe, që disa prej konsujve francezë edhe e mësuan. Ndriçimi i epokës së Pashalleqeve, që përkoi edhe me zhvillimin e vrullshëm edhe të Francës së Napoleonit, vjen më së miri prej këtij teksti.

Nëse më lejoni të bëj një paralelizëm me konsuj dhe ambasadorë të sotëm që publikojnë statuse në rrjete sociale, mbase duken “absurdë” konsuj, si: Pouqueville, Desriveaux, Hecquard, Dozon, Aubaret, Degrand etj, të cilët gjenin rast të interesoheshin dhe të shkruani për folklorin, mitet, përrallat, ritet dhe veshjen e banorëve të Shqipërisë.

Një pjesë e rëndësishme e tyre i ka kushtuar shumë faqe të veprave të tyre, Shkodrës me rrethina. Këta konsuj romantikë frëngë nuk e fshehin një lloj qasjeje poetike dhe kultin e

natyrës, njeriut, lirisë. Ata bëjnë personazh të veprave të tyre dokumentare qytetin tonë dhe qytetarë të vyer të tij, të cilët, mbase, pa këto dëshmi edhe do të ishin harruar.

Me të drejtë autori, Luan Rama, shprehet:

“Historia e konsujve francezë në Shqipërinë e shekujve XVII-XIX, përshkrimet e tyre mbi jetën e shqiptarëve, etnografinë, doket e zakonet, ngjarjet e mëdha historike apo ngjarjet tepër personale që nuk i gjen ndër konsuj të tjerë, të gjitha së bashku krijojnë një afresk të madh ku secili shton një informacion apo ngjyra të reja, ngjarje e përshkrime të jashtëzakonshme historike dhe unike siç i gjejmë tek Pouqueville, Hecquard, Dozon, Degrand etj... Të tjerë na lanë botime të rëndësishme që sot përbëjnë referenca të përhershme për historianët tanë të kësaj periudhe historike dy shekulle...”

Por unë do të shtoja se edhe lexuesi i letërsisë dokumentare apo studiuesi i mirëfilltë i letërsisë nuk mund të anashkalojë libra të tillë si: “Udhëtim në More e Shqipëri”, “Historia e ringjalljes së Greqisë” të Pouquevillit; “Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së Epërme, apo Gegëria” i Hecquard; “Manuali i gjuhës shqipe” apo “Përralla shqiptare” të Dozonit; “Kujtime nga Shqipëria e Epërme” e Degrandit.

Ja pse në këtë kuptim ky libër i autorit Rama është edhe një ndërmendje e mirë për lexuesin, i cili mund të frymëzohet prej letrarësisë që ai mbart, në përmbajtje e në formë.

Kjo edhe falë një rrëfimi të ngjeshur dhe më gjuhë të thjeshtë shprehëse. Në imagjinaren time si lexues, këta konsuj të shoqëruar me kavasë (shoqërues) me kostume kombëtare shqiptare, rendin me përvujtni herë si poetë, herë si etnografë, herë si studiues antropologë, sociologë e hartues fjalorësh. Ata shtegtojnë më ditë, me javë, me muaj anëkend, ndonjëherë duke mbajtur edhe rreziqe pritash e sëmundjesh...

E fillova me Pouqueville-in dhe me të po kam dëshirë ta mbyll këtë fjalë timen të shkurtër paraqitëse.

Më bëri përshtypje konsiderata e Chateaubriand për këtë konsull dhe studiues dashamirës të shqiptarëve.

Ja si shprehet shkrimtari i madh frëng:

"Kohët e fundit gjithë bota ka ndjerë përkushtimin e konsujve tanë. Shumë prej tyre, viktimat e bujarisë së tyre, në mes të shtëpive të tyre me flakë, kanë mbajtur veçse flamurin e bardhë, rreth të cilit gjetën azil e mbrojtje myslimanë e të krishterë. Këta janë konsuj që kanë nevojë sot të shpërblehen..."

E për ta aktualizuar këtë citim, edhe mua sot, më duket se një shpërblim i mirë për punën e Konsullatave të Francës dhe konsujve të përkushtuar ndër shekuj, po i rikthehet edhe prej këtij libri të Luan Ramës, që po promovohet edhe në Universitetin tonë.

## **Xhahid BUSHATI**

### **NJË HISTORI DRAMATIKO-TRAGJIKE NË NJË RRËFIM VETJAK.**

Shënime për romanin "I burgosuri", i autorit Adem Ēzkēse (Ozkose), një histori e vërtetë burgimi

Duke lexuar librin "I burgosuri" - Një histori e vërtetë burgimi -, mësova se autori, në mes të tjerave, ishte dhe gazetar. Kujtimet më kthyen kokën pas, dhe u ndalën tek ato vite, ku kisha punuar edhe unë 15 vite gazetar radiofonik në radion lokale të qytetit tim. Pra, kur ende sot botoj shkrime të ndryshme kulturore në gazeta të ndryshme, ishte e udhës të njihesha edhe me publicistikën e zotit Ēzkēse, me veçoritë e kësaj gjinie, me përvojën, udhëtimet, me tiparet, kulturën dhe përceptimet e ngjarjeve dhe fenomeneve nga ana e tij, me konceptimin dhe mënyrën e të shkruarit kësaj eseistike për një histori të trishtuar që lidhet si protagonistem me vetjakën e autorit dhe jo vetëm të tij.

Autori Ēzkēse, në këtë roman të tij, vjen si tipologji e njeriut të kulturuar, me shumë shtresëzime kulturore, veçanërisht të një raporti solid mes letërsisë dhe gazetarisë, të një fraze të përpunuar e të një leksiku të pasur, të një fraze plot ngjyra, ku sundojnë metaforat e simbolikat. Gjithashtu, duke sjellë një copë jete shumë të rëndësishme nga vetvetja, mënyrën se si e paraqet atë, them që autori ka bashkudhëtarë tragjizmin. Ky tragjizim përmes kodeve estetike kthehet në imazhe filmike, imazhe që nuk mund të harrohen lehtë, ndaj mbesin thellë në kujtesë.

Rrugëtimi i deritanishëm gazetaresk i autorit është një shkollë, ku njeriu ka se çfarë të mësojë, dhe ajo çka është më e rëndësishmja mëson sesi njeriu vendos raportin e tij personal me kauzën e lirisë së vërtetë, shpesh herë ky raport në situata e gjendje shpesh të paparashikuara mbart edhe koston e një çmimi të lartë mes jetës dhe vdekjes, por në fund triumfon jeta dhe liria.

"I burgosuri", ashtu siç na thotë autori i librit është një histori e vërtetë burgimi, dhe përbëhet si konceptim dhe strukturë ndërtimi prej një parathënie dhe 32 pjesësh të rrëfyera në mënyrë lineare, ku periudha e burgosjes paraqitet përmes një tensioni të rëndë e të ngarkuar psikologjik e shpirtëror, si dhe të një ferri dantesk, do të thojë. Përmes një kqyrjeje formale të titujve të pjesëve e shoqëruar edhe me përmbajtjen e ngjarjes, kam nënvizuar disa elementë që flasin si tekst e nëntekst, si emocion, kulturë e letërsi në një fushëpamje historike e aktuale, ku dhe zhvillohen ngjarjet, si p. sh.: - Damask, - ... në dritën e hënës, - Siri, - ... në fshatin Fua, - Sure-ja "Jusuf" që na ndriçoi shpirtin, - Shpresë e thurur në zgavrat e murit, - Allahu është me durimtarët, - Dielli i parë pas dyzet ditësh, - Nata e fundit në qeli, - Udhëtimi nga Damasku në Teheran, - Qelia brenda meje.

Nuk është e vështirë që në përceptimin e këtij udhëtimi kohor, të mos shpërfaqen disa cilësi, autorit: botëkuptimi fetar i tij, shpresa për jetë dhe për të jetuar, metaforat e: natës, shpresës, diellit, hënës, shpirtit, dritës.... por edhe të kujtimeve dramatike që nuk shlyhen lehtë e që autori i formulon në mënyrë trishtuese me fjalët-dhimbje: "Qelia brenda meje". Fare mirë mirë mund të ishte titulli i një drame. Në të vërtetë romani është një dramë, ku në pikëpamje kohore dhe të rrafshit të saj, flet: e djeshmja, e sotmja dhe e ardhmja. E, në pikëpamje të stilit, sintetikja dhe e vërteta, argumenti, kultura dhe poetikja janë disa nga tiparet interesante që vizatojnë portretin e gazetarit Adem Ēzkēse, që me talentin e tij, dhe e kam fjalën për këtë roman, lexuesin e ndjek e panjohura, ankthi, dhimbja, trishtimi, besimi, besueshmëria, lutja, ëndërrimi, mirësia dhe rrezatimi i një dashurie sa familjare aq dhe shoqërore. E gjitha kjo ngarkesë e shoqëron lexuesin në leximin e komunikimin e këtij teksti plot nerv, dallgë e pse jo edhe qetësi e pritshmëri njerëzore e besuese. Kjo është arsyeja që



libri lexohet me një frymë, si dhe me pyetjen kureshtare dhe tronditëse: - Ç'po ndodh me personazhin kryesor që është i njëjtësuar me autorin?

### **-Momenti i parë, shënimet e autorit në parathënien e tij. Ç'përfaqësojnë?**

Zakonisht parathëniet, si koncept e këndvështrim janë delikate dhe të vështira. Ata duhet në mënyrë të koncentruar të paraqesin tharmin e veprës autoriale, si dhe të shoqërojnë dy pyetje: - E para, pse duhet lexuar ky libër?, - E dyta, pse duhet të jetojë ky libër edhe pas aktit të leximit?

Për vetë natyrën prej gazetari e shkrimtari të zotit ËZKËSE (OZKOSE), të gërshetimit të proceve krijuese dhe dalluese të problematikave dhe fakteve jetësore, të mishërimit dhe pasqyrimin të realitetit ekzistues, ai ia ka dalë mbanë duke na dhuruar një rrëfim si model parathënieje, i trishtuar, tragjik dhe shpresëdhënës. Njohim raportet e tij e të shokut të tij Hamitit me një botë të re, të nëndheshme. Sigurisht të panjohur e tmerruese. Gjithashtu dy shokët njohin torturat dhe persekutimet të paimagjinueshme. Për rrjedhojë autori e Hamiti janë dëshmitarë. Vetë libri është dëshmi. Raportet e dy jetëve: asaj jashtë dhe asaj brenda, ekzistuese. Autori plot dhimbje shprehet: "... ndjenim se jeta jashtë po na largohej gjithnjë e më shumë dhe po kthehej në një ëndërr..." (Parathënie, f. 7.) Një tipar tjetër që shpërfaqet në këtë parathënie, është figura e diktatorit Assad. Mjafton të përmendim këtë fragment të autorit, i cili është: "sepse bota që regjimi i Assadit kishte krijuar nën tokë, ishte si një tjetër planet, si një botë tërësisht tjetër. (Shikoni pak ndërtimi e fjalisë: "në një tjetër planet", dhe theksi bie te "një tjetër" për të thënë, se këtu mbizotëron vetëm e keqja, tirania. Me pak fjalë, por përzgjedhëse vizatohet terrori i diktatorëve. E diktatorët në jetën udhëheqëse vetëm ferr dantesk dinë të prodhojnë e të manifestojnë. Përballë kësaj faqe tmerruese, kemi një faqe ku poetit i japin jetë, e bëjnë të jetojnë, dhe këto janë Përfaqimi i besimit dhe i shpresës. Me këto gurë të çmuar e rrezatues, ËZKËSE zgjohet dhe fle, fle dhe zgjohet, e një ditë si çdo ditë tmerruese i përballonte kryelartë dhe me dinjitet njerëzor. Libri-dëshmi është një traktat sa letrar aq dhe filozofik.

### **-Momenti i dytë, autori në rolin e dëshmitarit, të historianit, të intelektualit të ditur e plot kulturë. Marrëdhënia dhe komunikimi me Sirinë.**

Është një marrëdhënie e shumëfishtë mes autorit dhe Sirisë, aq e bukur por shpesh dhe e trishtuar e tragjike. Është një shikim poliedrik i autorit ndaj Sirisë.

- Marrëdhënia e parë është ajo mos-harrimit i daljes në mbrojtje, për të argumentuar dhe shprehur të vërtetën. Ndaj, autori thotë: "Ndonëse vitin e fundit u përpoqa të bëja diçka për Sirinë, nuk ishte mjaftueshëm. ... Vendosa të shkoj në Siri, të xhiroja një dokumentar dhe të trëgoja për luftën përmes syve të një fëmije." Këtu dua të ndaloj te fraza "përmes syve të një fëmije". Ky shikim i kësaj moshe flet për besueshmërinë e të vërtetës, sinqeritetin dhe brenda të sotmes udhëton e ardhmja.

- Marrëdhënie e dytë është ajo e kujtimeve për Damaskun. Janë disa fjalë çelësa që vizatojnë portretin e Damaskut, si: qytet i ëndërruar, po rijetoja atë ëndërr, u dashurova me Damaskun që në vizitën e parë, qytet me vlera historike e dritë dijetarësh, enciklopedi e historisë islame, etj. Të gjitha këto elemente flasin se Damasku është kimi e shpirtit të autorit.

- Marrëdhënia e tretë është ajo e tragjizmit të Damaskut dhe të aktit të sakrificës të mëtejshme të autorit, ku në mes të tjerave ai shprehet: "Në detyrën time si gazetar, për dy muaj e gjysmë u bëra dëshmitar i kryengritjeve popullore në Siri... ... Teksa largohesha nga Damasku më 27 maj, lutesha për lirinë e menjëhershme të popullit sirian. Por nuk ishte e lehtë për mua ta braktisja Damaskun, atë qytet që e dua me pasion. ... Ishte dita ime e dyzetë në qeli. ... Kishin kaluar 62 ditë që kur ishim rrëmbyer dhe 51 ditë në qeli. ... Sapo fituam lirinë, fillova të mendoj përsëri se çfarë mund të bëja për njerëzit në Siri."

### **Në vend të përfundimit**

Kur mbarova së lexuari veprën, për të qenë i sinqertë më shumë se një herë, bisedova me vetveten, cila është tipologjia e këtij romani-dëshmitar krahas jetësimit tragjikisht të autorit dhe rrëfimit të tij plot shpresë?, Më duket se i shkon për model shprehja, se ky roman i takon vepra që pa hezitim, quhen 'vepra pa lamtumirë'. Këtë vepër nuk mund ta shkëputësh nga dora, dhe në një moment të jetës tënde e thërret dhe këshillohesh me të.

Është një libër që në koncept ka dimensionin e dëshmisë së një realiteti tragjik por edhe të realiteti të lirisë. Dhe esenca e këtij romani jepet si formulë për t'u mos u harruar përmes këtij fragmenti të autorit, i cili thotë: "Në fakt, kërkesa për liri, është një ideal që do të zgjasë me breza. As bombat me fuçi dhe as burgjet nëntokësore ku jetojnë mizoritë më brutale, nuk mund ta shkatërrojnë atë. Nëse shfarosni një brez që kërkon lirinë, ndjenja e lirisë do të ringjallet në brezat që vijnë pas tyre. Sepse për njeriun, skllavëria është e shpikur, liria është e lindur."

Shkodër, maj, 2023

**Ermira ALIJA**

**Mbi monografinë “Naim Frashëri në historiografinë letrare shqipe” të autores Irma Bilali, promovuar në bibliotekën “Marin Barleti” të Shkodrës**

Ideja e të mbledhurit të shkrimeve kritike në 2022, më shumë se 120 vjet mbas vdekjes së Naimit, kur kanë kaluar 30 vite demokraci në Shqipëri, ka qenë një ide e mirë për të kuptuar se si ka lëvizur mendimi letrar kritik për Naimin në sisteme të ndryshme, por edhe në kohë. Them në sisteme të ndryshme, jo për arsyen e të bërit politikë, por për faktin se qasja ideologjike e ndërpreu dhe e pengoi studimin letrar për 50 vjet, duke e deformuar dhe strukturuar politikisht. Në këtë këndshikim është shumë interesante ideja e vëzhgimit të mënyrës se si u lidh periudha e parakomunizmit me atë të paskomunizmit në studimet letrare, si u ristartua studimi letrar.

Mendoj se kjo është një ndër arsytet, që, studiuesja Irma Bilali, e ka parë mendimin kritik mbi Naimin për afërsisht sipas 3 periudhave:

1. Në fillim të shekullit XX
2. Në vitet '59-83
3. Në mendimin bashkëkohor, pas viteve '90, të cilin e ndan 1990-2000 dhe 2000-2017 që është viti, kur ajo ka mbaruar studimin.

Ka këtu përsëri një detaj që mendoj se është serioz, pasi autorja nuk përdor termin *Komunizëm* apo *Socializëm* për mendimin letrar në këto periudha, si terma me nuanca sociologjike e politike, por përdor vite, të cilat kanë një konotacion mendimi letrar, të lidhura me botime të caktuara letrare.

Nga aspekti historiografik, kjo monografi është interesante edhe për arsyen e vazhdimësisë të studimit të Ibrahim Rugovës: *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare: 1504-1983*. Kjo monografi përpiket të sjellë kritikën mbi një autor në një periudhë më të gjatë, gjë që në një farë mënyre është vazhdim i traditës së shqyrtimit të kritikës, nga vetë mendimi kritik, është metakritikë. Dhe në këtë aspekt s'ka shumë punime të këtij tipi.

Autorja përmend me të drejtë se sfida e kësaj monografie është e konsiderueshme, ndër të tjera, edhe për hir të shumësisë së shkrimeve për Naimin, por, edhe për kohën e gjatë kur shtrihen këto shkrime.

Në këtë perceptim ajo shkruan: *...ky punim mbetet pjesë e një studimi integral pasi në një punim të vetëm është e pamundur të përfshihen të gjithë trajtimet kushtuar kësaj figure...* (fq 19). Megjithatë, ndoshta mund ta marrim këtë thënie edhe si shprehje modestie, pasi autorja ka shfletuar dhe marrë në analizë një sasi të konsiderueshme veprash. Bibliografia numëron rreth 175 tituj.

Monografia fillon me shikime teorike kritike dhe në kapitullin e dytë menjëherë paraqitet mendimi i studimit letrar për Naimin në fillim të shekullit XX, pra të viteve '900, ku mendoj se paraqesin interes shkrimet për të në:

- La nazione Albanese, Itali, më 1903 (sipas studiueses biografia e shkruar aty për Naimin mund të jetë e Lumo Skendos)
- në revistën Yll' i mëngjesit, në Boston, më 1917
- në revista të tjera brenda Shqipërisë e sidomos në revistat e shkrimeve fetare “Kultura islame” dhe “Njeriu”
- në revistat pedagogjike
- në atë të Koliqit më 1931 e më vonë 1959
- në mendimin e Injac Zamputit, At Justin Rrotës, Kolë Ashtës apo Musine Kokolarit (40-41) dhe shumë studiuesve të tjerë seriozë shqiptarë të fillimshekullit XX
- në mendimin e të huajve, si: Gaetano Petrottës, Atë Fulvio Cordignanos etj.

Kapitulli i tretë që përshkruan mendimin letrar në periudhën e diktaturës, paraqet interes për zhvillimin e mendimit vecanërisht në:

- Historitë e letërsisë, duke i menduar ato si punë në grup: 1955, 1959, 1983,
- Monografitë, si trajtime individuale: R. Qosja (2000), Zija Xholi (1962), Dhimitër Shuteriqi (1962)
- në organet letrare '45-90
- në organet shkencore të kohës: Buletinet shkencorë dhe Studimet Filologjike të Universiteteve
- në artikuj kërkimorë shkencorë, apo shkrime të tjera, ku interes paraqesin në opinionin tim shkrimet e Poradecit

Përsëri pas viteve '90 analizohen veprat që kanë objekt Naim Frashërin. Vihen re risitë në këtë kritikë qoftë brenda të njëjtëve autorë, qoftë edhe në opinionin e përgjithshëm të studimit, ku mund të veçonim veprën me 2 vëllime nga Laurent Bica, njëra prej të cilave titullohet: *Naimi në Kostandinopojë*.

Autorja i ka lënë një kapitull të veçantë botimeve dhe ribotimeve të veprës së Naimit. Jo pa qëllim ajo përmend historikun e botimeve të “Bagëti e bujqësi” të Francesco Altimarit në punimin: *Premisa metodologjike për një botim kritik të poemës “Bagëti e bujqësi”*, të vitit 2015, që mendoj përbën një bazë të mirë teorike për një shikim kritik.

Nuk është rastësi që studiuesja Irma Bilali analizon botimin e Altimarit, citon jo më kot faktin që ai thotë se ... *i është drejtuar fillimisht variantit të vitit 1980 të botimit të plotë të veprës së N. Frashërit nga Akademia e Shkencave, si më i besueshëm dhe pas shqyrtimit të kujdesshëm ka vërejtur papërshtatshmëri të kritereve të transkriptimit dhe ngre dyshime nga pikëpamja filologjike, në krahasim me botimin e parë të veprës, shtypur në Bukuresht, më*

*1886...* (Shënimi 683, fq 379). Kjo më kujtoi një botim timin në Buletinin e Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, nr 66, 2016, fq 53- 61, me titull: *Censurimet e vargjeve të Naim Frashërit*, ku bëhen objekt vargjet e censuruara të Naimit në poemën “Bagëti e bujqësi” dhe në disa poezi. Studimi nuk është shterues, paraqet fenomenin të konkretizuar me disa botime (që prodhonin mbi 10000 kopje), por jo me çdo botim të dalë. Në Kapitullin V ka edhe një përmbledhje të pasqyrimin të Naimit si letrar në krejt tekstet shkollorë të pas viteve '45, një punë e jashtëzakonshme edhe kjo.

Duhet thënë se në këto kapituj studiuesja reflekton një intuitë të mirë në pasqyrimin e mendimit letrar dhe zbulon thelbin dhe veçantinë e studimeve që bën objekt, gjykon të rëndësishme ribotimet sipas përkthyesve dhe vlerëson parathëniet dhe shënimet që shoqërojnë çdo botim, në botime të veçanta shqyrton me skrupolozitet edhe detaje të holla, si kushtimet, recensentin, ilustrimin e kopertinës, fotografitë etj., që për studiuesit kanë rëndësi. Autorja dallon botimet e pasviteve 2000, si botime me tendenca për t’iu afruar sa më shumë origjinalit dhe për të korrigjuar gabimet e bëra prej presionit ideologjik; tregon gjithashtu edhe punën për përkthimin e Naimit në italisht nga Jolanda Kodra apo nga Francesco Altimari etj. Autorja përmend edhe fjalorin e Naimit me fjalë dhe frazeologji, të përgatitur nga Dhimitër Shuteriqi e të ribotuar nga Akademia e Shkencave më 2017, nën kujdesin e vajzës së Shuteriqit, ku i është kushtuar shumë vëmendje neologjizmave të krijuara nga Naimi.

Interesant është edhe fakti që studiuesja përmend edhe të gjithë autorët që i kanë kushtuar krijime Naimit, ku përmend rreth 50 emra. Ajo shënon edhe disa konkluzione, ku ia vlen të përmendet që *studimi letrar për Naimin shenjon rezultate të qëndrueshme dhe koherente*. (fq 410).

Nga ana tjetër ajo shkruan se historiografia letrare deri në ditët e sotme paraqet më shumë tema për diskutim, sesa forma të sigurta.

Autorja përmend si pika të dobëta të studimit të deritashëm:

- krahasimin e varianteve të botuara të veprës

- filozofinë naimjane
- përdorimin e teknologjisë në arritjen e konkluzioneve shkencore

Për të gjitha këto sa thamë, monografia paraqet një punim profesional që i shërben dhe do t'i shërbejë studiuesve të letërsisë ndër vite.

## ▪ Etnografi ▪

Zenepe **DIBRA**

### ISMAJL GOLEMI-MJESHTRI I PARË ARTIZAN I PRODHIMIT TË VULAVE



Ai ishte një mjeshtër i madh, artizan, novator dhe profesionist i shkelqyer. Shumë i qetë, i durueshëm, i matur por edhe i përpiktë; çfarë i shihte syri i bënte dora. Vizatonte shumë bukur, skiconte çdo gjë përpara se ta realizonte dhe pastaj me ato duar që rrallë kush mund t'i përdorte si ai, realizonte atë se çfarë kishte projektuar.

Në historinë e tij 2500 vjeçare, qyteti i Shkodrës krijoi një traditë të rëndësishme në fushën e artizanatit, ku mbarti me vete mjeshterinë e lartë, individualitetin, fantazinë krijuese, shijet e ndjenjat artistike të kësaj treve. Pazari i Shkodrës, që heret ishte kthyer në një panair të këtyre produkteve që pëlqeheshin e bliheshin jo vetëm nga vendasit por edhe nga mbarë rajoni. Në sokakët e zejtarëve, dyqanet radhiteshin sipas 80 zejeve e profesioneve të ndryshme, ku mjeshtrit popullorë zbukuronin gurin duke i dhënë forma të ndryshme, gdhendnin drurin me ornamente të ndryshme, kalisnin hekurin, qëndisnin me fije ari dhe argjendi veshje të papërsëritshme kombëtare, punonin lëkurat e çdo lloji, stolisnin armët e trimave të lirisë. Më vonë dyqanet e rreshtuara në pedonalen e Shkodrës, do tregtonin mallra të ndryshme, në mes tyre dhe shumë produkte artizanale të mjeshtërve shkodranë. Mjeshtrit hidhnin në treg punime të kostumeve kombëtare, qëndisi, vegla të ndryshme, armë artizanale, enë zbukurimore poçerie, punime druri nga më të ndryshmet që gdhendeshin aq bukur etj.<sup>52</sup>

Kongresi Kombëtar, i mbajtur në Lushnjë në janar 1920, hodhi themelet e qeverisë së re. Rimëkëmbja e Shtetit Shqiptar dhe sigurimi i pavarësisë së tij, i vendosur në Kongresin Kombëtar të Lushnjës, në janar të 1920, zhvillimi dhe konsolidimi i tij i mëtejshëm, shtronte si detyrë, forcimin e pushtetit qëndror dhe lokal, që në prioritetet e tij do të kishte luftën ndaj informalitetit.<sup>53</sup> Një shtet i fortë kondiciononte detyren qytetare dhe ligjore që kushdo që merrte një shërbim apo që prodhonte duhej dhe t'i paguante taksen shtetit. Dhe për këtë duhej edhe identifikimi i personit dhe mallit që tregtonte, nepërmes nënshkrimit dhe vulës. Por punimi dhe prodhimi i vulave ishte diçka e veçantë, me përgjegjësi sepse kërkonte precizion, profesionalitet por edhe elemente të sigurisë. Vula vertetonte dokumentin, ajo ishte identiteti i një profesioni, i një institucioni, i një personi privat dhe për këtë duhej jo vetëm mjeshtri por besim dhe siguri. Ismajli ishte i vetmi në Shkodër, që realizoi me qindra vula, me profesionalitetin dhe durimin e tij por edhe me ndershmërinë e tij, që e shoqëroi gjithë jeten deri sa vdiq.

Ismail Golemi lindi në Shkodër, më 1908 dhe u edukua në familjen e mirë dhe të ndershme të Golemëve. Kishte dy vëllezër Qamilin, një mësues veteran i përkushtuar në edukimin e brezit të ri dhe Ragipin me profesion shofer, si dhe një motër, Naziren, të martuar në familjen Kraja. Ishte martuar me Budije Millen, dhe kishin katër vajza Shpresen, Kursimen, Fatmiren dhe Fiqiretin. Që herët, mbas një arsimimi të mesëm, ai shfaq talentin e punëve me dorë, punimeve të drurit por edhe çdo gjë tjetër që kishte nevojë të meremetohej, të rikonstruktohej por edhe të konstruktohej nga e para, me një intuitë teknike të lindur. “*Vizatimet e tij, bile*

<sup>52</sup> Muzeu historik i Shkodrës Artizanati

<sup>53</sup> Wikipedia “Kongresi i Lushnjës”, 1920

*edhe piktura të ndryshme ishin ato të një mjeshtri të spikatur autodidakt – tregonin disa që e kishin njohur por edhe që kishin patur nevojë për doren dhe punën e tij. Por ai do merrte një profesion që pak të tjerë mund të merreshin: punimin dhe prodhimin e vulave. Në fillim punimi i vulave bëhej në mënyrë artizanale, kur shkalla e zhvillimit ekonomik ishte ende e ulët. Më vonë, kur marrëdhëniet tregtare filluan të rriteshin dhe prodhimi artizanal ishte në kulmin e zhvillimit të tij, por edhe ai industrial kishte filluar të merrte formën më të zhvilluar dhe moderne, ekonomia nën tryshinë e një pushtetit që po forcohej, kushtëzonte formalizimin e ekonomisë, Kështu Ismaili më 1939 blen në Itali një makine dore për punim vulash. Në studion e tij do vinin me qindra njerëz të profesioneve të ndryshme, të institucioneve, të shtetit, të propagandës, të shëndetësisë, të shkollave, të personave që zotëronin biblioteka private dhe shoqata, gra të qytetit, fshatit por edhe të malësisë që kishin nevojë për këtë mjet të rëndësishëm identifikimi. Me këtë makinë ai punoi deri në vitet 1945-46, pra deri atëherë kur mbas v. 1946 u ndalua me ligj puna private. Në këtë kohë makineria u privatizua por shteti i dha një dyqan, ku Ismaili punon si i punësuar (me rrogë fikse) deri në vitin 1959-60. Në vitet 1948-59 ka punuar me një mjeshtrë të talentuar Ndrek Palin.*



### **Smajl Golemi me Ndrekë Palin në dyqanin e prodhimit të vulave**

Mbas v. 1960 makina u mor nga shteti dhe u dërgua në Tiranë, kështu edhe Ismajli shkëputet nga kjo punë, por vazhdon të punojë me dorë, duke gdhendur mbi një gomë vetëm me një brisk (bisturi). Natyrisht vulat tashti ishin më të thjeshta, emra personash, numra që përdorehin në ambalazhet e fabrikave ushqimore (për konservat), për Fabrikën e cigareve, Uzinën e telave, etj. Përgjithësisht vulat që prodhoi mjeshtri I.Golemi, kishin një veçanti sepse ato nuk ishin unike, nuk kishin një kallep apo formë por ndryshonin nga kërkesat e një institucioni apo një tjetri, nga një subjekt privat në tjetrin. Shto këtu edhe preferencat e klientëve të cilët kishin pretendimet e veta në prodhimin e vulave. Ismajli mbante një rregullsi të punës që bënte, sepse çdo vulë që prodhohej u stamponte në disa katalogë, qoftë për ta patur si dokument historik të punës që bënte por edhe për të evidentuar punën me klientët në lidhje me pagesën që ato bënin. Katalogët mbanin jo vetëm shtampat e vulave por edhe vitet e prodhimit. Kështu në katalogë viti i fundit i prodhimit ishte viti 1960. Nga ajo punë e reflektuar në disa dhjetra katalogë, kanë mbetur vetëm 4 katalogë që i ka ruajtur me fanatizëm, Shpresa, vajza e madhe e Smajlit, një mësuese veterane e nderuar që ia kushtoi jetën e saj edukimit të brezit të ri duke u dalluar në çdo aspekt të jetës saj private dhe shoqërore e sidomos me nxënësit dhe kolegët e saj. Në dijeninë e familjes por edhe të dhënave të tjera, Ismaili ishte i vetmi në qytetin e Shkodrës dhe fshatrave të saj që prodhonte vula. Por shtampat e vulave në katalogë, që prodhoheshin tek punishta e Ismailit për shumë rrethe të tjera, për nevojat e tyre, tregon se edhe në Shqipëri, prodhuesit e vulave ose ishin të pakët ose ishte vetëm Ismaili që i prodhonte. Po të analizohen këto katalogë do të shohim dy periudha të punimit të vulave ajo para vitit 1944 dhe periudha që vjen mbas vitit 1944.




### **Katër katalogë që kanë mbetur, me shtampa të qindra vulave që ka punuar I. Golemi**

Në periudhen e parë do shohim vula të personave privatë, tregtarë të vegjël dhe të mëdhej, vula të disa institucioneve, bile edhe nga qytete tjera. Para v. 1944, vulat nuk ishin të thjeshta. Ato kishin elementë identifikues të profesionit, shoqëruar edhe me zbulurime, si p.sh. tregtarët e duhanit vendosnin gjethe duhani, apo pjesë zbulurimore, disa të tjerë venin edhe godinat ku zhvillonin biznesin e tyre, etj. Nga këto mori vulash të prodhuara para vitit 1944, dalin këto konkluzione:

1. Sasia e vulave dhe llojshmëria e tyre tregon shkallen e zhvillimit ekonomik dhe institucional të qytetit të Shkodrës ku evidentohen një numër i madh tregtarësh të vegjël dhe të mëdhej, zanatçij, mjeshtra, kontrollorë, etj.
2. Në këtë periudhë shteti kishte një rol të rëndësishëm në formalizimin e biznesit, sepse pothuajse edhe tregtarë të vegjël, me një biznes të vogël kishin vulat e tyre, ku në faturat e shitblerjes që bënin figuronte, firma dhe vula e biznesit. Kështu janë vula të tregtarëve edhe të vegjël të duhanit, të furrtarëve, të rrobaqepsve, të bujtinave, të prodhimit embëlsirave, pijeve, etj
3. Vula kanë patur edhe persona private bile edhe vula që përfaqësonin gratë. Vulat e grave ishin të thjeshta me emrin e tyre që ato i kanë përdorur. Përdorimi i vulave nga gratë vinte për shkak se shumë prej tyre ishin analfabete dhe në vend që të vendosnin *një gisht*, ndoshta ishte më serioze një vulë. Nga ana tjetër për legjimitetin e pasurive të lëna nga prindërit, apo pasuri e lënë nga burrat e vdekur, apo edhe për të vulosur dokumenta personalë të qëllimeve të ndryshme, vula kishte një identitet të qartë, pa ekuivoke dhe ishte më serioze.
4. Shumë vula të periudhës para 1944, ishin të institucioneve të ndryshme përfshirë edhe ato të vendeve pushtues si p.sh. italiane apo edhe të institucioneve jashtë Shkodrës por edhe jashtë territorit shtetëror shqiptar, nga Ulqini, Budva, Podgorica, Tivari
5. Në katalogë vulat janë të përziera, pra vula të profesioneve dhe institucioneve të ndryshme, e cila varesh nga dita kur kërkohet vula, dhe prova në katalogë e stampimit të tyre, për kontroll vihej në atë ditë që vinte klienti dhe natyrisht kërkesa e tyre nuk kishte një rregullsi. Më të sistemuara janë vulat e tregtarëve të duhanit ku në katalogë janë vënë në mënyrë shumë më të rregullt.
6. Vulat kanë ngjyra të zezë, bojë vjollcë apo edhe bojë kafe, me nuanca të ndryshme





Një fletë katalogu me shtampime vulash të ndryshme

Në katalogët para vitit 1944, dominojnë vulat e tregtarëve të duhanit. Kjo sepse rritja e prodhimit të duhanit dhe qëndrueshmëria e kësaj kulture në strukturën e bujqësisë së Shkodrës, çoi në krijimin e industrisë së përpunimit të saj. Forma më e hershme e përpunimit të duhanit ishte coptimi i tij për t'u pirë me çibuk. Më vonë filloi grirja e tij me thikë ose me brisk, më vonë me çark (havan), dhe mbas v. 1900 dalëngadalë zevëndësohet me maqinat grirëse. Në vitin 1925, në Shkodër hapin punishtet e para për grirjen e duhanit firmat e **Idriz** dhe **Adem Troshanit**, të **Ymer Matit**, e **Caf Vilës** dhe më 1928 **Jonuz Zaja**, **Asllan Hoti** e **Brahim Hysa**, duke vazhduar më vonë me firma të tjera. Në v. 1919 **Fasli Ademi** sjell makinën e parë për përgatitjen e cigareve e më vonë edhe makinën e dytë që kishin kapacitet prej 20,000 *zivane* në orë. Në Shkodër për herë të parë Fasli Ademi importon nga Austria kompleksin e makinerive për prodhimin e kutive të cigareve të tipit *sirtar*. Në 31 lagjet e qytetit funksiononte një rrjet i gjërë dyqanesh prej 66 njësisish. Kuptohet se duke ditur që duhani ishte monopol i shtetit dhe përdorimi i vulave bëhej i domosdoshëm, për të eliminuar edhe informalitetin dhe kontrabanden.<sup>54, 55</sup>

Vetëm nga fisi Trashani janë tre tregtarë që tregtojnë duhanin dhe kanë vulat e tyre, si **Idriz Troshani**, **Adem Troshani**, **Rexhep Trashani**, por nga që në fillim kanë punuar bashkë

<sup>54</sup>Paulin Zadrima "Krijimi dhe i zhvillimit i industrisë së përpunimit të duhanit në rrethin e Shkodrës (1900-1920) "Seminari II Ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", Shkodër 1995;

<sup>55</sup> Paulin Zadrima "Krijimi dhe i zhvillimit i industrisë së përpunimit të duhanit në rrethin e Shkodrës (1920-1945), "Seminari II Ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", Shkodër, 1998


është edhe vula **Vëllezërit Troshani**. Në këto vula prodhuesit e duhanit, përveç emrit të tyre, i kanë vënë edhe një emër duhanit me një shumëllojshmëri të veçantë, si emra vendesh, përfshirë emra qytetesh dhe fshatra të Shqipërisë, si: Shqypnija, Sheldija, Jubani, Postriba, Trashani, Koplik, Guri i Lekës, Cukali, Kanina, Devolli, Tomorri, Gjirokastra, Korça, etj. Kishte emra duhani nga vendete jashtë Shqipërisë, si: Ulqini, Shkupi, Prishtina, Peja, Rozhaja, Gucija, Sazana, Kosova, Pezreni Vardari, Roma, Venezja, Portugali, Vardari, Bosnja, Kavallja, Maqedonija, Stamolla, Tivat, Tripoli, Pompej, Misiri, Ballkan, Selaniku, Shari, Jugu etj Arsyet e vendosjes së këtyre emra vendesh janë të lidhura me vetë impresionet, kujtimet, dhe shumë gjëra që e kanë lidhur personin që tregton me emrin që i ka vënë duhanit. Por këtu janë emrat edhe të vendeve ku duhani është kultivuar më tepër si Sheldija, Jubani, Postriba, Kopliku, etj. Por në shumë raste ka edhe emra të tjerë që i kanë vënë duhaneve që kanë tregtuar, si;

Afrimi, Ylli i Dritës, Dreni, Neretva, Elbaroza, Bota e Re, Demokracija, Fitorja e Ambel, Bujku, Teuta, Arditë, Defrimi, Drita, Skanderbeg, Drandofilja, Flaka, Diamant, Korona, Prova, Republika, Ylberi, Florini, Shqypja, Besa, Shpresa, Liqeni, Zaja, Diana, Parruca, Minerva, Drina, Teuta, Donika, Rilindja, Shqypja, Rodi, Venus etj.





DEPOZITË DUHANIT  
RIZA HOTI  
SHKODER



DUHAN I FORTË K. I  
KOSOVA  
HASAN MATI  
SHKODER  
Gram 50 Letra Fije 50

FABRIKË DUHANIT  
SPECIAL  
I FORTË  
Ymer Mati  
SHKODER

<p>DUHAN I FORTË KUALITET I * SHELDIRA *</p> <p>GR. 50 LETRA 50 LEK 3.50 YMER M. MUSTAFA SHKODER</p>	<p>DUHAN I FORTË KUALITET I * DEVOLLI *</p> <p>GR. 50 LETRA 50 LEK 3.50 BEUTA MANI SHKODER</p>	<p>CNS DUHAN I BUTË KUALITET I PARË VENUS</p> <p>GR. 50 QIMI LEK 3.50 R. RIZA HOTI SHKODER</p>	<p>DUHAN I FORTË K. I HASAN MATI SHKODER QIMI LEK 2.50</p>
<p>DUHAN I FORTË KUALITET I * HYLLE *</p> <p>GR. 50 LETRA 50 LEK 3.50 HALIT BEHLULI SHKODER</p>	<p>DUHAN I FORTË MARKA SUZAN</p> <p>K. I GR. 50 FIJE LETRA 50 QIMI LEK 2.50 FETAH META SHKODER</p>	<p>DUHAN AFERDITA</p> <p>K. I GR. 50 LETRA 50 QIMI LEK 3.50 L. P. SHKODER</p>	<p>DUHAN KUALITET I I MARKA ORO</p> <p>GR. 50 FIJE LETRA 50 QIMI LEK 3.50 LATIF DERVISHI SHKODER</p>
<p>DUHAN I FORTË KUALITET I LULZIMI</p> <p>GR. 250 LETRA FIJE 250 LEK 17.50 RAMA SHPUZA SHKODER</p>	<p>GRAM 50 DUHAN K. I KRISTAL LEK 3.50 OSMAN DRUCI SHKODER</p>	<p>DUHAN I FORTË MARKA KONSUMI</p> <p>K. I GR. 50 FIJE LETRA 50 QIMI LEK 3.50 TOUFIK M. BEÇI SHKODER</p>	<p>DUHAN I FORTË MARKA BYLBYLI</p> <p>K. I GR. 50 FIJE LETRA 50 QIMI LEK 3.50 TOUFIK BEGTESH SHKODER</p>
<p>DUHAN I FORTË MARKA OHRI</p> <p>K. I 50 FIJE LETRA GR. 50 QIMI LEK 3.50 ADEM BEÇIRI SHKODER</p>	<p>DUHAN I BUTË KUALITET I * SAZANA *</p> <p>GR. 50 LETRA 50 LEK 3.50 NUT BEHRI SHKODER</p>	<p>DUHAN I BUTË LIRIJA</p> <p>K. I GR. 50 LETRA FIJE 50 QIMI LEK 3.50 KAPLLAN REÇI SHKODER</p>	<p>DUHAN I FORTË MARKA TEUTA</p> <p>K. I GR. 50 FIJE LETRA 50 QIMI LEK 3.50 RAMA AGOVIQI SHKODER</p>
<p>DUHAN I FORTË K. I VERI</p> <p>YMER PELINKU SHKODER QIMI LEK 3.50</p>	<p>DUHAN K. I FORTË TRASHANI</p> <p>LEK 3.50 I. VLL. TRASHANI SHKODER</p>	<p>DUHAN I FORTË MARKA POSTRIBA</p> <p>K. I GR. 50 FIJE LETRA 50 QIMI LEK 3.50 FETAH META SHKODER</p>	<p>DUHAN I FORTË MARKA VJOLLCA</p> <p>K. I GR. 50 FIJE LETRA 50 QIMI LEK 3.50 KEMAL KARAKAÇI SHKODER</p>
<p>DUHAN I FORTË KUALITET I * PAKIZIJA *</p> <p>GR. 50 LETRA 50 LEK 3.50 HALIT LIPRI SHKODER</p>	<p>DUHAN I BUTË KUALITET I * SAZANA *</p> <p>GR. 50 LETRA 50 LEK 3.50 NUT BEHRI SHKODER</p>	<p>NEL ISUFI NËP. BINDERLLIUE SHANIL SHERKI</p>	<p>LUDE SELIM SHARRAN ZEJNEFI GJILJITZEZE SHERKI</p>

**Vula të tregtarëve të ndryshëm të duhanit**

Vetëm në një katalog janë të sistemuar afro 240 vula të tregtarëve të ndryshëm të duhanit dhe ndodh që një tregtar të ketë edhe dy deri në pesë vula të ndryshme.




### Shtampat e vulave të Hasan Matit që tregojnë cilësinë dhe çmime të ndryshme të duhanit

Kjo për arsye të kualiteteve të ndryshme të duhanit, si rezultat edhe të çmimeve të ndryshme. Në përgjithësi në shtampat e vulave të duhanit ku përveç duhanit viheshin edhe letrat e mbështjelles së cigareve, shënohesh emri i duhanit, kualiteti i duhanit, i fortë apo i butë, gramatura, zakonisht 50 gr, si dhe letrat që do mbështilleshin cigaret zakonisht 50 copë, çmimi i shitjes dhe emri i tregtarit që e tregon.



Shtampa e një vule të tregtarit Hasan Met Hasani, ku shënohen emri i duhanit dhe vendi ku prodhohej dhe tregtohej, emri i tregtarit, gramatura, çmimi, dhe numri i letrave për të mbështjellur cigaret.

Në katalogët e Ismail Golemit, vulat i kanë patur pothuajse të gjithë personat që kanë kryer një aktivitet tregtar, shërbim apo aktivitet artizanal, mjeshtrit e rrobaqepsisë, furrtarët, prodhuesit e ëmbëlsirave, të tregtimit të këpucëve, etj





SARTORIA MILITARE  
PROBAQEPSIJA USHTARAKE  
VLLAZEN KOSOVA  
PESHKOPI

KEL VLL. DEDA  
TREGTAR  
SHKODER

*Idriz Dibra*  
MANIFAKTURER  
*Shkoder - Shqipni*

PUNIM AKLLEKUT  
HALIL VLLA DIBRA  
SHKODER

VËNË RRUSHI  
GASPER NEGRI

DISTILERI ALKODLIT  
"KOLIQI"  
MATI KOLIQI  
SHKODER

KAFE FIRENZE  
SCUTARI ALBANIA

*Gjyl Caushollaj*  
TREGTAR - COMMERCIANTE  
IMPORTAZIONI - ESPORTAZIONI  
*Shkoder - Scutari d'Albania*



### Disa nga shtampat e vulave të furrtarëve të qytetit të Shkodrës

Ka disa firma të mëdha që kanë vënë në vulat, në mënyrë figurativë fasaden e jashtme të magazinës së tregimit, si firma e vëllezërve Ulqinaku, apo edhe fabrika e duhanit Taraboshi e vëllezërve Ademi.



Mapoja “Ulqinaku” dhe Vula e Magazinës Ulqinaku, Vlezërit Sali Mehmeti



**Fabrika e duhanit “Taraboshi”, K.Marubi 1937; Vulat e Fabrikës Taraboshi e vëllezërve Ademi**

Shumë vula i përkasin institucioneve të qeverisjes, të policisë, krypleqve, të institucioneve fetare, apo të shoqërive kulturore.



Shumë vula janë të pushtuesve italianë, që pushtuan vendin tonë më 1939 dhe që kishin institucionet e tyre të diktaturës në Shkodër.





3<sup>o</sup> Regg.<sup>o</sup> Artiglieria Alpina „Julia“  
BATTERIA "MATI"

COMANDO BATTAGLIONE R. GUARDIA DI FINANZE  
- SCUTARI -

**Vula të institucioneve të ndryshme të Italisë fashiste në Shkodër**



Interesante është edhe vula e zyrës së aeroportit të Shkodrës





<p>KRYESIA E KISHES KATOLIKE TE SHQIPERISE EPISKOPATI KATOLIK SHQIPTAR Sekcioni i Administrates Nr. _____ Prot. _____</p>	<p>KRYESIA E KISHES KATOLIKE TE SHQIPERISE EPISKOPATI KATOLIK SHQIPTAR Sekcioni Financjar-Ekonomik Nr. _____ Prot. _____</p>	<p><b>PAGUE ARKETARI</b></p>
<p>KRYESIA E KISHES KATOLIKE TE SHQIPERISE EPISKOPATI KATOLIK SHQIPTAR ZYRA E PERSONELIT Nr. _____ Prot. _____</p>	<p>KRYESIA E KISHES KATOLIKE TE SHQIPERISE EPISKOPATI KATOLIK SHQIPTAR Sekcioni i Kulturës Nr. _____ Prot. _____</p>	
<p>Autorizohet Pagesa Shefi Llogaris: _____ Drejtori: _____</p>	<p>Autorizohet Pagesa Shefi Llogaris: _____ Drejtori: _____</p>	<p>Kryesia e Kishes Katolike Shqiptare Episkopati Katolik Shqiptar Nr. _____ Prot. _____ Mbledhjet me _____ 195</p>

Vula të, të Komunitetit Musliman (Dega Kulturore), Kishës Ortodokse, të Kishës Katolike të Durrësit, Lezhës, Pultit, Sapës, dhe kryesisë së Kishës katolike. Këto vula i përkasin katalogut që i është vënë data 1952-1957, para vitit 1967, ku zhduken institucionet fetare bashkë me to edhe vulat



*Gjyush Shalija*  
*Shkoder*

TOMA	SAIT HALLUNI		
R ZEFI	JAKO KOSTJA	DED MIRASHI	Sylejman Lopçi
DULI	BABUN CELI	MET HASANI	Xhafer Sylejmani
OTKRI	MUHA SELA	GJON DEDA	SAIT KRAJA
lahi	LIME HASANI	ESMA HALILI	Dalin Pashukja



### Vula personale private ku spikasin vulat e disa grave

Por ajo që është interesante se edhe nga vende të tjera jashtë Shkodrës, siç duket vinin në Shkodër për të bërë vula. Dhe kjo se Ismailit i kishte dalë zani dhe nami për mjeshtëri, siguri, dhe profesionalizëm. Vula që i përkasin Ulqinit, Tuzit, Podgoricës siç duket janë bërë në vitet 1944- 1948, vit mbas të cilit u prishen marrëdhëniet shtetërore me Jugosllavinë, mbyllen kufijtë dhe përfundon edhe bashkëpunimi ,





★  
Opštinski Nar. Osl. Odbor  
Broj \_\_\_\_\_  
ULCINJ \_\_\_\_\_ 194\_\_

★  
Narodna Oslobodilački Odbor  
SREZA BARSKOG  
Br. \_\_\_\_\_  
Bar. \_\_\_\_\_ 194\_\_ god.

OPŠTINSKI NAR. OSL. ODBOR  
„ NARODNA MILICIJA ”  
ULCINJ



Vula të shtetit malazez 1944-1948

S. D. E. S.  
M.  
ZETA  
SKADAR.



**Vula të ndermarrjeve të huaja në Shkodër**

Mbas vitit 1944 vulat janë pothuajse të gjitha shtetërore. Por Ismajli ka punuar edhe vula gjatë kohës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, vula të këshillave Nacionalçlirimtare (K.N.Ç.) të qarqeve të ndryshme të gjithë Shqipërisë, shtabet e brigadave, shtabet e divizioneve, të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të komandave të vendit, komandave të zonave ushtarake, etj. jo vetëm të Shkodrës por edhe të qyteteve tjera.



Por duke ditur se jo të gjitha ndërmarrjet private apo njësitë tregtare private nuk janë shtetizuar menjëherë, edhe mbas këtij viti ka patur vula të tyre deri kur krijohen ndërmarrjet shtetërore dhe kur zhduket krejt sistemi privat. Por numri më i madh i vulave është i institucioneve shtetërore, sepse shteti krijon institucionet e veta ku dallohen vulat e institucioneve arsimore, shëndetësore, të ndërmarrjeve prodhuese, të kooperatvave, të organizatave të bashkimeve profesionale, të rinisë, të grave, etj





K. K.  
DEGA E BUKËS  
Nr. 10

K. K.  
DEGA E BUKËS  
Nr. 11



K. K.  
DEGA E BUKËS  
Nr. 14

K. K.  
DEGA E BUKËS  
Nr. 15

K. K.  
DEGA E BUKËS  
Nr. 19


K. K.  
DEGA E BUKËS












### **Vula të Këshillave Popullore të katundeve të ndryshëm të Shqipërisë**

Në dy katalogë të viteve 1952-1957, janë vulat e këshillave popullore të katundeve të Peshkopisë (afro 180 vula), por në flete e tjera janë edhe vula të këshillave popullore edhe të qarqeve të tjera. Po në këtë katalog ka vula të Bashkimeve Profesionale B.R.P.Sh., të Shkodrës, Q. Stalin, të Korçës, të Krujës, Elbasanit, Beratit, Peshkopisë, Vlorës, Durrësit, Tiranës, Sarandës, etj. Më tej janë vulat e Komitetit Lokal të Bashkimeve Profesionale të Punëtorëve të Tregtisë, të disa qyteteve, vula të kooperativave të shitblerjes, etj.





**Vula të institucioneve të ndryshme në të gjithë Shqipërinë**

Me punën e tij të jashtëzakonshme, Ismail Golemi tregoi intuiten teknike, artizanale dhe shumë mjeshtërore të genit artistik dhe novator shkodran që si kudo shkelqeu edhe në këtë drejtim. Por ai me ndershmërinë e tij, në këtë profesion sa të bukur, por edhe delikat dhe më shumë përgjegjësi, tregoi traditën e hershme të shkodranit duke u përfaqësuar sa më denjësisht për familjen e tij por edhe Shkodren, për të mbetur i respektuar dhe i nderuar në të gjithë Shqipërinë dhe në një pjesë të rajonit.<sup>56</sup>

**DR. Zenepe Dibra**

**5. Shënim: Vajza e Ismail Golemit, Shpresa (Golemi) Kopluku, i ka dhuruar Bibliotekës së qytetit “Marin Barleti”, 4 katalogë me shtampa vulash të prodhuara nga Ismail**

**Golemi në vitet 1939-1960, duke shpresuar që këto katalogë mund t'u shërbejnë studiuesve për studime më të thelluara.**

Shkodër 11.04.2022

Willy Kamsi

## NIKOLLË DAKAJ përkthyes e polemist

Kujtohet në vijimsí tradita e Shkodrës në lamën e kulturës dhe të studimeve humanistike, tue u konkretizue ky pohim me emnat e një vargu personalitetesh, të cilat kanë lanë gjurmë të pashlyeshme në jetën e kombit shqiptar.

Por edhe një traditë nuk është e mundun të jetë e tillë po qe se nuk ka një bazë të shëndoshë formimi. Dhe kjo bazë, sikurse të gjithë e mbajnë mend, megjithse ka kalue një gjysmë shekulli prej kohës në të cilën ishte në lulëzim të plotë, gjindej në Gjinnazin “Illyricum”, sikurse edhe në Kolegjën Saveriane. Aty studjoi dhe u formue një plejadë mendesh së ndrituna, të cilat qenë shue me një plan kriminal që synonte vumjen në gjuhë të Shkodrës. Qenë po ata studentë, të Kolegjës Saveriane, të dalun në jetën e gjallë të qytetit të lindjes, që në një çast të caktuem (1929) themeluen Shoqinë kulturore “L. E. K. A”, e njikohësisht revistën me të njëjtin emën, e cila e vijoi botimin e vet deri në 1944, vitin fatkeq të pushtimit komunist të Shqipnisë, mbas atij të Italisë me 1939.

Por gjithçka nuk mbeti me kaq. Në vjetin 1937 qe bënë një hap i randësishëm përpara, gjë që difton përgatitjen e një numri në shëj studjuesish e letrarësh, disa sish edhe përkthyes të kryeveprave të letërsisë klasike botnore. Themelohet në atë vjet *Akademija Saveriane*, e para akademí në Shqipninë e pavarun. Ky themelim bahej kur pranë Etënve Jezuitë gjindeshin tashmë mjetet e duhuna për punë shkencore albanologjike. Biblioteka tejët e pasun, arkivi, mbledhë me një cenë për t’u admirue nga vetë pjestarët e Urdhmit Jezuit, me dokumenta të Vendit, me riprodhime nga arkiva të ndryshëm të Europës si dhe muzeu qenë elementat bazë për një zhvillim të mëtejshëm të kësaj shprehjeje në shëj të një pune shumëvjeçare, në mos shekullore të tyne në Shqipni.

Si pamë, ishin krijuar paravumjet për formimin më në fund të një klase intelektuale të nivelit europian, gjë që i kishte qenë mohue prej pushtuesit turk, tue mos pasë lejue ky deri arsimin fillor, ku do të mësoheshin gjuha shqipe dhe historia e popullit shqiptar.

Qe formue pra Nikollë Dakaj në ambjentin françeskan shkodran, në Gjinnazin “Illyricum”, ku mësimi jepej prej emnave më në shëj të Provincës Françeskane të Shqipnisë. Ndër mësuesat qenë Etnit Gjergj Fishta, Marin Sirdani, Donat Kurti, Viktor Volaj, Bernardin Palaj, vetëm për me përmendë ndonji sish, sepse asnjë frat nuk mund të lëhet jashtë për kontributin që ka dhanë në zbatim të parimit tashmë të njoftun të tyne “FË E ATDHË”.

Gjithë ajo dije e kulturë u bënë pjesë jetike e një të riu me talent, si ishte Nikollë Dakaj, i cili diji me e derdhë në veprat e veta, sidomos si përkthyes i autorëve klasikë.

Prej këtij ambjenti e në këtë shkallë formimi u shfaqën disa emna të tjerë në shëj si janë ata të përkthyesve të letërsisë klasike: Frano Alkaj, Henrik Lacaj, Pashko Gjeçi, Mark Ndoja, Dedë Gajtani, Guljelm Deda, të gjithë në moshë të ré. Kurse, në një moshë më të pjekun, tashmë njiheshin Át Vinçenc Prendushi, D. Lazër Shantoja, Át Mark Harapi, tue mos përmendë sa të tjerë që i dhanë një ndriçim të posaçëm kësaj pjese të letërsisë klasike në gjuhën shqipe.

Ajo që u dha dorë, për me e përballue në një mënyrë sa më të mirë këtë përpjekje, qe së pari formimi humanistik, dhe së dyti gegënishtja e tyne e lavrueme që, me fjalorin tejët të pasun të gegënishtes e me kuptimin e çdo fjale që e skalitë në mënyrë të bindshme atë që shprehë, gjë që nuk vrehet në fjalorin e gjuhës së sotshme zyrtare, tejët më të vorfën, në këtë

pikëpamje, solli krijime në gjuhën shqipe që nuk i lëshshin gjâ mangut, në kurrnji vështrim, krijimtarisë klasike. Nuk është i pakuptim ky pohim, sepse e gjithë gegënishtja, kishim me thanë burrnore, e ka djepin e vet në epikën legjendare, e në veçantí në qerthullin e Mujit e të Halilit.

Këtu duhet të kërkojmë e do të gjejmë formimin dhe frymëzimin e autorit tonë, Nikollë Dakës, i cili, e kishte me të leme frymën e gjuhën e asaj letërsie të dalun prej zemrës se malësorit. Ajo rrezaton njikohësisht gjithë atë bukurí shprehjeje që shfaq shì natyrën poetike të një populli i cili, tue jetue në malet kreshnike të Veriut të Shqipnisë, në të përpjekun me natyrën e ashpër të maleve, shprehte gjithë butësinë dhe bukurinë e shpirtit të tij. Nji kontrast që mund të spjegohet vetëm tue jetue përbrí atyne njerëzve.

E përvetësue me qysh me qumshtin e nanës, do të bahej vlerë e patjetërsueshme me pika të përpjekuni edhe me mentalitetin e një bote tashmâ të prenueme si ishte ajo greko-romake, por gjithnji e gjallë në kulturën e popujve të qytetnuem, gjâ që do të reflektehej në udhën plot vishtirësi të përkthimit të poetëve klasikë.

Duhet të kemi gjithnji parasysh se Nikollë Dakaj aq e kishte të veten krijimtarinë popullore sa që, tue krahasue përkthimet e tija me kangët e krijimit popullor, do të ndihet madhështia, do të thoshim klasike, e përkthimeve të tija njinji me atë të shprehun në tekstet origjinale.

E Nikolla, sidomos në faqet e SHKËNDISË, do të përpiquej me autorë si Homeri, Virgjili, Tibuli, Horaci (me disa vijime) e Katuli.

Prandej ndjekja e Gjinnazit “Illyricum” t’Etënve Françeskanë, me drejtim humanistik, ka qenë përcaktuese në formimin e asaj plejade autorësh të rij shkodoranë. Njohja me themel e gjuhëve klasike, greke e latine, ka qenë pádyshim, në kuadrin e formimit, një element bazë për përpunimin e asaj që do ta quejmë *forma mentis* e që do t’jetë element themelor edhe për ata që u morën, krahas krijimtarisë origjinale, me përkthimin e veprave mâ me randësi të autorëve në zâ klasikë.

Kështu prá duhet pá formimi, e rrjedhimisht fryti që erdh e u shtjellue në veprën e Nikollë Dakës.

Po kujtojmë në ketë pikë se, prej formimit klasik të studentëve të Kolegjës Saveriane, një student i saj, Luigj Gurakuqi, do të hartonte trí *Elegidion* në gjuhën latine e 25 vjeç do të botonte së pari, me 1904 të “Albania” e Konicës, *Vjershërimin*

Lavrimi i gjuhëve, së pari i atyne klasike, e mâ vonë, në rrjedhim të tyne, i shqipes që një ndihmesë në shëj për përkthyesin e ardhshëm. Gjithë kjo mori dukë me një fjalor të pasun, gjâ që i solli lexuesit një pasunim të mâtejshëm të njohunive në lidhje me bukurinë e gjuhës shqipe, tue qenë kjo e lidhun ngushtë edhe me krijimtarinë epike shqiptare, që është tejjet e pasun me fjalë e shprehje të atij burimi.

Duhet vretë se ajo gjuhë, me burim nga një gegënishte e pasun dhe e zhdërvjelltë, bâni që në dorën e Nikollë Dakës, edhe si përkthyes, të kthehet në një mjet komunikimi të gjallë për çdo lexues shqiptar, të çdo krahine qoftë, tua u bâ e kuptueshme dhe e shijueshme e tue thye mâ në fund atë koncept nihilist se gegënishtja nuk kuptohet nga toska, sikur t’ishte një gjuhë e huej, kur dijmë se edhe ndër toskë ka pasë e ka që e dijnë përmendsh deri *Lahutën e Malcís* pa kurrfarë vështirësie. Ketë nuk mbeti pá e vretë deri Norbert Jokli i cili me bindje pohon “... gegënishtja e shkrueme prej poetit të ri është një gegënishte e përbashktë, d.m.th. e kuptueshme fort mirë përgjithësisht”<sup>57</sup>.

Në ketë mënyrë vepra klasike e kthyeme në një frymë shqiptare bâhet mâ e arritshme për kedo i përket fisit shqiptar, tue i prekë zemrën e menden.

Randësi të posaçme merr prá edhe puna se përkthimet janë bâ prej veprave në gjuhën e zanafillës e nuk janë, si po ndodhë në shumë rase, përkthimi i një përkthimi.

---

<sup>57</sup> Shif: FEDRI, *Përrallat ezopiane*. I përktheu nga origjinali latinisht Nikollë Dakaj. Elbasan 2001, f. 17.

Sikurse merr edhe përdorimi i masave klasike. Në se përkthyes të tjerë nuk përdorën masat klasike në përkthimet e tyre, por masat popullore, qenë Etëhem Haxhiademi dhe Nikollë Dakaj ata që i shtinë, tue prû vlerësimin e prof. Jokl-it se këta “*po ecin mirë tue paraqitun në veshën shqipe edhe masat e vështirshme edhe të koklavituna të Horacit*” mbasi “*nuk është punë e vogël me ia përshtatun masat e Horacit dhe elegjitë e Tibulit gjuhës shqipe*”<sup>58</sup>.

Duhet pasë parasysh se formimi i thellë i Nikollë Dakës dhe bukuria e vargjeve klasike të autorëve mât në zâ të lashtësisë, të sillte që ai, edhe në krijimtarinë e tij origjinale poetike, të ketë ndikimin e atij formimi.

Tjetër pamje në veprimtarinë e Dakës është ajo e polemistit. Vrehet kjo në dy rasa. E para kur shprehet për përkthimin e “Të fejuemve” të Manzoni-t, dhe këtu polemizon me Át Mark Harapin. E dyta, kur me poemën *Koineja* shprehet me të drejtë por edhe me afsh kundër vendimeve politike të Kongresit të Drejtshkrimit të vjetit 1972.

Krejt polemika me Át Mark Harapit siellet vetëm e vetëm rreth çështjes së gjuhës së përdorun në atë përkthim, të kritikuem prej një letrari të rí, të posa kthjem prej studimeve përjashta, Kolë Ashtës, i cili mât vonë nuk ka me u përfshí mât tej n’atë polemikë.

Secili prej tyre, si Át Harapi si Dakaj, mpron tezin e vet dhe ketë mprojtje e bân, si thonë italianët, “*a spada tratta*”, gjâ që përcakton në njëfarë mënyre edhe karakterin luftarak të të dyve, i bazuem ky, qoftë në formimin e plotë intelektual e ditunor, qoftë në thellimin që kishin pasë me veprat e mëdhá të letërsisë së lashtë greko-romake dhe të letërsisë klasike moderne italiane e franceze që i bante edhe mât të bindun për aftësinë e tyre dhe rrjedhimisht për págabueshmëni.

Prej kësaj polemike, prá, spikatë natyra e rrëmbyeshme e të dy kundërshtarëve, ndryshe prej asaj të Kolë Ashtës, i cili nuk ndihet mât mbas gjykimit që jep për atë përkthim, kurse gjaku i nxehtë i Dakës dhe i Harapit bân që një argument plotësisht shkencor, i rrjedhun prej një mendimi që do ta quejshim akademik, pruni zbritjen nga një shkëmbimi opinionesh, sigurisht në kundërvumje, në një rragatje të panevojshme për argumentin e trajtue.

E gjithë kjo nuk i hjek një ashkle çështjes në trajtim.

Në qoftë se Át Harapi mpron tezën e vet me ngulm, kjo varet prej seriozitetit me të cilin e kishte marrë çështjen e përkthimit të një kryevepre të letërsisë italiane, si është “Të fejuemët” e Manzoni-t. Të kihet parasysh edhe koha e gjatë me të të cilën u mor me atë përkthim. Në qoftë se libri doli i botuem në vjetët ’40 të shekullit të kaluem, qysh me 1927 kishte botue një kapitull, do të thoshim sprove, në faqet e “Kalendarit të Veprës Pijore”, që botohej në Shkodër prej Etëve Jezuitë.

Në parim synimi i Harapit ishte mënjanimi i fjalëve të hueja, tue vlerësue sa mât shumë ato fjalë që i ka të shumta gegënishtja e jo toskënishtja, dhe e bájne prá që ky përkthim të marrë një karakter, simbas opinionit të Kolë Ashtës e të Nikollë Dakës, tepër lokalist e prandej larg që të shijohej prej lexuesit që nuk i përket Gropës së Shkodrës.

Megjithatë, në qoftë se qendrimi i Át Markut i përgjegjet një optike së caktueme, jo mât pak i drejtë është edhe ai i Dakës, i cili i ndikuem prej zhvillimit që kishte marrë gjuha si dhe afrimi që kishte fillue të dukej në shkrimet e revistave LEKA e Hylli i Dritës, sidomos te e para, bân që të shprehte me forcë një mendim në kundërshtim me atë të përkthyesit.

Argumentat që bje janë plotësisht të pranueshëm nga ana shkencore.

Së pari shef si domosdoshmëni pëshitetjen pa mëdyshje në Rregullat e drejtshkrimit të vendueve prej Komisionit Letrar të Shkodrës në vjetin 1917, megjithse nuk e pranon që, kur flitet për gjuhë të mesme të kuptohet e mesmja gjeografike, por mât tepër shef në ketë të shprehun një të mesme gramatikore e sintaktike. Në ketë mes propozon unjimin e gegënishtes, gjâ që toskët e kanë krye. Kështu që ndryshimet në mes dialekteve do t’ishin:

---

<sup>58</sup> Ibidem, f. 16,

“Rotaçisma, zbutja e zanores hundore n’ë, gjatësija e zanorevet dhe ndonji tjetër i pa randësi”. Si përfundim “Gjuha kështu do t’ishite e bashkueme mjaft, pa u përziem dialektet. Të përdorej atëherë nepër zyra e shkolla gjuha e mesme, sot zyrtare. Nuk do të prishej gjë. Shkrimtarët do t’ishin të lirë me shkruar si në njenin si në tjetrin nga dy krye-dialektet pa u bam kurrnji dhunë as shkrimtarëvet të mdhej gegë, as shkrimtarëvet të mdhej toskë”<sup>59</sup>.

Dhe në këtë pikë jemi deridiku sot, megjithëse kjo është një arritje krejt e vetvetishme e përdoruesve të gjuhës, e përligjërueme. Nënshkruesit e Akteve të Kongresit të 1972<sup>-shit</sup> e ithtarët e tij, misë të institucioneve shkencore gjuhësore, mbas 37 vjetësh, endë nuk marrin një vendim sa guximtar por edhe sa më realist për një zhvillim harmonik e pa humbje të vlerave të patjetërsueshme të gjuhës shqipe në tanësi, por mbesin të ngrimë në pozita tashmë të tejkalueme.

Polemika që qet në pah natyrën e gjallë të Dakës, për me pohue mendimin e vet, del në veçantë te poema *Kojneja*. Poemë në formë e në paraqitje, por thellësisht polemizuese në drejtim të organizuesve të Kongresit të Drejtshkrimit të vjetit 1972. Aty, në vargje, shpërthen natyra polemizuese e autorit për një pëdrejtësi që i është bërë gjuhës geqe, jo vetëm, por 4/5 të shqiptarëve gegëfolës. Gjuhë që sjell me vete një letërsi shumëshkullore, tue nisë me Formulën e Pagëzimit e tue mbërritë te autorët më të rij e bashkëkohës t’autorit. Nuk mungon në këtë poemë as ironia, por mbi të gjitha sundon kritika dhe thirrja urimtare që gjuha kombtare të jetë një bashkim i dy elementave, gegë e toskë, pa i përzie në mënyrë mekanike, e që do ta bajnë me përparue, tue vlerësue edhe më tej të gjithë pasuninë e patjetërsueshme të gegënishtes, dikur e pengueme, por që më në fund po përpiqet ta rimarrë veten.

Synimi i Nikollë Dakës, në krejt qendrimin e tij polemizues nuk ka tjetër qëllim veçse gjuhën shqipe, që duhet të ketë në themel rregullat e shpalluna qysh heret, 55 vjet para Kongresit të 1972<sup>-shit</sup>, rregulla që panë dritën në vitin tashmë të largët të 1917<sup>-ës</sup> nga një Akademi e vërtetë shkencash si qe Komisioni Letrare e Shkodrës. Rregulla që patën si mendim shkencor atë të tre gjuhëtarëve në shëj si ish-in n’atë kohë Maximilian Lambertz, D. Ndrë Mjedja e Rajko Nachtigall.

Qysh në themel e kapë çështjen Nikollë Dakaj, kur ven në dukje natyrën e vërtetë të atij Kongresi: “S’ecë para gjuha me ligjë e dekrete”<sup>60</sup> e më tej “Ç’ka paskajorja që të përjashtohet | nga gjuha si nepërkë, kur e përdorë | shumica e kombit ?”<sup>61</sup>. N’anë tjetër vëren se “S’ka atdhetar që s’është për koinenë, | për shqipen e njësuar vezullorë | ku të përpajnohen t’folmet krahinorë | e ku secili ta ndjejë gjallë të venë; || Ku e vjetra të gërshetohet me të renë | e veriore t’ecin e jugore | të rrokura si motra dorë për dorë | me n’ballë si ideal gjithmonë atdhenë ”<sup>62</sup>. Por ven në pah edhe dredhinë e komunizmit që, tue përfitue prej atdhetarisë së tyne shtini në kurthë “e arbreshë e kosovarë, që lodhë mërgimi | e malli për atdhenë këputë i kishte, | brohoritën me tjerët si ferishte | **pa ua pré mendja se ku ishte synimi** ”<sup>63</sup>.

Vetëm tue shqyrtue këto vargje kuptojmë mendimin e Nikollë Dakës e, po u krahasue edhe me atë të shprehun në polemikën me Át Markun, do të shofim se ajo që e ngushton, dhe e nxitë me u shprehë, është e ardhmja e gjuhës shqipe, si vlerë identiteti e pacenueshme për shqiptarin, vlerë që e kishte ndihmue për me mbijetue në shekuj e njëkohësisht me krijue ato xhevahire si janë kangët epike, të cilat nuk shprehin vetëm një krijim të shpirtit të rapsodit popullor, por janë në të vërtetë krijimtaria më e mirë dhe e mirëfillte artistike, e cila, me të drejtë, mund të quhet një fillim i dëjës i letërsisë së lavrueme shqiptare.

<sup>59</sup> Ibidem, f. 129.

<sup>60</sup> Nikollë DAKAJ, *Kojneja e gjuhës shqipe*. Tiranë 2008, f.45.

<sup>61</sup> Ibidem, f. 46.

<sup>62</sup> Ibidem, f. 44.

<sup>63</sup> Ibidem.

Si përfundim kemi se, edhe si polemist, kujdesi i parë i Dakës është gjuha shqipe me të shprehunin e saj të kuartë, me ndonji element nga pasunia leksikore e përgjithshme e ardhun edhe prej krahinave të tjera.

Me këtë, Nikollë Dakaj, bëhet dhe mbetet një ndër figurat e mirëfillta në përpjekje për një kulturë gjuhësore të vërtetë shqiptare e me frymëzime sa s'është kombtare shqiptare.

16.12.2009



NGA «ILIADA E HOMERIT»

## Libër I - Murtaja - Mënija

Mnën rrenimtare këndomë, oj Zan', ti t' Akilit Pelejas  
 T' zeza ndeshtrasha Akejvet e cila u solli me mija:  
 Shpirtën t' mdhaj kreshnik' sh në Fërr se shum gorrromisi,  
 Trupënt e tyne mandej ajo prë u a bëni po qëjvet,  
 Shujt' dhe shpëzve të malit'; e Zeusit u bëjte vullndesa  
 Qyshse s' pari u kapën ndër vehte edhe u kacafytën  
 Mbreti i burrave t' dheut Atreu, e hynër ai Akili. 5

Kush qe ai hë qi degam' ktyne t' dyve u shtini t' u zëjshin?  
 Bir' i Laton' s e i Zeusit. Në mbretin huj mbassi mori  
 T' zez' ky n' ushtri n' a lëshovi një dergjë, u farojte po gjëndja 10  
 Q'ish asobote qi Kryzin Atrejasi njat meshatarin  
 Pat nepërkamb'. Ky kish ardh' tek anit e shpejta t' Akejvet  
 T' bin për të nxjerrë, e dhanit kishte prëm të panumër me vehte.  
 Flamurin n' dorë edhe bajte të larg-shigjetues Apolonit  
 Maje shkeptri t' artë, edhe u lutej Akejve të gjithvet, 15  
 Veçanerisht, por Atrejve të dy, sundimtarvet të gjëndes:  
 » O ju Atrejë e ju mir' ndër kollëkë o Akej' të mbërthyem,  
 Jú ata zota po u dhëshin, t' Olympit qi rrijn' ndër pellaze,  
 Krejt m' i a sham' ju Prijamit mbretin, shndosh n' atme me kthyem,  
 T' dashunë muë me m' a nxjerr' t' ime bë, e dhanit me i pëlqyem, 20  
 Larg-shigjetuesin Apol tu' nderuemur të birin e Zeusit »

Tjer' t' sá qenë asobote në godi kan' ramun Akejajt  
 Mir' me u ndám me meshtár e dhanit t' i pranojn' të shkëlqashmet;  
 Por kurrq'sh jo për shtat nuk i rá Agamnonit Atrejas,  
 Keqas prandej e përzú dhe fjalë i flakrovi të rrehta: 25  
 » Mâ mos të bëj, o plak, me të zán' rreth anijave zgavra,  
 As tash ktu tu' u tallë, as rishtasi mbrapa tu' kthyem,  
 Shkeptri se gjâ nuk të vlen besa t'ë, as ai flamur' i hyjit.  
 Vet' atë kurr s' e lëshoi: mâ par' e pleqnija t' a zaje  
 Larg prej atnje n' at Arg, përmbrenda pellazeve' t' mija, 30  
 Vejk' tue bâm edhe muë bri shtrati ajo tu' m' u gjetun.

Hiqmu tash, mâ mos të m'ndezësh, shëndoshi ti po deshte të ndahesh. >

Kshtu tha; plaku m'atbot' pat' frig' dhe fjal' s i ndigjovi,  
Heshtasi çau nga brigjet e detit t' larg-shungullueshim.  
Shum mbasandej, kështu m'ânësh i ndám, m' a përbejti po plaku 35  
Mbretin Apol, atë t' cil' n kom' - bukura lindi Latona:  
> O zhgjetë - argjan' t më ndëgjo, Krysen qi m' mban ti nën proje,  
Kilën dhe t' shugurueshmen e rreblë e sundon ti Tenedin,  
Smintë, n' qoft' se ndo'i her' ndo'i shéjtnore të kandshime t' ngreha  
Ja por n' qoft' se njimend t' kofsh' të flijova të mujme 40  
Mzetsh a dhësh ndonji her', prá ti njëket' lutje pëlqema:  
Lot' t e mij báni Dánajt t' i lajn' prej zhgjetave t' ua, >

Kshtu tha ky tuj u lut'; vesh vù i ká Feb Apoloni  
Flak' dhe ndezun në zemër prej mojeve zbriti t' Olympit  
Krahve' ai shilizën mbështet', rreth e rreth në kukúr dhe mbështjellun. 45  
Se ç' bumbullojshin shigjetat prej krahve t' atij të tërbuemi  
Hapin ai nga po thekte. Si nata u dyndte teposhte.  
Nguli mandej ai aníve përbáll një heshtë edhe hodhi:  
Se ç' far' gjâmë të tmershme e rgjanta lëshoi patërshana.  
S' pari ai mushqve u rá të leht' mbasandejna langojvet, 50  
Por n' e mbram n' ata vet' tuj u sjell' me i msuk maje-mbrefun  
Mshoi: pa i a ndám q' asohere zjarmijet kufoma po kallshin.

Ndand' dit' rresht po n' ushtrí flakurojshin mëzdrak' t e hyjnueshim,  
Dilën e dhetë Akilen në kuvend mbar' popullin grishí:  
N' mend kta këlij qe një zoj' qi i a prá llan' - bardhë ajo Hera, 55  
Dhimb' pse për Dánaj m' i rá nga i vrejti kso dore tu' vdekun.  
Mbledh' teksá ata qen' në rend edhe patën zatetun  
Braf ndër ta m' kamb' tu' i a bâm, zù t' flase kamb - shpejtë ai Akili:  
> Mendja m' thotë, or Atré, mbassi smbrapun rishtasi jemi  
Dal' tash lypet të kthejm', na gjall' me shpëtuen në mujshim, 60  
Fare tu' qën' se Akejt, qe, lufta po i qet e murtaja.  
Çou por n' daç' i divnac, ja n' daç' meshatár po pëvesim  
Ja por edhe i andrratár—pse dhe andrra nga Zeusi dikohet —  
'Cili t' na thot' pse gjithaq pezmatuem áshit Feb Apoloni:  
Se a m' rrin idht' për ndo' i kusht të pakryem, për fli a por qindshe, 65  
Ja psë i rrunza' ei ndoshta dhe i dhíve t' zgjedhuna tymi i  
Dheshket atij si shpërblim qi nga na të laroje lingatën. >

Foli kso dore dhe ndëj, braf m' kamb' mbasandejna i a báni  
Njai Kalkant Testoreu, mâ i mir' qi nuk báhet shortari,  
Koh' n e tashme qi dijte, te ardhmen edhe të kaluemen, 70  
Vetë edhe prim m' u kish der' n' Hjon aníve t' Akejvet  
Ai me shortin e vet, Feb Apoli mësuem qi i a kishle ;



Qÿsh ká bâm mbassi mirë u mendue kuvendin t' a nise ;  
 » O Akilé, ti po don—mik i Zeusit—prej meje me dÿjtun  
 Idhun Apoli pse rrrin njai larg-shigjetues sundimtari ; 70  
 Gadi jam vet' me t'a thán', ti veç kqyr mirë e betomu  
 Se miqasishit me fjalë e me krah ké muë me m' u gjetun.  
 Pesh', besa, 'i burr' pse do t' çoi, veç tjerve të gjithvet i cili  
 N' dorë Argejt m' i ká, për fjal' dhe i shkojn' gjith Akejajt.  
 Mbreti i qénun pse kúr me 'i njeri harmatohet të vogël, 80  
 Ai, edhe për n' i a dal' t idhnin t' a pengojë aso dite  
 Mbrend' krahanorit po hujn e ruen, dërsá t' a shpërtheje  
 T' gjetmen ras'. Mendò, prá, se a ké si a bân me m' shpëtuem -

Ktij njeso dore po merr t'i përgjegje kamb-shpejtë ai Akili :  
 » Merr, prá, zemër e në at ogúr na kallxò qi po dijke 85  
 Pse kurrqÿsh, Kalkan, pasha Apolin—at mikun e Zeusit —  
 Për hír t' t' cilit Danájvet ogur' t po m' u shtron ti përpara,  
 Kush jo, gjall' sá t' jem' mbí dhé edhe sÿni të m' laje  
 Dorën e rand' s' do t' a vëje në tÿ rreth anijave zgavra  
 N' gjithsá Dánaj më janë, edhe n' thae për vetë Agamnonin, 90  
 Si má i miri n' Akej po tash qi na shitet i cili.»

Mori gajret atbotë edhe foli divnaci i shkëlqyeshim :  
 » Idhtë ai nuk rrin për ndò i kusht të pakryem, për flije jo qindshe,  
 Porse për njat meshtár nëpërkamb' qi m' ká Agamnoni,  
 Nga s' desht bín t' i a lirojte, dhantí as atij t' i a pranojte ; 95  
 Larg-shigjetuesi për kta çoi t' liga, gjithnji dhe do t' çoje,  
 T' zezë as murtajën Danájvet ai s' ká për t' u a ndám jo përpara  
 Se sÿ-sumbulla vash' të dashunit tat' t' i dorzohet  
 Pá ndò i pagesë a dhantí, t' shugurueshme 'i flí edhe qindshe  
 Kryzit t' i çojm'; njat her' kushdin e pajtojmë e e përkulin.» 100

## BASHO JONA

1. — *Pelejas*: Mhiemni i Akilit, prisi të Mirmidonvet; 2. — *Homeri* i quen Grekët herë Akejë, herë Argejë, herë Dánaj; 3. — *në Fërr*: në jetën e andejme; 7. — *Atrou*: Agamemnoni, bër i Atrout e vllá i Menelaut (v. 16-17: *dy Atroujt*); 9. — *blé i Lat, e i Zeusit*: Apoli; 11. — *Kryzta*: meshtár, prift i Apolit; 37. — *zhigjetë-argtant*: titull i zakonshëm i Apolit; *Kryzën*: qytet në Troadë, i kushtuem Apolit sikurse edhe qyteti i *Kilés*, po në tradë, dhe *Tenedi*, ishull n' Egjë (v. 38); 44. — *maje-ja*: maje qi del në shesh mbí maje tjera të njëj mati; 45. — *kukër-i*: vendi ku shtihet zhigjeta, milli i shigjetës; 47. — *si nata* i idhnuem për në tepri: Feb Apoli ishte zoti i dritës; 51. — *msuk-u*: topuz; 52. — *kufoma*: po kallshin: Grekët i digjshin kufomat; 62. — *çou!*: hajd; 65. — *flí-cinshë*: hekatombe, flí ojiqind qësh; 67. — *dherëket*: i kandet, i pelqohet; 80. — *i qénun*: zoti, i aftë shumë në gjithshka; *me u harmatuem*: me u idhnuem.

K. V. KATULI

## K A N G Ë I

KUSHTESA

Kúj librecin e rí t' i a truej të kandshëm  
 Me gurshpanin e brisht' tashsá të lmuem ?  
 Tý, Kornel: përse ti ké pasun doke  
 Për dishka t' i kujtojsh lokat e mija  
 Q' se guxim n' Italian' vetëm ti mirrshesh 5  
 Motet mbar' me na i çfaq' ndër trí vëllime  
 Të tan' dije, për Jovin, e t' vështira.  
 Fal' prandejna të qoft' shka ka kjo libërz  
 Sido t' jët:: e të bájsh, o virgjën projse,  
 Qi má shum se uji shekull të qindroje. 10

## K A N G Ë II

TRUMÇAKU

O trumcak, ti, gëzimi i vashës s' ime  
 — Me të cilin lodron dh' e mban në prëhën,  
 'Cilit bulën e gishtit qet kur sulet  
 Dhe ka doke t' a nzisë idht' m' e çukatun,  
 Ndërsá mue nji dishír përmbrenda m' kallet 5  
 Për të bâm nuk e dij çfar' loje s' kandshme  
 Asaj dhimbën për t' mujt' me i a leduem,  
 Thom se i ulet atbot' zjarmija e madhe. —  
 Porsi ajo me lodruem me tý të mujshem  
 Dhe të zëmrës me i hjek' t' idhtat kujdese ! 10  
 (Njaq kjo gjâ më pëlqen, sa thon' se e arta  
 Mollë i pati pëlqem vashës kamb-lete  
 Qi i a zgjidhi njat bréz ngamot të ngjeshun).

**Kushtesa.** — Me këtë kangë Katuli i a kushton veprën e vet poetike historjakut Kornel Nepotit. Metri, i të gjitha këtyne vjershave është *faleci ase njm'ndbetë-rokili katuljan* i përbërë prej pesë kambesh, ndër të cilat vetëm e dyta është *daktyl*: Kúj li-|brecin e| rí t' i a| truej të| kandshëm v. 2 Me gurshpanin... me gurin e vdekun qi grimcohet lehtae; v. 4 bokat e mija: Hafet e mija; v. 6 në trí vëllime: janë *Chronicon libri*; o virgjën projse: njena nga nandë Zanat ase *Mincerva*. **Trumçaku.** — E dashura e Katulit mbante nji zog për të kaluem kohën, të cilin duket se i a kë dhuruem vetë poeti v. 12 vashës *kamb-lete*: *Atlanta*, e cila kishte dishmuen se do të martohej veç me atë qi t' a munte në vrap e *Hypomeni* i a doli kësaj pune me dredhi tue i lëshuem në vrap e sipër nga njanën prej trí mollash t' arta qi i a kishte dhuruem *Afërdita*.



## K A N G Ë III

VDEKJA E TRUMCAKUT

Qani, o ju Dashunore, e ju Dishrake,  
 Dhe sá t'jeni ju gjindeja má e pashme!  
 Pse ka vdekun trumcaku i vashës s'ime,  
 Ai trumcaku, gëzimi i vashës s'ime,  
 Qi ajo donte má fort me sýt e ballit 5  
 Prejse i ambël pat qënë edhe m'a njiite  
 Njaq mir' zojën e vet sa vasha t'amën,  
 As prej prëhni të saj kurr s'u largonte  
 Por tash ktu tash aty rreth tue flutruem  
 Veç tu e zoja ndalohej me cijatun. 10  
 Ai por tash ka filluem nji rrug' të terrshme  
 Për njatje nga nuk lan' me kthiem askendin.  
 T'zeza m'qofshi, terrina t'zeza t'Ferrit,  
 Qi përpini, ju, bukurit të tana:  
 Çfar' trumcaku shkëput' më keni mue! 15  
 Oh, çfar' kobi! Heu, o trumcak ti i mjeri,  
 Për pun' t'ande tashí se vashës s'ime  
 Syzit frým së lotuemi zanë e i kuqen!

## K A N G Ë XIII

GRISHJE FABULIT

Mir' do t'hásh' o Fabuli i ém, tek une  
 Me ndihm' t' zotave përmbas disá ditësh,  
 T'mirë e t'majme në qoft' se 'i dark' me vehte  
 Do të sjellish, edhe nji vash' bardhoshe  
 Bashk' me vënë e me krypë e t'gjitha hokat. 5  
 Kaq në sillësh, po thom, o mik i dashun,  
 Mir' do t'hásh; pse Katulit t'and kuleta  
 Plot i ásh mbushun me shtretën marimangash.  
 N'tjetrën an' dashuní do t'gjëjsh t'përzëmërt  
 Dhe má t'kandshëm çaf ásh e má t'pëlqyeshëm: 10  
 Pse 'i bár ere tash t'jap, qi vashës s'ime  
 Falë i a kan' Dashnoret e Dishrahët,  
 'Cilit kúr t'i mirrah er' do t'lutish zotat  
 Hund' me t'bâm fund e maje, lum Fabuli.

BASHO JONA

*Vdekja e trumcakut.* — Vajton zogun e kangës II, v. 1 *Dashunore e Dishrake*: hyjni dashunije, v. 2 *e pashme*: e bukur; v. 18 *syzit*: zvoçlim i fjalës sy.

*Grishje Fabulit.* — Grishë Fabulin, në qoftë se i bjen të gjitha ushqimet me vehte, mbassi atij i ká frým era në kuletë. Te Katuli gjën vetëm dashuní dhe dhanti së dashunash.

# TITIRI

## E para kangë baritore e P. V. Maronit

*Qarku i përkthyeset të klasiket latinë në gjuhën shqipe po vjen dita ditës tue u shtue. Kretel intelektuale shqiptare kanë pasë rasën të shijojnë nëpër të përkohëshme të ndryshme, dhe në ndonji botim të reçantë copa të zgjedhuna klasikësh latinë, të përkthieme me kompetencë e me një gjuhë të rrjedhshme prej Z. Elehem Haxhiademi, prof. Frano Alkaj e prof. Henrik Lacoj.*

*Në ket numër të «SHKËNDIS» po u paragesim lexueset t'onë përkthimin e së parës kangë baritore të Vergilit me titullin TITIRI, të përkthieme ndër heksametra (si n' origjinal latinisht) nga një pendë e ré, qi duket për të parën herë në shtypin shqiptar dhe qi ep shpresa të mira se, do t'a pasunojë letërsia t'onë me shkrime të vlefshme.*

*Kjo pendë e ré mshehet nën pseudonimin Basho Jona.*

### TITIRI E MELIBEU \*)

- M. Nen njat ah dega-gjânë, Titir-ó, po ndëjua per rrashit  
 Ti një kangë baritore po merr me të njomë zanamara:  
 Brigjet por, qe, na po i lám t' atedheut, edhe lavrat e ambla;  
 Na prej atmje po dalim, ndersá shtrim, Titir, ti, n' hije 5  
 Pyjevet emnin u mson t' i a jehojn Amarildes së pashme.
- T. O Melihé, kje një hý, po, qi né kso qetije na fali.  
 Po se për muë një hý gjithmonë aj do t' jét; e theroren  
 Shpesh prej vathave t'ona me gjak një rrunzë do t' i a njome.  
 Lëja për lopë gjithkahë - si po sheh - t' mallojshin e mue  
 Liri m' dha me zumare të njomë të kendojshem ça dojshem. 10
- M. Smirë, mana, aspak s'po t'a kam; por bindem un: kahë për gjith ara  
 Mrapshtë gjithçafja po merr. Qe, vetë zemer-plasun po i reshi  
 Ftujat perpara; njiket mzi jam, Titir ó, tuj e bajtun,  
 Pse tashsá dy binjokë - ah! shpresen e grigjes - i lshovi.  
 Ktu n' rrasë t' lame, me múnd, ndershej lejthíve të shpeshta 15  
 Mendja e letë mos t'ish kjënë-nder mend áshit tash tu' më ramun-  
 Shpesh ket të zezë m' a thanë do lisa qi çavi rrufeja,  
 Shpesh prej iluja së thatë një sorrë kob-záuc m' a foli.  
 Për né tash, Titir ó, kush áshit ky hý, tí, diftona.



- T. Shí njaj qyteti i Romës, Melibé, mênde leti mendojshem 20  
 Se si ky i joni diç áisht, në të\_cillin\_kem' na barija  
 Doke shljerrat e njomë shpesh heresh teposhte me i reshun.  
 Klyshat 'isoj un i mbajshem me qêj; per dñi edhe i njifshem  
 Edhat; keshtu ish mesuë të mdhát me i marrë per të vogla:  
 Por, po, ballin aq nalt mbí tjera qytete kjo ngrefi. 25  
 Sá kanë doke\_selvít permbí\_t' perkulshimet çufra.
- M. Po ç' kje gjitha ajo punë qi Romen të çovi m'e pamuu ?
- T. Kje liriya nji sý qi m' a lshoi muë t' ngathtit t' e vona,  
 Mbas' qi perherë\_mâ e bardhë para rruësit mjekrra më bijte;  
 Lshoi por 'i sý mbí muë, mbas 'i kohe së gjatë ajo mbrini, 30  
 Mbas' qi né Galateja na lâ e\_na muër Amarilda.  
 Pse - perimend po t' a thom - sá ndorë Galateja më kishte  
 Shpresë liriye nuk ish, kujdes, jo, nuk ish pekulijet.  
 Sádo qi flí me shumicë prej megjave t' mija flakrojshin,  
 Vetë edhe djathtë t' pamazitun qytetit i zëjshem të shtrëjtít, 35  
 Plot me t' holla perhera e djathta s' m' u kthejte tu shpija.
- M. Bindeshem, oj Amerildë, hyjnit\_pse kputshim i thirrshesh,  
 Kokrrat-o n' dega të veta per kê kacavarë i durojshesh!  
 Titiri ktu s' ká kjënë. Titir-ó, po, tý njeto hala,  
 Tý njeto kroje të thirshin, të thirshin tý kto pemishta, 40
- T. Eh, ça me bâ ? ajo s'epte liri robenije me dalun  
 As ndokahë tjeterkund hyjnorë kaq t' ardhshim me ndeshun.  
 Ktu njat djalë të ri, Melibé, un e pásh per të cillin  
 Dymbdhetë hera në vjetë, po, theroret t' ona pergjaken.  
 Ktu, sá m' ndieu tu' i u lutë, kje njaj qi i pari më gjegji: 45  
 Lopët, ju, si paresh, o djelm, kullotnij, mberthenij muzetent.
- M. O plak-ó fat-bardhë, njeto troje prap t' uat po mbetkan!  
 Kaq edhe mjaft á per tý, sado qi rrasa të gjalla,  
 Knetë edhe janë plot zuktha me lmashk, kto kullosë tash të qesin; 50  
 Ftuja'et barsë 'i tagji, jo, keq s' do t' u bájë e panjoftun,  
 As e bagtís së sqiut nuk ká me t' i prá, jo lingata.  
 O plak-ó fat-bardhë, njektu te të njofshimet lume,  
 'Dhe nder currila hyjnorë\_freski tash gjën ti, në hije;  
 Tý po njetu tu i pari kufi, n' at\_gardhin shelqetit,  
 Bletat Hyblé kah shujtë nder lule perherë ato marrin, 55  
 Gjumin-o shumë me t' a ndjellë tý kanë me zuzatje të leten,  
 Ktu tash të kndon nen curra të naltë gjethatari tu veshi,  
 N' kaq tu' gungutë-ata t'út-zâ-marrunit pllumba me mé s'kanë,  
 As maje vidhi së hjedhtë me t' a lânë s' ká turtulli gjamen.



- T. Drëjt e letës neper ajr më parë prâ kanë me kullotun, 60  
 N' zall edhe peshkun picak m' e lânë kanë detet e mdhaja;  
 Visesh, po, se nderruëm, perpara kâ e mergueme  
 Partja me pimun n' Arar, ja n' Tiger me pî Germanija,  
 Se prej zemere s' onë njatî t' i kaloje voliia.
- M. Por na tjerët po kalojm n' Afrikâj prej etje të rreshkun, 65  
 Do per në Skytje po çajm e i Kretës te lum' i rrembyeshim,  
 'Dhe te Britâjt po thuej prej krejt rruzullimi të damun.  
 Váll, ndojherë, mbas 'i kohe së gjatë, un megjet e atmes,  
 Kulmin edhe të kolibes vobege me plisa mbulue,  
 Mbas do korrash me i pâm kam vetë edhe pronet e mija? 70  
 Ndoshta kto tokë kaq të pllëshme mizuër nji ushtâr do t'i gzoje?  
 Arat-o nji prej së huëjsh?! Qe, po ku mberrinë dasija  
 T' mjerët qytetarë të m' i çojë! Per kta, thue, arat i mbollem?  
 Eja, tash dardha shartò, Melibé, vé' per fije hardhija!  
 Hikni, moj ftuja - dikúr bageti fat-lume - ju hikni! 75  
 Jo, q' me njetash, mâ jú, nder zgore peshtetun të blera,  
 Vetë per kundruëll s' do t'u shof kacavjerrë nder krepa morrizash;  
 Kangen un krejt do t' a lâ: jo, vetë tuj e rruajtun, o ftuja,  
 S' kioi terfojë të kërthnestë as shelnje me kputun të idhta.
- T. Por, megjî kta, mbí gamba të blerë, bashkë mundesh me mue 80  
 Sontë njetu me konisë. Né pemë na qiltojn, po, të buta,  
 Kemi keshtëja të njoma 'i shumicë edhe kemi ua djathit.  
 Tym nder shpija perball, qe, kulmet e nalta po qesin,  
 Nisë edhe kanë m' u shtri prej malesh hije të mdhaja.

## BASHO JONA

\*) P. Vergil Maroni, mbreti i ujerrsharvet latinë, e shkroi këtë kangë në nderë t' Augustit, pse ky i kishte falë pronet atbotë kur tokë e Kremônës e të Mantuas po u daheshin ushtarve ngatnjyvesa veteranë si shpërblim, Titiri e Melibeu, emna barijsb, shembullojnë i pari Vergilin vetë, e i dyti nji asi orë zezësb që kjenë qitë prej tokve të veta. Blegloreshat Amarida e Galateja mshehin qytetin e Romës e të Mantuas. Augusti në këtë kangë emnobot hy a po djalë i ri (iuvenis).

Kanga shprehë më së miri natyrën e butë të Vergjilit. E përkthyen së pari A. Zanon i nder njëmbëthetë rroksha të lirë, e Z. E. Haxhiade mi nder heksametra.

## V R E J T J E

1) Vargu është heksameter daktilik. — 2) Dega-gjënë: E-ja kurr nuk numrohet rroke përveç kur gjindet ndër fjaltza nji rrokshë më, në, të, së etj. Në nji diftong zgjaton zánoren perpara. — 3) v. 17-18: Ndër Romakë kto dy sheje ishin ogur-zeza. — 4) v. 22 Me i reshun: për t' i shitë. — 5) v. 33 Pekulifet: Pekuli-ja: dhantí për të marrë me të mirë (Bashkimi). — 6) v. 44 Pergjaken: prej flish. — v. 46 Paresb: perpara, më parë. — 8) v. 47 O plak-o: në krahasim me vargun 29. — 9) v. 54 Shelqetit: shelqet-i: pyll shelqesh. 10. v. 55 Bletat Hylbé: (Sicili) ishin n' ato kohë fort të përmenduna. — 11) v. 99 Gjamon: tur.ulli gjimon. — 12) v. 64 Vollija: voli-ja: mollza e faqes. — 13) v. 72: varg spondaik (me spondë në V kambë). 14) v. 74: në frymë t' idhnis. — 15) v. 76 Zgore: zguer-ori (zgore-ja: zgaverr në shkamb a landë-



## Në dekë t' At Gjergj Fishtës O. F. M.

*Vec, po, dersá mos t' shkimben hana e dielli,  
E e mbramja cirkë n' Ocean t' kthellë mos t' shtrrase,  
Emni i atij burri, qi per Atme e Fé  
La nám n' fis t' vet, aj p' rherë gjallon, e deka  
Mbi të pushtet nuk ká...*

(FISHTA - «MRIZI I ZANAVET»)

Po, po, se edhe njaj diell qi plot gjallui  
Gjit e natyrës i njethë, ka' i amshueshim  
I bjen terthores s' qiellve, 'i ditë do t' vrohet  
Kulihum permbí dhé tu' u gorromisun  
Rob i koses mortore. Gjithç'á mb' shekull  
Shuhet e des má pak kúr të mendohet.  
Dritarët e mendes deri m' sot na i kuaqte  
Pamja e madhueshme e 'i burri të shkelqyeshim  
Si hýll nder shokë; i kjarti báll i t' cillit  
E syni depertues qi hajte zemrën,  
E hapi hije-madh si me perpimun  
Malet e rrmbyeshme t' Shqyptaris të dojte,  
Gjithkúj e njoft, pushtet — i thojshin — deka  
Mbi të nuk ká. Mbrenda nji vorri t' zí  
Aj gjumin megjithkta sot nisi t' gjatin,  
Mjesá mbarë toka kapertnyem arbnore  
Rrin e kqyrë me habí kah Ora i vojti.

O frat fat-bardhë, ti pernjimend kjé Ora  
E Shqyptaris: qyshse mbi lule t'ballit  
E butë pranvera zû me t' vezullue,  
Atë mb' krye t' vendit n' krahanuer e vune  
Bashkë me njat Fé, kujtim qi kemi s' naltit.  
Lahuten ndorë ti more, e n' gjuhë të t' Paryet,  
Fisnike e cilla n' pluhën t' tokës deneste,  
Nalt i naltove n' rrethe t' nalta flijet  
Qi rán p'r Atdhé: atbotë dheut t' Kastriotit

Fati i u qesh, e gjakut t' onë bujár  
 — Rrkajë anekand qi *malesh* gurgullojte  
 Per me qindrue ah: p'r at liri pá t' cillen  
 Jetë zemra s' ká — i u gjet i gjallë Omiri.  
 Njajo zemer qi deri tash tý tejzat  
 T' ushqeu pá prá e gjallë edhe gufnese,  
 Murojë Atmes i u bá shi prej arenzit  
 Qyshse «*MBAROI MALSIJA*». Por lavdet t' tana  
 Kush mund t' t' i njehë, o hylli i tokës arbnore ?

Nji gjumë të randë, po thuej se nji gjumë deket,  
 Shqypnija flëjte. Arbnori zdashë e zdathë,  
 Rrebtë tuj ofshá nen thunder t' zezë anmike,  
 Terthuer shikjohej vllá me vllá; dishiri  
 Kurrkund s' e lodhte kryet nji herë perpjetë  
 M' e ngrehë, qi parzma t' i lakmojte t' mjerit  
 Diellin t' gzojte gjallnues, i lir pá droje.  
 Pushken e gjatë edhe të idhtë tagá'n  
 Gjithmonë besnik, aj gjakut t' vet i a sllte  
 Prej s' huejsh i rrëjtun e prej s' egrash vuejtje;  
 Ndersá besë e burrní e bujarí  
 — Má e bukra pasuní s' parësh trashigüe —  
 Veç e per veti n' punë sejcilli i shtijte,  
 Pá i rá nder mend se kahdo gjuha e tí  
 E turrshme 'ihëri bumbullojte e e ambel,  
 Atje vllazen aj kish nji zemre e' i gjaku.  
 Lmekun prej gjamve t' katerqind pranveravet  
 Armët ndoshta pergjithmonë me i lshuem aj matej.

T' izetten herë por krye tue qitë qindvjeta  
 Q' se dritë t' vertetë pau rruzulli lumnijet,  
 Burra t' atidhtë Shqypnis Sunduesi i Eper  
 Vullndese s' paperkulshime i dergovi,  
 Qi prej Deçiqit deri mb' ranë të Artes,  
 Prej delit ilirik e mb' stom t' Vardarit,  
 Shperthyen porsi rrufé ku i ftou liriya;  
 E bashkë me ta çoi tý, o Kangatár,  
 Qi vepers s' tyne s' lartë e kreshnikore  
 Vlerë t' i epshesh e émen të padekshim.

E burrat shkuen prej plumbeve trathtare  
 T' gjith nji nga nji; por ti, o frat fat-bardhë,



Gjith-herë vigan, gjith-herë edhe i palodhshim,  
 Porsi ata rrathët e kreshtes s' Veleçikut,  
 Kambë vetun ngule, vetun e plotsove  
 Shka ata filluen. Perherë e mâ kreshnike  
 Kanga e kandshime e jote tuj ushtue  
 Zgjou pergjithanesh jetiket virtyte  
 Fushash e malesh. N' shkollë edhe u' therore  
 Frymë s' vertete s' patundshime prej tejet  
 Shqyptari i etshim terhoq, deri tash  
 Qi zâni i yt kumboi kudo qi e lypen  
 Atdheu e Feja.

Kush por — vâj! — mbas sotit,

Ktî zâni fijeat qi m' i u kanë ngri,  
 Kâ me na i folë Arbnorit? Per Shqypni  
 Kush kâ me i rritë breznit e reja? *Vallet*  
 Kush të *Parrizit* do t' na i thotë?...

Shum—kushi

Kujton, o FISHTË, me tÿ se krejt Shhypnija  
 Humbi në vorr per jetë. Por kot. Sá heresh  
 Vetë msue na ké se deka veç â praku  
 I jetës s' dytë, ku Baba i rruzullimit  
*Amshon n' lumni shka Atij t' i két peryjë;*  
 S' diqe prandej, por pernjimend sot leve,  
 E kushdî tash, ndersâ me evari  
 Te ti kujtimi m' fluturon me ande,  
 Me Skanderbegun e me Dedë Gjo' Lulin,  
 Me Naim Frashrin, me Çerçiziu Tòpulli  
 N' gjuj lutë Tenzonë ti per kombi shqyptare.

Por, pse, moj zemer, hovin pá nevojë  
 Larg m' e marrun po don permâje rêvet?  
 Rët veç e shí dikojn e borë të shumten  
 Ke tjeter na nuk meritojm. *Lahuten*  
 Çile një herë, e hapin theke 'i hera  
 Nder bjeshkë të nalta *Mriz* ku *Zanat* ngrehin:  
 Nji zâ njaty ké me veshtruem të ambel  
 E t' rî gjithmonë, qi ligjeron si shpatë;  
 Aj vllazen do t' i mbajë Shqyptarët gjithmotin,  
 — Sa Osja bashkë e Marash Uci t' kndohen —  
 Gjithmotin Atmes do t' i rrijë parzmore,  
 Gjithmotin FISHTEN gjallë e ruen nder né,  
 Valët e Drinit sâ t' dynden rrotullore.

BA-JO

PREJ ALB TIBULIT**LIBER I - ELEGIJA I***(Metri: distik elegik)*

Don prej ari së verdhë pasuní t' grumbulloje ndokushi \*  
 E t' zotnojë me shumicë pendë të punuëmuna dhé,  
 Friga të cill' n m' a ndrydhë sá herë qi t' afrohet anmiku  
 Gjumin edhe m' i a kputë záni i buríve per luftë :  
 Por muë m' del kjo pakica qi kam në qetf me jetue 5  
 N' voter t' eme ndersá zjarm të flakojë pa i a dá.  
 Vetë, po, po, mundem kondend ket jetë m' e çuë me pak sende  
 Kund pa pasun nevojë rrugë per me marrun të gjatë;  
 Por të xetit të verës me i hikë nen hije t' i lande  
 Qi t' naltohet perbri krojeve t' kjartá unjí. 10  
 Marre së m' vjen pse ndoj hera në dorë un të kapí dy-brynshen,  
 As pse t' ngathtit qé t' nguei ndojhera n' usté;  
 Rrunzen as edhin e vogel, e áma jashtë po t' a lëjte,  
 Merzí s' kam në gjí deri tu shpija t' a bajë.  
 Cuba 'dhe ujq, jú dhimbë le t' u bijë per kta shtjerra të vogjel, 15  
 Ma mirë pré á me rá grigjë ku të ndeshni të mdhá.  
 Koha sá t' u vije, hardhija me vú kam të njoma  
 'Dhe pemë tjera të mdhá porsí nji bulk i mesuëm.  
 Shpresa me m' rrëjtë, jo, s' ká, por frytet grumbull perhera  
 Do t' m' i apë e me musht t' mirë do t' m' a mbushe fuçin. 20  
 Pse njiperuji un i çmoj, kúr t' jén me lule rrethue,  
 T' vjetrin gúr n' udhë kryq, drún 'dhe të shkretë në livadh.  
 'Dhe çdo fryt qi i riu të m' bije vjeti me veti  
 Zotit bulk, po, per flí para kam vetë me i a vú.  
 Çères e artë, nga katundi i jonë t' kjoftë falë 'i kunorë prej 25  
 Kallzish, qi t' rrijë varë perpara tempullit t' and.  
 'Dhe nder kopshtije me pëmë, po, i kuqi t' vendohet rojtari  
 Qi t' i trembe me kosë t' eger Prijapi, gjí' zojt.  
 Ju edhe, Larë, qi n' rojë njeket arë tash të vorfen e keni  
 — T' pasun por dikúr — epni dhantít qi u perket. 30  
 Mzet me mija nji herë pastrojte 'i mzore e coptueme :



Flí tash' i kingj të ligshhtë trollit të vogel i bájrn.  
 Jú, po, një kingj tash u pres rreth të cillit rinija e katundit  
 «Rrnoshi t' mbjelluna» t' vrrasë «vënë 'dhe n'a qitni të mirë».

Ktu per gji' vjetë kam zakon blegtorin t' ém m' e pastrue, 35  
 Doke me tam' edhe kam Palen e kandshme t' a lajë.  
 Eni ktu, hyjnorë, as prej kso sofre së vogel,  
 As prej vorbe së dlië mos t' i perbuzni dhantit.  
 Vorbat i báni n' e parë per veti një i vjeter nder pyje  
 N' vend t' putirave t' onë, bote së butë tu' i thadruëm. 40  
 S' jam tue lypë pasunit e t' parve, as frytet të cillat  
 Arët e punuëmuna mirë gjyshit të vjeter i dhanë.  
 Paksá tokë mjaft ásht, mjaft ásht mbí shtrat me pushue  
 E m' e ulë ngae n' dalët n' shtrojë të zakonshime shta'n. 45  
 Se ç' galdim ásht rát stuhit me i ndië të terbueme  
 Ngrykë edhe m' e mbajtë vashen në parzem të njomë,  
 Ja kúr Jugu dimnuër ujë shum të sjelle me veti  
 Pa farë droje në gjumë — shiu tu' t' perkundun — me rá!  
 Kesh e t' a kish kaq vetë: e njaj qi terbimin e delit  
 E t' zín shí t' mund e bajë t' jét pasanik me të drejtë. 50  
 O dalët fare má parë sá ár e smaragd ká bota  
 Se per largimin t' onë sýt e ndoj vashe t' lotojn.  
 Ty t' ká hije, Mesalë, per tokë e per dét me luftue  
 Qi shpís s' ate t' i pritsh sulmin e turrshim anmik, 55  
 Lidhun por muë po m' mbajn, qe, verigat e vashes së pashme  
 'Dhe prandej po rri rojë para t' egrave dyër.  
 S' kam, jo dishír per kso lavdesh, oj Delja e éme, me tý veç  
 Mjaft qi të m' dale perorë—t' lutem un—afras me mbetë.  
 Tý me t' vrojtë, po kam kúr ora të m' qaset e mbrame, 65  
 Me dorë t' éme të zbét ngrykë kam me t' marrun tuj deké.  
 Me kjá ké ti, lum Delja, 'dhe n' sbtrat si të m' ulsh per t' u djegun  
 Lotë tuj derdhë n' idhní ké ti me m' puthë pa pushim.  
 Me kjá ké: porsí hekur të fortë nuk i ké, jo, ti tejzat  
 As njat zemer të butë gurit nuk ké si t' a kesh. 65  
 Djalë n' at mort as vajzë me pasë nuk ká qi të mundet  
 Kta t' dy dritarë të zbét rishtasi n' shpí të m' i kthejë.  
 Mant e mí mos i nguc ti m' atbotë, por kqyr e kurseji,  
 Dele, flokët e shkatrruëm, t' njethá kurseji volit.  
 Nderkaq veç — sá fati t' na hecë — dashuní na të lidhim, 70  
 Pse ká deka me ardhë krejet mertisun me terr,  
 Kryë, qe, koha e plogët po na qet, e s' do t' mújm na me dashtun  
 As me flokë të bardhë s' kemi me mujtë të miklojm.



Punë tashi t'kem' me të let'n Aferditë, sá mbarre mos t'kemi  
 Dyërt me i shperthyë e degamë sá t' na pelqeje me zânë,  
 Ktu jam un pris edh' ushtár i pashoq; ju flamurë e burija, 75  
 Hiqmuni kndej edhe varrë sillnjuni njerzve dishrakë,  
 Sillnju 'dhe gjá : un 'i herë i sugurtë si t' i mbushi kotecat  
 Kam me larguë pasanikët, kam me larguë edhe ún.

## BASHO JONA

## V R E J T J E :

- \*) Në ket elegí Alb Tibuli i lypë ndjesë Masalës, mikut të vet, pse s' mujte me e ndjekë nder lufta mbasi i delte e i teprote gzimi i voters, i jetës së katundit e i dashtnis.
- v. 2. pendë... dhë: njaq tokë sá pnojn dy qé në një ditë.
- v. 11. dy-brynsheh : (*bidentem*): berr qi çohet me u pré per fí.
- v. 14. rrunzen : dele njëj vjeti.
- v. 19. Shpresa : hyjnija e shpresës.
- v. 21. Kúr t' jót me lufe rrethue : prej popullit në shëj nderimit.
- v. 22. Nen trajtë të njëj trupit landet a të njëj guri paraqitej zoti i kufijvet *Terminus*; ktu mund të merret si hyjni arash pergjithsisht.
- v. 24. Zotit bulk : *Silvani*, hyjni e vjeter romake, qi mproje arat e bagtin.
- v. 25. Céres e artë : hyjnesha e tokës (*Demetra*) qi paraqitej flok-artë.
- v. 27-28. Nen trajtë të njëj surratit të kuq me kosë në dorë mshehej zoti i kopshtijevet, *Priapi*.
- v. 29. *Larë* : janë *Lares familiares*, shpirtent e gjyshavet qi mbaheshin si mprojtca të shpis e u báhej kremtja në Mars.
- v. 33. Jú : flet me hyjni qi ká permendë ma nalt.
- v. 36. Palen : *Pales*, hyjneshe barish.
- v. 47. Jugu dimnuer : *Auster hibernus* : erë hyjnore.
- v. 51. *Varg spondaik*; *Smaragd* : gúr i çmueshem.
- v. 23. Mesalë : M. Valer Mesalë Korvini, gojtár i mirë e mecenat i Tibulit.
- v. 57. Delja : (*Delia*) : e dashtuna e poetit (pseudonim).
- v. 67. Mant : (*Manes*) : qubeshin kështu hijet e të dekunvet.
- v. 71. Koha e plogët : plognja.
- v. 73. Të let'n Aferditë : *Venus*, hyjnesha e e dashtnis e bukuris.
- v. 74. Degamë : degamë, grindje dashunore.



PREJ HORACIT

## KANGA SHEKULLORE

*Që nga vjeli 249 p. K. dihet se genë krentuem disa Lojë (Ludi) për mirvojftjen e luftës punike. Më vonë Augusti deshi që këto lojë të përsriteshin për amëshimin e Perandoris. Krentoheshin krye 110 vjetësh (njij shekulli). Krentimi për të cilin Horaci e shkroi këtë kangë u bë në 17 p. K., dhjetë vjetë mbassi Augusti kishte marrun në dorë Perandorin, tue culosun këshu syprantën e Romës përmbi bolë. — Kjo kangë është korale, e këndueme nga 27 djelm dhe po aq vajza. Dallohet ndër të gjitha kangët e Horacit për një harmoni të veçantë varguimi dhe për ndiesi të thellë fetare.*

**METRI** : strofë safike, e përbëme prej tre njimbëdhjetë-rrokshash safikë, me daktyl në kambën e tretë dhe prej një adoni ase pësë-rrokshi me theksim përmbi të parën e të katërtën rroke. Njimbëdhjetë-rrokshat e kanë pushimin (cezurën) përmbas rrokes së parë a edhe përmbas rrokes së dytë të daktylit, d. m. th. mbas rrokes së pësët ase mbas së gjashtës :

Féb e — ti Di — anë || o e — pyjvet — zója . . .

Nderë e — bardhë e — qiellit || o — jú t' nde — ruëshëm . . .

(adoni) Epni shka u — lypim . . .

Feb e ti Dianë, o e pyjvet zoja,  
Nderë e bardhë e qiellit, o ju t' nderueshëm  
Dhe t' adhruem përher' në ket koh' gjith-shëjte  
Epni shka u lypim,

Pse n' këtë t' Sibyl's urdhënuem kan vargjet  
Djelm që t' pamashtrë edhe vajza t' zgjedhna  
Zota'e t' cilve t' shtatta pëlque u kan kodrat  
Kang' t' u këndoishin.

V. 3. Koh' gjith-shëjte : për arsye të përsritjes së Lojvet Shekullore (Ludi Saeculares).  
V. 5. t' Sibyl's . . . vargjet : profetët e Sibylës ishin të rreshtueme ndër vargje poetike ;  
V. 7. Zota'e t' cilvet . . . : Zotavet mprojtës të Romës, qytetit të shtatë kodrave.

O ti Diell gjallnues, me koç' qi t' ndriçme  
 Dit'n e çel' dhe e sosë edhe i tillë e i ndryshëm 10  
 Lën përsri, kurrgjã, jo, mos pásh má t' madhe  
 Kund ti se Romën.

Si e ké doke fmiyt qiti n' drit' sa t' báhen  
 Lehtas, llythé, e përkrahi nanat  
 Si në don Lucin', ja má fort me t' quejtun 15  
 Don Genitale.

Oj hujnesh', rinfn ti t' a rritsh, kanunet  
 T' i ringjallsh t' eprorve përmbi t' bashkuem  
 T' gravet, e t' pinjojvet përher' má t' ngjeth't mbi  
 Ligj' të martesës, 20

Kangët qi kështu edhe lojëti bota  
 T' i kremtojt' n' qetf mbas qindëdhjet' vjetve  
 Tri her' dit'n e bardhë e njaq her' tu' i ndjekun  
 Natën e kandshme.

E ju, Parka, knduem qi veç kini t' ndrejtën 25  
 — Shka nji herë ásht folun qindroft' gjithmotin —  
 T' mirat, ju, nji her' mbassi t' i plotsoni  
 Shtonani fate.

Toka plot me fryte dhe gjã të gjalla  
 Cerérës t' i a vëjt' nji kunor' prej kallxish,  
 Bulve t' reja ushqim le t' u japin t' shndoshta  
 Erët e uji.

J ambël ti dhe i but' mbassi t' ulish heshtën  
 Djelt qi jan' tue t' lutun, Apol, veshtroji ;

V. 9. *Diell gjallnues*: Dielli këtu paraqet Hujnin e dritës Febin (Apolin), i cili për shkon qiellët me nji koç' (karrocë) të ndezun ;

V. 15. *llythé*: emën i Djanës, sikurse má poshtë *Lucinë e Genitale* ;

V. 17-20: Augusti kishte bãm nji rregullim të veçantë për martesë, prej se nga përdhosja e kohës djelmnija e Romës pakohej për ditë má tepër; këtë ligjë e dekretoi edhe Senati ;

V. 21-24: flet për kangët dhe lojëti shekullore, të cilat kremtoheshin për tri ditë e tri netë me radhë ;

V. 25. *Parka*: Parkat ishin tri hujneshat qi kishin në dorë fatin e jetës së njeriut ;

V. 29. *Toka*: këtu e hujnizueme, zoja Tokë ;

V. 30. *Cerérës*: zojës së prodhimëve tokorë.



Veshtroi, mbretënesh' drapënore e hyjvet, 35  
Han', tani vajzat.

Romën n' qoft' se ju e ndërtoet, dhe aradhet  
Përmbi breg etrusk patën ngulë iljake  
— Njajo tub' qi n' udh' të sigurt' do t' ndrronte  
Lar't e qytetin, 40

Pa rrezik së cil's nepër Troj' të kallun  
Ai Eneja i mir' qi n' atdhé teprovi  
Shteg i çeli t' lirshëm, mâ shum tue i fol' se  
Ishte tue lanun —

Zota, doke t' mbara rinis së rysun, 45  
Zota, ju qet' pleqënis së kandshme  
Fisit t' Romlit gjâ dhe nipni t' i jepni e  
T' gjitha të mirat ;

Dhe shka — që të bardh' tu' u flijuem — t' u lype  
J Ankizeut bujar e i Veñerës gjaku 50  
Le t' a nxjerre — i par' m' kundërshtar' — e t' sillet  
But' me të thyem.

Ja për tokë e dët se të rrebtat çeta  
Medi fort po i dron edhe albanet spata,  
Urdhna Skytt tue pritun tek jan', t' parysun 55  
Tash edhe Indast.

Ja se besa e Paqa, Turpnimi e Nderi  
Guxim kan me t' hershmin virtyt t' përbuzun  
T' kthejnë, e krye po qet Plotënija e lume  
Mbush' me të mira. 60

Ogur-mir' stolis' me mëzdrak t' shkëlqashëm  
Febi, qi u pëlqehet të nand' Kamene'e,  
Me mjekí t' shëndosh't qi përtrín' të lodhnat  
Shise të trupit,

V. 37. *ju*: ky përemën lidhet me emnin *Zota* të vargjevet 45 e 46 ;

V. 39-44: përkujtohet shpërngulja e Eneut nga Troja ; *iljake*: trojane.

V. 43. *tue i fol'*: tue i premtucm ;

V. 57-59: këta gjashtë emna me germë të madhe janë paraqitun si hyjnif ;

V. 62. *nand' Kamene'e*: nandë Kamaneve, nandë Zanave, të cilat i drejtonte Febi,  
i përmendun edhe porsí mjek hyjnuer.

Drejtësisht fortes't palatine t' vrente, 65  
 Dhe fuqin e Romës e Lacin. gzueshëm  
 Vjet për vjet má t' mira sigure mote  
 Kishte me sjellun :

Dhe ajo q' Aventinin sundon e Algidin  
 Djana pësmbðhet' djelve m' i a u kqyr' kish lutjet, 70  
 Edhe me mirsi përkushtís së vajza'et  
 Vesh do t' i vënte.

Se kso mendje' áshjt Jovi e hyjnit<sup>2</sup>të gjitha  
 Plot me shpres' të mir' në shtëpi po kthehem  
 Febit valle i msuemun edhe Dianës 75  
 Lavde me i kduem.

## BASHO JONA

V. 65. *fortes't palatine* : Augusti përmbi kodrën palatine i kishte ndërtuem Febit një faltore të madhueshme ;

V. 66. *Lacin* : *Latium*.

V. *Aventinin . . . Algidin* : Aventini áshjt një ndër shtatë kodrat e Romës, dhe Algidi një mal në *Latium* ; ndër të dyja këto Djana kishte nga një faltore.



Prej HORACIT

## LIBËR III — KANGË XXX

*Metri i kësaj kange është asklepjudeu (i parë) i përsritun vijimisht: Përbàhet nga një tripod i daktylike e gjymët dhe një dipodi daktylike, të ndame përmes prej cezure:*

*Ja, se — një pome — ndâr ||ngrefa ma — t'amë — shuëm*

Ja, se një pomendár — ngrefa ma t' amëshuëm  
 Se bronzi e më t' naltë — se piramid' t mbretnorë,  
 T' cil' n as shiu rrenimtar — as i tërbuëm veriu  
 Mos të mund t' a rrënojë — as i qindvjetve mbarë  
 I panumërti rend — as rrokullimi i koh' s. 5  
 Krejt nuk kam për t' u sosë, — porse një pjes' nga unë  
 Do t' i rrshas' Libitin's; — deri në mot më t' largë  
 N' lavde t' reja me u rritë — kam derisá 'i uratë  
 T' kapet m' at Kapitól — me' i virgjioesh' të urtë.  
 Ká me u thán' kah i rrebtë—dirgjet Aufidi e kah 10  
 Dauni i vorfën për ujë — gjind pat sunduëm bulqorë,  
 Prej nji s' vogle shtëpi — rritun e bâm i madh  
 Kang' t më i pari kam sjellë — vel' po, te Eolis  
 Ndër mënyr' t' Italis. — Mirre tashi lavdín  
 E fituëme me t' drejtë — kryët edhe muë plot gzim 15  
 Me njat larin delfik — oj Melpomen' rrethomë.

V. 2.—Piramid' t mbretnorë: naltuem me madhni mbretnore; v. 7.—Libitin's: *Venus Libitines*, hyjuesha e sjelljevet të mortëshme; v. 10.—Aufidi: lum i Apuljes (Ofanto); v. 11.—Dauni: për një liri poetike është marrun këtu mbreti *Daunus* në vend të *Daunias*, krabinës që ai sundonte, për arsye t' afërsis së këtyne dy emnave; v. 13.—te Eolis: vargjet e poetvet colë *Alkeus* e *Safos*; v. 16.—Melpomen': zana e tragedis e te Horaci, zana e poezis së naltë dhe të prekëshme.

## LIBËR IV — K A N G Ë VII

Metri i kësaj kange është arkilokeu (i tretë i përbërë prej njëj heksametri, dhe njëj tripalij; katër llojë të gjymtë në një rroqe, a por më shqip prej njëj ištati-rrokubi me theksim në të parën, të katërtën dhe të moranën rroqe, e cila në metrikën moderne do të viente për dy :

*Bora tek-është tu' u-dë || edhe-bul't po u-ktheju' për gji'-fusha  
Pemve mbi-kreshlën e-njomë...*

Bora tek është tu' u dë, edhe bul't po u kthejn' për gji' fusha  
Pemve mbi kreshlën e njomë :  
Toka faqe po ndrron, mbrend' bregut të vet edhe shajun  
Ambël lumejt po kalojnë :  
Hirja valle të keej' me Floçka dhe motra të dyja 5  
Çveshun po merr', ja, guxim.  
Gjã t' amëshueme mos prit t' vjeti t' a thotë edh' e madhja  
Or' qi ket dit' do t' na rrmbejë.  
T' Ftoftit me u zbut' po i a nis' me Freski, pranvera dhe vera  
Doli kalojse, si fryt 10  
Viesht' fryt-plota të jap', do t' shuhet; e plogt' mbasandejna  
Stina ma e shkurta na vjen.  
Han't e shpejta, po, në këto ndrrime na i sjellin qiellore :  
Kryenin t' a ulmen' i herë,  
Shi ku i buti Enë, ku Tuli i pasun, e Auku, 15  
Pluhën e hije do t' jem'.  
Zotat e epër kush din të na thot' në se vjetve të tashme  
Koh' do t' u ngjesin të ré?  
Gji'shka dorës së shtrëjt' do t' i rrshase së trashigimtarit  
Shpirtit t' aud mik qi t' i japsh. 20  
Kryet ti 'i her' tek t' a ulsh, mbi t' y dhe Minosi të rrëbtat  
Gjyqe të veta t' i bájë.  
Fis as mirsi, lum Torkuati, as s' ké gojtarí qi t' i a dale  
T' y prej andejna të kthejë ;  
Pse Hypolitin e pastër kurrqýsh nga terrinat e Ferrit 25  
Djana s' i a del t' a lirojë,  
As të dashunit t' vet ato pranga e Letit m' i a kputun  
S' mundet Theseu Pirithout.

BASHO JONA

V. 5. — *Hirja*: «*Gratia*»: në mythologji kemi tri «*Hire*» qi emnohen «*Aglata*», «*Euphrosyne*» dhe «*Tballa*»; *Floçka*: *nymfe*; v. 9. — *Freski*: *Zephyrus*: erë prandimore ase vetëm erë; v. 10. — *kalojse*: kaluese, për të kaluem; v. 13. — *Han't e shpejta*: ndrrimet e shpejta të hanës; v. 15. — *Tuli i pasun*: *Tullus Hostilius*; *Auku*: *Aucus Meneus*; të dy në numrin e shtatë mbretëve të Romës; v. 21. — *Minosi*: *Minos*, i biri i *Zeusit* dhe i Europës, gjyqtar i Ferrit; v. 23.6. — *Hypolitin e pastër*: i biri i *Theseut* dhe i *Hypolitës*; mbas *Euripidit*, ky nuk u ndigjoi rënave të *Fedës*, ndjerkës së vet, e cila e paditi për të kundërtën të *Theseut*, dhe vdiq i ndrydhun nga kocija e vet, nga se i u trembën hamshorët nga një taroç i dërguem prej *Neptunit*. *Djana*, mproje e tij, pse ishte i pastër dhe dishrak gjoje, nuk mujti kurrsesi t' a shpëtojë nga vdekja; v. 27. — *e Letit*: thirret kështu lumi i Ferrit, qi do t' a kalojshin të gjithë të vdekunit; v. 28. — *Pirithout*: ishte një mik i *Theseut*; gojdhana më e përhapura difton se *Herakli* nuk pati mujtë t' a lirojë *Pirithoun*, por *Horaci* këtu *Heraklin* e zavendson me *Theseun*, tue dashun të provojë se as dashunija e njëj miku nuk mjafton për të ngjallun një të vdekun.



# “KËSHTU I DON MUSHKA DRÛT,,

(Dy fjalë me mustakoça)

**A**TJE në kryeqytetin e Iliris, në Shkodrën vigane, janë ngritur në kambë disa dhe po duen të përmysin dhën. Shumica janë partizanë të D. Ndrë Mjedjes, të cilët nuk durojnë qi ky t'u preket me pupul dhe, nga ana tjetër, përpiqen me të gjitha fuqit t'a naltësojnë sa më fort, porsì *mâ të madhin letrar e poet lirik shqiptar*, porsì *hartuesin e alfabetit*, qi kemi sot në përdorim, dhe - po të vijojnë në këtë mënyrë - *kushdi se shka do të na paraqitet nesër ky poet me vleftë i tokës s'onë*.

Përveç këtyne, në të përkohëshmen «Leka» (Vjeti XV, Nr. 6, fq. 181 - 192), me habin e të gjithëve, na del përpara një mustakoç - burrë si burrat qi qenë motit i cili synon të ndalojë zellin e të rijvet dhe të përmysë *gjuhën e mesme*, që prej kohe gjuhë zyrtare e Shqipnis, tue u vâm dangë të zezë shkrimtarëvet të saj.

Dhe këta po shkruajnë këndej e andej nepër të përkohëshme të ndryshme, me një ton shumë të fortë, sikur t'ishite kultura një monopol krejtësisht i tyne. Me këta zotnij, qi paraqiten të njëj shkollë, kam këtu një dy fjalë, me të cilat po mundohem t'u a mbushi mendjen se të tjerët nuk hân bar. Dhe pikërisht due të flas me At Mark Harapin dhe At Gjon Karmën, të dy S. J.

**A**t Mark Harapi, i cili e nderoi letërsin shqipe me përkthimin e bukur të romanit italian «*Të fejuemit*», mori shkas nga kritikuesit e vet të fyejë personalisht zotin Dr. Kolë Ashta, dhe të sulmojë *gjuhën e mesme* dhe shkrimtarët e saj.

Ndër sa fjalë fyese kundra zotit Dr. Kolë Ashta, po paraqes ato qi e karakterizojnë më mirë frymën e pastër dhe njerzore t'artikullistit: «*Kritikuesi (z. Ashta) ... nuk din me t shkruet si duhet as tri faqe të shkreta, e na ngrehet gjyqtar mbi tjerë! Ulu, more, prej fikut se del ndonjt mustakoç e të zdrypë për veshit. - ... çka lëshon shkruesalect i «Shkëndis» - Ky nuk u a ka pà as kartuçat mâ të mëdhajve filolog të shqipes e na kokorisë filologji!» (sic!)*

Tue arsyetuem me gjakftohtësi, z. Dr. Kolë Ashta është një shkrimtar i ri dhe nuk ka shkruem ende aq shumë sa me dhanë një gjykim përmbi të. Ai tash sa ka filluem të shkrujë. Pastaj ata profesorë universiteti qi i kanë dhonun titullin *doktor* në letërsi, me nënshkrimin e vet kanë treguem se z. Ashta din të shkrujë më shumë se tri faqe si duhet, dhe i është dashun të japë provime filologjije, prandej nuk ka nevojë aspak At Harapi të përmendë *kartuçat*.

Sa pse thotë At Harapi dy herë n'artikullin e vet se zoti Ashta kokorisë, unë e di se kokorisin pulat dhe jo njerëzit, prandej me këtë fjalë At Harapi ka nderuem gojën dhe pendën e vet.

Së fundi, sado i zoti të jetë At Harapi, atij i mungon, me sa di unë, titulli *doktor* në letërsi, qi gëzon zoti Ashta. E me këtë fjalë nuk due të thom se këtë do t'i përkulen të gjithë ata qi nuk e kanë ket titull, por due të thom se ai qi



gëzon një titull të tillë ka të drejtë të shkrujë dhe të gjykojë mbi vepra letrare pa pasun nevojë At Harapi me i marrun nderin përpara letërsisë me shamje. Më të vjetrit dhe më të praktikuemit nga penda mund t'a këshillojnë, mund t'i japin zemër, por jo t'a shajnë si At Harapi, vetëm pse nuk i ka pipat mirë me të.

Deri dje zoti Dr. Kolë Ashta ka shkruem shkodranisht, dhe mund të jetë që nuk i ka hÿm në palc gjuhës së mesme. Sa pse e ka shkruem fjalën «smuatore» me «ue», është një gabim me të vërtetë, por a nuk është një gabim edhe fjala shumë **filolog** (për *filologë* a *filologj*) dhe bashkimi i njësisit me shumës në frazën «mos me ja (t'a) pasë aspak lakmi **kombeve** të hueja», si vrehet në artikullin e At Harapit fq. 187 radhë 16 dhe fq. 188 radhë 20? Atëbotë, kur vetë At Harapi nuk qënka i pagabueshëm në gramatikë dhe në orthografi, pse bërtet më të kotë kundra të tjerëve? Më mirë të hapë sÿt e të shofë se mustakoçavet tashmë u ka kaluem koha.

Por pika më me randësi në artikullin në fjalë të At Harapit është sulmi kundra gjuhës së mesme dhe kundra shkrimtarëve të saj, si i ndjemi Luigj Gurakuqi, z. Aleksandër Xhuvani, Karl Gurakuqi. Ndau Paluca, Kostaq Cipo, Ernest Koliqi, Shpend Bardhi, Kolë Kamsi dhe sa e sa të tjerë.

Dhe me të vërtetë, po të lexohet me vemendje gjysma e dytë e faqes 189 të artikullit në fjalë të At Harapit, del në shesh se shkrimtarët e gjuhës së mesme – zyrtarishtes – dijnë në pikëpamjen gjuhësore vetëm të pasunohen me ar dhe të grumbullojnë qiflliqe. Por këtu Zotnija e tij mos të kujtojë se ideali është ndrym vetëm në pallatet e bukura dhe në kopështet e hapta të Jezuitëve në Shkodër. Ka idealista edhe përjashta. I ndjemi Luigj Gurakuqi, kur u vra në Bari, u gjet me këmbishë të arnueme dhe me çarapë të shkyem, e pra a kishte në dorë ai të grumbullojë të holla sa të donte, a kurrkush tjetër. Pastaj nuk është nevoja me përmendun sa e sa të gjallë që mbas gjurmëve të Luigj Gurakuqit ndjekin gjuhën e mesme, të cilët mbas më shumë se njëzet e pesë vjetësh shërbimi nëpër zyrat e natës shtetnore, sÿt banojnë ndër shtëpija të ulta qerpiqësh, dhe marrin uha nga të tjerët pse nuk u del rroga të përballojnë jetesën. U djersitën dhe u plakën pa kohë të shkretët tue punuem, ndokush edhe natën, për gjuhën shqipe, dhe prap se prap del ndonjë mustakoç që t'i hudhë në baltë, si njerëz që punojnë për bark dhe jo për ideal. Por këta puntorë të mirë dhe të ndërgjegjshëm mos të ligështohen, pse Shqipnija nuk mbahet vetëm në At Mark Harapin. E nesër-mja do t'i qesë faqe-bardhë.

Le të shikojë pastaj At Harapi se shkrimet toske kanë të njëjtën orthografi dhe paraqesin pothuajse krejtësisht një mënyrë të vetme të dialektit të vet. Por nga ana tjetër gegët, po të vrehen në shkrimet e tyre të shumta dhe të bukura, përdorin tri a katër mënyrë të ndryshme shkrimi. Pastaj trajtat e gjuhës së shkrimtarëve gegë të veriut, janë të gjymtueme dhe të hangruna shumë. Mungon shumë herë grupi mb, dhe L, gjë e cila nuk lejon të shifet rranja e fjalës dhe e bën gjuhën të vrashtë. Përkundrazi, po të shkrueshin të gjithë gegët një orthografi dhe një trajtë të vetme gjuhe, toska do të mund t'a zënte më lehtëzi gegënishten, dhe ndryshimet e dy krye-dialekteve do t'ishin shumë më të pakta.

Na del tash përpara problemi se cila gjuhë e gegëve do të mirret porsë letrare prej të gjithëve. Sigurisht ajo që kuptohet më tepër në përgjithësi. Dhe kjo është – me sa diç unë dhe sikurse është mendimi i shumë e shumë të tjerëve shqiptarë dhe të huej, albanologë – gjuha e Shqipnis së Mesme. Mirëpo, tue



qëne se kjo gjuhë ka të meta dhe me të vërtetë nuk ka dhanë deri më sot ndonji kryevepër, duhet që veshtrimi i mbiemnit «i mesëm» mos të mirret aq fort në kuptimin gjeografik, por më tepër të mirret porsit trajtë e mesme gramatikore dhe syntaktike e fjalëve. Mbas këtij mendimi punon Instituti Mbretnuer i Studimevet Shqiptare, dhe kanë shkruem shumë vetë, si u tha edhe më nalt, dhe nuk është nevoja të vrasim vehten na tash me kërkime. Librat shkollorë që ka botuem Ministrija e Arsimit janë përgjithësisht në këtë gjuhë të mesme. Pastaj kemi shkrimet e të ndjemit Luigj Gurakuqi – që mori më i pari nisjativën – dhe, midis të tjerëve, shkrimet e shumta (përkthime) të ndjekësit të tij më të përpikët dhe më puntuer z. Prof. Karl Gurakuqi.

E në qoftë se At Harapi don të ngulë kambe në fjalën e vet se kjo gjuhë e mesme nuk kuptohet, pa kurrnji mbështetje, (letrën zyrtare që tregon Zotnija e tij na nuk e kemi pâm se si ka qënë e shkrueme) e pyesim: Kush është ai që nuk e kupton gjuhën e bukur të romanit «Lule» (prej Fabjan Barkatës-përkthim nga Prof. K. Gurakuqi) ndër gegë dhe ndër toskë? Ishim ende fëmijë në klasën e parë të lyceut kur e këndojsim në shkollë faqe për faqe librin «Zemra» dhe e kuptojshim porsit gjuhën e nanës, përvec ndonjij fjale së rrallë, që profesori na e shpjegonte menjëherë. Prandej, më duket se nuk gënjehem në qoftë se thom se po t'ishin shkruem në gjuhën e këtyne dy librave shëmbullorë, veprat e Fishtës, të Prensushit dhe vetë romani i përkthyer nga At Harapi me titullin «Të fejuemit», nuk do t'i mirret vesht vetëm Sakodra me rrethet, por e gjithë Shqipnija, pa përjashtuem as toskët. E gjuha e mesme nuk i urren frazat e styllin e bukur, si i duket At Harapit.

Sa pse At Harapi ankohet se toskët nuk shkruajnë në gjuhën e mesme, duhet t'a dijë se secilit i pëlqen gjuha e nanës së vet, pa ndryshime themelore. Pastaj toskët e kanë kryem – si u tha edhe më nalt – një detyrë në këtë pikë: e kanë unjisuem gjuhën e vet mjaft. T'a bëjmë kaq edhe na gegët dhe atëbotë sa ndryshime do të mbeteshin midis dy krye-djalektevet? Rotacizma, zbutja e zanores hundore n',E, gjatësija e zanorevet dhe ndonji tjetër i pa randësi. Gjuha kështu do t'ishte e bashkueme mjaft, pa u përziem djalektet. Të përdorej atëherë nëpër zyra e shkolla gjuha e mesme, sot zyrtare. Nuk do të prishej gjë. Shkrimtarët do t'ishin të lirë me shkruë si në njënin si në tjetrin nga dy krye-djalektet pa u bâm kurrnji dhunë as shkrimtarëve të mdhej gegë, as shkrimtarëve të mdhej toskë.

Me kaq – kush don të marrë vesht dhe të cveshet nga regjonalizma – nuk duhet t'a shajë zotin Dr. Kolë Ashta, pse paska dishruem që «Të fejuemit» t'ishin shkruem në gjuhën e mesme. E në qoftë se Fishta tallej në satyrat e veta me këtë gjuhë, poezija e tij satyrike dhe polemikat e tija i tregojnë kujdo se sa pasjoni ka vluem në zemrën e tij. Ai është poeti më i madh që ka pjellë toka e jonë shqiptare, por kjo nuk don me thanë se fjala e tij është një dogëm kritike. Dhe në qoftë se këtij ajo tallje sarkastike i ka hije në satyrë, nuk i bjen për shtat aspak At Harapit në një artikull kritike.

Se ku do të dalë kjo cetë shkrimtarësh me këso shkrimesh, unë nuk e dij. Shof vetëm se prej tyne kujtohet se vetëm ata do të vrâjnë e do të kthiellin në qiellin kritik të letërsisë sonë.



Sikurse At Harapi, po me at vrull sulmues, na paraqitet edhe At Gjon Karma S. J. në numrin e përparshëm të kësaj së përkohëshme me artikullin e vet «*Lirizma Mjedjane e Bota Letrare*».

Mu në faqen e parë thotë se për këtë çashtje kanë shkruem të papjekun e të pjekun, mendëkcyem e t'urtë e të peshuem. E kush janë këta të papjekun dhe mendëkcyem? Sigurisht jo partizanët e tij, por unë më shokët, qi nuk i u përkulëm.

Prap në faqen e pestë (artikullit të vet, mbas sa talljesh, më shán porsì mal-suer të vorfën — «*ata (skyferët) çerdhen e vet e kanë nder male, ku lejnë e rriten e jetojnë si të munden*» — gjá e cila mue për vehte më bán krenar, mbassi mali i Hotit ku unë kam lém, ka mbetun má shumë se një herë pa ma-shkuj në votër tue luftuem për tokën e shéjtë shqiptare.

Dhe po në këtë faqe — faqja e sulmit má të rreptë — sikurse i ka hije pet-kut qi bán, At Karma S. J. shkruen: «*Me u dhanë gjegjen si e typin (mue me shokët në kundërshtim me të) duhet me zdrypë në shkallë të poshtërsis së ty-ne*»...

E këtu më duhet të thom: Ngadalë njiherë, po ku jemi? A edhe mue Zo-tinja e jote do të më shtijë në radhën e atyne «*që nuk dijnë se shka áshit edu-kata, dhe e perdori pendën me një fjaluer sokaqesh?*... (Vre «*Shkëndija Viti III, Nr. 8-9, fq. 25*). Ndër shkrimet e mija të pakta deri më sot nuk ka vrejtë ndokush shamje, dhe kush më njëf nuk më shán në pikëpamjen e urtis morale dhe shqiptare. Si nxanës i Shkollës Françeskane të qytetit të Teutës - votër kulture dhe edukate përnjimend shqiptare — pa u kújtuem jam përpjekun t'a kryej detyrën t'eme si nëpunës shteti, si shqiptar i vërtetë dhe si puntuer i le-travet, me sa fuqi qi kam pasun. E këtë gjá mund t'a vërtetojnë Inspektorija E-prore e Ministris s'Arsimit dhe nxanësit e mij të dashun të Normales s'Elbasanit dhe të Lyceut të Tiranës.

Áshit turp me levduem vetvehten. Këtë gjá, këndeji nga ana e jonë, nuk e ka bâm kurrkush vec At Harapi n'artikullin e sipër-treguem, por shamje të ti-lla do të shqetsojshin edhe vetë butesin e Vergilit.

Dhe tash, tue kthym në çashtjen e Mjedjes, t'a dijë kushdo se kjo nuk áshit hapun prej meje. Nuk do t'i besojshe kurr vetvehtes për një hap të tillë. E kanë hapun ata qi përmenda në fillim të këtij artikulli, qi deshën t'a naltësoj, në shumë má tepër se sa e paraqesin veprat qi i ndjemi ná ka lanë.

At Karma thotë se Mjedjen i u desht t'a studjojë për t'u a shpjeguem nxa-nësvet. Pra, i shtým prej nevoje. Dhe unë marr rasë nga kjo t'i thom Zotnis së tij: Merrni në dorë një herë, ju lutem, edhe poetët e tjerë t'Átdheut t'onë. Dhe kur të zbuloni magjstralitetin e lyrikavet të Milosaut, kur të ju dalë përpara Zef Schiró-i, madhështija e lyrikavet të Fishtës, ambelsija e Naimit, njomsija e Çajupit dhe sa e sa poezi, të bukura nga cdo pikëpamje, të Lasgushit dhe të Frennushit, do të shifni menjherë se ata qi cohen kundra jush nuk janë kundër-shtarë të Mjedjes, por — tue e lanun këtë në vendin qi i shënojnë veprat qi ka shkruem — duen të mbajnë në vend të vet nderin dhe emnin e të tjerëvet qi në lyrikë dhe përgjithësisht në letërsi i a kanë kaluem. Fol, moj «*Bukurija*» e Naimit, fol «*Milosau*» i De Radës, fol, «*Mino*»-ja i Schiroit, fol, «*Lule vjeshte*» e Fishtës, fol, «*Vasha shqiptare*» e Asllanit. Pse rri në kështu pa zá? Mos të ke-



ni frikë nga bota e vdekun mythologjike, ju shprehse të mrekullueshme të zemravet më ndiesore të poezis shqiptare.

Unë më i pari Mjeden e due dhe e cmoj. Poezit e tija i kam zanë për mendësh që prej vjetësh, dhe ato poezi të tija qi ishin të shpërndame nepër të përkohëshme të ndryshme andej e këndej, ka disa vjetë të mira qi i kam kopjuem për t'i pasun afër kurdoherë me i lexuem. T'a urrejshem Mjedjen nuk do t'a kishem bëm këtë punë kurr e kurr. Mjedja ka me të vërtetë poezi të bukura të dënja për një poet, por ka të tjerë qi kanë shumë më të bukura dhe më të njo. ma. Mjedja nuk na ngjet në një sferë të papritun poezije. Bota e tij është e zakonshme dhe e thjeshtë, dhe arti i tij i studjuem mirë. Nuk është një geni poetike. Prandej është një dhunë qi i bëm At Karma Horacit kur e përlu për t'a krahasuem me Mjedjen, sikurse s'ka kurrfarë kontrolli kur ngulë kambë se kurrnji fjale a titull nuk është i tepruem për të. Kështu, në mbështetje të një arsytimi të tillë nuk do t'ishte një gjë e tepërme t'a queshim poetin më të madh qi ka pëm bota!!!..

Prap Mjedja ka poezi aq të thjeshta saqi mund t'i punonte edhe një jrishtar n'artin poetik. Nuk e kanë bukurin, fantazin dhe fuqin tërheqse e magjike të poezivet të De Radës dhe të do vjersharvet të fishtës dhe të Naunit, keto të Dom Ndreut. Pastaj ndër gegë stulin klasik të poezis e ka punuem dhe vendosue përpara Mjedjes, dhe më mirë se Mjedja, poeti tjetër Fishta, pa i a hjekun e pa i a humbun gjuhës shqipe aspak natyrasin e rrjedhjen. E për këtë gjë mund të këshilloheni me kë të dueni, jashta rrethit t'uej.

E sa pse Mjedja është ndrÿm mbrenda vorrezavet injacjane, kjo ka një vlefte për Urdhin t'uej, por nuk ju jep arsye qi pa fare kontrolli t'a bëni një idhull, një mit në Shqipni. Mitat i krijon populli pa kujtuem dhe i shtÿm prej njëj shkaku të fortë, dhe jo grumbujt propagandistikë të një shkolle a të njëj tjetre.

Pra, ku e ka të drejtën At Karma të thotë aq pa frikë për poezin «Pal Moretti-t» se është «stoll e pakurrkundshoqe e letërsisë shqipe» e mandej «Dom Ndrë Mjedja... është aq i persosun në teknikë vjerrshash, aq i persosun në fuqi (III), n'ambeist (III), e bukuri gjuhe (III) aq i persosun në ndies zemre e hove pindarike (III), sa dahet në shej ndër shkrimtarë e poetë t'anë si dahet në shej bylbyli ndër zogj këndues»?. Më jipet të thom këtu: Sa shpirt fantastik... por tue m'u kujtuem Fan S. Noli, nuk mund të ndalohem pa i thanë për së largu: Kuku për lyrikat t'ua të bukura qi të dërmojnë në zemër, qi të rrëmbejnë papritmas dhe nuk dijnë me të lëshuem më, kuku për gjuhën t'andë të fortë e kumbuese si me qënë tue rëm shkrepë prej malit! Sot këto po vëhen te kambët e Dom Ndrë Mjedjes, më i madht letrar e poet lirik shqiptar, lumnija e kombit etj. A ka kund njëri të gjallë qi ndigjon?!!!...

Por thanjet e At Karmës me shokë janë kritike sikurse fjala qi thotë se qyteti i Gjinokastrës e ka nderuem Mjedjen tue e pagzuem lyceun e vet me emnin e tij, prej cmimit qi ka për të. Kurse nuk është aspak e vërtetë. Nuk dinte gjë fare Gjinokastra kur lyceu i saj pagzohej me emnin e Dom Ndreut. Dhe për më tepër ai qi e parashtroi, nën dikasterin e Z. Dr. Xhevat Korca, këtë gjë ka qënë një shkodoranë, dhe pikërisht Prof. Karl Gurakuqi. Gjallë janë njerëzit e mund të tregojnë. E me këso pallavrash duen me e rritë Dom Ndrën. Asht kot, me fantazi, njerëzit e mdhej vëhen në lojë, nuk naltësohen.

Mandej nuk më pëlqen aspak ajo mënyrë qi me i përlun njerëzit tue i usluem anash, dhe jo drejt për së drejti. Dhe këtë gjë e kanë bëm si At Karma



si *Skyferi*, qi dron të tregojë kush është. At Karma në ket artikull thotë se unë kam treguem si burrat se i kishem kopjuem gabim vargjet e Dom Ndreut, dhe Skyferi, tue përlijë vehten në numrin e fundshëm të «Balli i Rinisë» thotë se po e rrëfen gabimin e vet si Nikollë Dakaj. Por këta t'a dijnë se bota nuk han bar. Unë kam treguem për dy vargje dhe dy fjalë të pa ndonjtë randësi metrike se i kishem gabueme vetë. Por për vargjet e tjera të shumta qi kishem sjellun përpara si të gabueme, kam thanë për disa se ku i kam kopjuem, dhe për gjysmën e tyre ju kam përgjegjë se me të vërtetë janë gabim, me ato provat e mija.

Tash ju, në qoftë se jeni me të vërtetë burra, mos e hidhni gurin nën dorë në këtë mënyrë, por t'i përgjegjini drejt për së drejti artikullit t'ëm me titullin «Bisedim apo luftë» (Balli i Rinisë, Vjeti I, Nr. 12). E në qoftë se doni me e vijuem çashtjen e përsosunis metrike të Mjedjes, unë jam gati të vijoj më gjatë. Por çfarë faji kam unë i shkreti pse pozit e Mjedjes paraqiten ndryshej në botim e njiçtëtër? Unë nuk kam aq të holla sa me i blëm të gjitha botimet dyfishhe dhe trefijshhe të poezivet të Dom Ndreut.

Ë mos kujtoni – simbas fjalës s'uej – se unë jam berr në metrikë. Shikoni përshtatjen e metravet të vështirshëm dhe të koklavitun të Horacit (si i thurret Dr. Prof. Norbert Jokl-i) dhe do të vreni se duhet një vesh shumë i mirë për t'i sjellun në gjuhën shqipe. E përshtatjen e tyre më duket se nuk e ka bëm Zotnija e juej. Dhe nuk më ka shtëm t'a báj këtë gjë, nevoja për t'u a shpjeguem të tjerëvet, por një dishir i rinis s'ëme më të parë.

Ju mundeni me folun si të ju pëlqejë, por kohët e reja – të pastrueme prej mustakocash – kujtoj se për këtë çashtje nuk do të më tallin sikurse ju andej, në qoftë se do të lëni një rojtar të mirë në arkivën e kryepishkopatës së Shkodrës, qi mos të turbullohen shkrimet e Dom Ndreut.



**L**exues i dashun! Do të keshë thanun sa herë për disa kritika qi bëhen sot, se është turp me shkruem si shkruen disa: me shamje, me tallje, me nënkambëca etj. këso dore. As ky artikull qi të mërzi, nuk është bëm si duhet, por është nevoja të bëhet kështu sot. Pse qysh në vogli më ka pasë thanun gjithëmonë baba: *Biró, kudo qi të shkojsh, mbuloji njerëzit ashtu si të shtrojnë ata ty*. Kujtoj se jemi marrun vesh.

**Nikollë DAKAJ**



## ▪Kronikë kulturore▪

### "Magjia e leximit"

Në kuadër të 7-8 Marsit u zhvillua veprimtaria "Magjia e leximit" e cila bashkoi stafin me antarët e bibliotekës të moshave dhe profesioneve të ndryshme të pasionuar pas librit. Gjatë bisedës pjesëmarrësit ndanë me njeri tjetrin përvoja interesante nga leximi i librave si dhe nga veprimtaritë kulturore të zhvilluara në bashkëpunim me stafin e Bibliotekës. Biseda u moderua nga zj. Magdalena Haxhi, përgjegjëse e Sektorit të Librit.

Pjesë e aktivitetit ishte dhe përformanca e këngëtarit lirik Arben Mjetaj, shoqëruar në piano nga maestro Bardhyl Hysa.



### Prezantimi i librit "Naim Frashëri në historiografinë letrare shqiptare" i autorës Irma Sokoli Bilali

Me datën 1 prill 2023 në ambientet e Bibliotekës Publike "Marin Barleti", u prezantua libri "Naim Frashëri në historiografinë letrare shqiptare" i autorës Irma Sokoli Bilali. Fjalën përshëndetëse e mbajti Prof. Stefan Çapaliku. Prof. Evalda Paci dhe Dr. Ermira Alija mbajtën kumtesat e tyre rreth librit. Aktiviteti u moderua nga drejtori i bibliotekës Maxhid Cungu.

Libri trajton ndikimin e figurës së Naim Frashërit historiografinë letrare shqipe duke referuar shumë autorë të rëndësishëm shqiptarë dhe të huaj që kanë paraqitur studime për të. Ky libër është një burim i rëndësishëm i informacionit për studiuesit dhe studentët e letërsisë dhe të historisë shqiptare.



### Prezantimi i romanit "Kohë dashurish të harruara", të autorit Ardian Cerga.

Me datën 12 prill 2023 Biblioteka "Marin Barleti" organizoi prezantimin e romanit "Kohë dashurish të harruara", të autorit Ardian Cerga.

Aktori i njohur i kinematografisë shqiptare, Ardian Cerga ka ardhur këtë herë para lexuesve dhe artdashësve shkodranë në një dimension të ri, në rolin e shkrimtarit. Libri "Kohë dashurish të harruara", bazohet në jetën personale të tij nga vitet '80 deri më

sot ku trajtohet një gamë e gjërë ngjarjesh nga jeta shoqërore e Shqipërisë së këtyre viteve. Drejtori i Bibliotekës Maxhid Cungu, në fjalën e hapjes theksoi se shoqëria shqiptare ka nevojë për vepra të tilla letraro-artistike të cilat paraqesin një shikim retrospektiv të kësaj periudhe në Shqipëri.

Biseda me autorin u moderua nga aktorja e teatrit “Migjeni”, Merita Smaja e cila në vazhdim interpretoi pjesë nga libri.

Shkrimtari Xhahid Bushati paraqiti një analizë të strukturës dhe kompozimit artistik të romanit. Gazetarja Neda Elbasani lexoi dhe interpretoi pjesë të cilat krijuan atmosferën e ngjarjeve të përshkruara në libër.

Në vazhdim morën fjalën aktori Astrit Fani, lexuesi i pasionuar Sokol Haliti, pedagogu Gëzim Puka, shkrimtaret Mimoza Rexhvelaj, Arjola Zadrima, Merita Kastrati, koleksionisti Andrea Jakova të cilët drejtuan pyetje në adresë së autorit si dhe dhanë përshtypjet e tyre për librin.

### **Prezantim i librit "Uilliam Shekspir" të Viktor Hygoit**

Biblioteka "Marin Barleti" në bashkëpunim me "Aleancën Franceze" prezantuan librin "Uilliam Shekspir" të Viktor Hygoit. Veprimtaria u moderua nga drejtorja e "Aleancës Franceze" Dhurata Hoxha.

Drejtori Maxhid Cungu, në fjalën e hapjes theksoi se përkthimi i veprave të kolosëve të letërsisë botërore mbetet një burim i pashtershëm për zhvillimin dhe pasurimin e kulturës në vendin tonë.

Përkthyesja e librit Ermira Xhomaqi Godo foli për historinë e veçantë që ka patur procesi i përkthimit i cili ka filluar nga gjyshi i saj, intelektuali Abdulla Rami, në kushte të internimi nga diktatura. Këtë punë ajo e ka vazhduar në vitet e fundit duke finalizuar me botimin e librit.

Pedagogia e gjuhës frënge, Drita Brahimi mbajti kumtesën "Rëndësia dhe jehona e veprës "Uilliam Shekspir" të Hektor Hygo.

Më tej morën fjalën pedagogu Gëzim Puka, studiuesi Gjovalin Çuni, Aleks Dushi, etj të cilët drejtuan pyetje përkthyeses dhe diskutuan rreth librit.

**Me rastin e Ditës Botërore të Librit, në periudhën 17-23 prill 2023, Biblioteka "Marin Barleti" organizoi një sërë veprimtarishë si, takime me lexuesit e rinj nga shkolla të ndryshme të qytetit, biseda letrare, prezantime librash nga të cilat po paraqesim si vijon:**



Me rastin e ditës Botërore të Librit, Biblioteka "Marin Barleti" organizon:

### **VEPRIMTARITË**

- # "Të duam librin", bisedë me nxënësit të shkollës Ismail Qemali  
E enjte, 20 prill 2023, në Bibliotekën "Marin Barleti"
- # Prezantim i librit "Për një demokraci të vërtetë shqiptare" | autorit Filip Gurazli  
E shtunë, 22 prill 2023, ora 11.00, në Bibliotekën "Marin Barleti"
- # Festivali III Mbarëkombëtar i Poeteshave - Shoqata "Gratë frymojnë vlera"  
E shtunë, 22 prill 2023, ora 12.30, në Bibliotekën "Marin Barleti"
- # Ligjëratë e shkrimtarit Stefan Çapaliku me temë "LETËRSIA DHE QYTETI"  
E diel, 23 prill 2023, ora 11.00, në oborrin e shtëpisë "Oso Kuka"



### **Promovimi i librit “Për një demokraci të vërtetë shqiptare” me autor Filip Guraziu**

Kjo veprimtari u zhvillua në praninë e një audience të gjërë lexuesish dhe dashamirë të kulturës. Mësuesi i njohur Gjeto Voci paraqiti një analizë të hollësishme të librit duke theksuar rëndësinë për kujtesën historike të ngjarjeve që mbart libri. Shkrimtari i shquar Primo Shllaku e vlerësoi librin si kontribut në pasurimin e letërsisë memorialistike. Më tej ai trajtoi raportin që ka shkrimi në dialektin gegnisht, që është karakteristikë e këtij libri, me kulturën kombëtare të shkrimit të letërsisë.

Autori Filip Guraziu, pasi falenderoi pjesëmarrësit, solli disa aspekte të punës së tij si drejtues vendor por edhe si veprimtar të shoqërisë civile në zhvillimin social- ekonomik të zonës së Shkodrës e më gjërë.

Veprimtaria u moderua nga drejtori i Bibliotekës Maxhid Cungu i cili vlerësoi gjithashtu librin por edhe nisiativat e z. Guraziu në rrjetet sociale në promovimin e trashëgimisë kulturore e historike të zonës së Shkodrës si dhe vënjes së saj në shërbim të zhvillimit të shoqërisë shqiptare.



### **Festivali i III Mbarëshqiptar i Poeteshave**

Veprimtaria tjetër e zhvilluar në ambjentet e Bibliotekës “Marin Barleti” me datën 22.04.2023, ishte Festivali i III Mbarëshqiptar i Poeteshave. Ky Festival u organizua nga Lëvizja vullnetare “Gratë Frymojnë Vlera”. Zj. Farida Ramadani, drejtuese e Festivalit, pasi prezantoi programin tha se nga 52 poezi të dërguara u perzgjodhen 25.

Juria e Festivalit e përbërë nga Rozafa Shpuza poete, Ermira Alija, pedagoge dhe Zyrafete Shala Kryetare e Shoqatës së Shkrimtareve Ferizaj, vlerësoi me çmime si më poshtë vijon:

Çmimi i Parë: Melita Vjerdha, Shkodër;  
Çmimi i Dytë: Shefqete Gosalci, Prishtinë;  
Çmimi i Tretë: Natasha Xhelili, Sarandë;  
Çmim Special: Meri Mezini, Tiranë;



Çmim Special: Klevisa Bardeli, Shkodër.

Festivali u moderua nga gazetarja Kozeta Bruçi. Gjate aktivitetit, nxënësit e shkollës “Dëshmoret e Prishtinës”, shoqëruan me kitare te gjitha poezitë që interpretuan poetet.

### **Bisedë Letrare me shkrimtarin Stefan Çapaliku me temë: "Letërsia dhe qyteti"**

Veprimtaritë dedikuar javës së librit në kuadër të Ditës Botërore të tij kulmuan me aktivitetin "Letërsia dhe qyteti", organizuar nga Biblioteka Publike "Marin Barleti" në oborrin e Shtëpisë "Oso Kuka" ku i ftuar ishte shkrimtari Stefan Çapaliku për të ligjëruar rreth marrëdhënies së hershme të Shkodrës me letërsinë. Ndër të tjera ai foli për kushtet historike të zhvillimit të kulturës si dhe të letërsisë në veçanti në qytetin e Shkodrës.



Në këtë aktivitet u promovua edhe libri më i ri i autorit Stefan Çapaliku "Darkave, nga një mbas buke", një përmbledhje me tregime të shkurtëra.

Veprimtaria u moderua nga drejtori i Bibliotekës Maxhid Cungu, i cili falenderoi pjesëmarrësit dhe tha se një ndër objektivat kryesore të Bibliotekës mbetet rritja e cilësisë së veprimtarive kulturore të cilat shkojnë në drejtim të rritjes së numrit të lexuesve dhe zhvillimit kulturor të qytetit.

Takimi përmbyllës për Ditën Ndërkombëtare të Librit u ndoq me mjaft interes nga një numër i lartë pjesëmarrësish.



### **Prezantim i librit “Përndjekja e Hajrije Mulletit, stigma e një komedie” i shkrimtares Fatbardha Saraçi Mulleti**

Me datën 2 qershor 2023, Biblioteka "Marin Barleti" në bashkëpunim me Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit dhe Shoqatën e Ish të Përndjekurve Politikë zhvilluan veprimtarinë për prezantimin e librit më i ri i shkrimtares Fatbardha Saraçi Mulleti “Përndjekja e Hajrije Mulletit, stigma e një komedie”.

Ky libër ka në qendër historinë e pazakontë të gruas së ish prefektit Qazim Mulleti, të cilën letërsia e realizmit socialist u rrek t’a denigronte përmes satirës. Në emër entit botues, Istituti SKPK, përshëndeti drejtori Çelo Hoxha. Veprimtaria u moderua nga studiuesi Gjovalin Çuni.

***Përgatiti: Maxhid CUNGU***